



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në "Psikologji" me Profile "Psikologji Organizative", "Psikologji Komunitare" dhe "Këshillim dhe Psikoterapi me Orientim Njohës Sjellor"

ofruar nga

Universiteti "Mesdhetar i Shqipërisë"

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof.Assoc.Eralda Zhilla

Dr.Ortenca Kotherja

Prill / 2025

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

1

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Për Programin e studimit Master i Shkencave në “Psikologji” me profile “Psikologji Organizative”, “Psikologji Komunitare” dhe “Këshillim dhe Psikoterapi me Orientim Njohës Sjellor”.

1	IAL aplikues:	Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti Psikologjisë-Sociologjisë
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave në “Psikologji”, me profile: “Psikologji Organizative”, “Psikologji Komunitare”, “Këshillim dhe Psikoterapi me orientim Njohës Sjellor”.
4	Urdhëri/VKM i liçensimit:	UMAS nr. 576, datë 04.10.2022
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	Urdhër me nr. 576 datë 04.10.2022
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i Dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	Në 2 vite akademike 4 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	120 kredite (ECTS)
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	7 (shtatë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	12 PAE / 4 PAK v.a.2022-2023 11 PAE / 3 PAK v.a. 2023-2024
18	Numri i studentëve:	-2021-2022 44 studentë (18 organizative dhe 26 komunitar) -2022-2023 38 studentë (14 organizative, 12 komunitar, 12 psikoterapi) -2023-2024 42 studentë (12 org, 6 komunitar dhe 24 psikoterapi)
19	Komente / të tjera:	-

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM:

Programi i studimit Master i Shkencave në “Psikologji” me profile: “Psikologji Organizative”, “Psikologji Komunitare” dhe “Këshillim dhe Psikoterapi me Orientim Njohës Sjellor”, është një program studimi, që u riorganizua nga Master i Shkencave cili ofrohet prej vitit 2022. Qëllimi i programit të studimit Master i Shkencave në Psikologji me profilet: “Psikologji Organizative”, “Psikologji Komunitare” dhe “Këshillim dhe Psikoterapi me Orientim Njohës Sjellor”, është të ofrojë një formim të thelluar dhe profesional për studentët në fushat specifike të psikologjisë. Ky program synon të zhvillojë aftësitë teorike dhe praktike të studentëve për t'u përgatitur si profesionistë të kualifikuar që mund të ofrojnë shërbime të specializuara në mjedise organizative, komunitare dhe klinike. Përmes një kurrikule të pasur, studentët do të fitojnë njohuri të avancuara mbi teoritë dhe praktikën më të fundit të psikologjisë dhe do të zhvillojnë aftësitë për të aplikuar metoda të bazuara në kërkime shkencore dhe ndërhyrje terapeutike në kontekste të ndryshme. Programi ka për qëllim të kontribuojë në zhvillimin e profesionistëve të aftë për të ofruar mbështetje dhe zgjidhje efektive në problematikat psikologjike të individëve dhe grupeve, duke iu përgjigjur nevojave të ndryshme të shoqërisë dhe tregut të punës.

Kjo perspektivë e programit të studimit krijon mundësinë që studentët të jenë të orientuar sa më qartë në përzgjedhjen e rrugëtimit të tyre profesional si brenda dhe jashtë vendit. Ky program studimi është program i studimeve të ciklit të dytë të studimeve universitare, me një nivel të studimeve 7 të Kornizës Shqiptare të kualifikimeve, me një kohëzgjatje prej 2 vitesh akademike, me studime me kohë të plotë, me 120 kredite. Njësia akademike që e ofron atë është njësia kryesore: Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Humane, si pjesë e institucionit të Universitetit Mesdhetar dhe njësia bazë është Departamenti i Psikologjisë-Sociologjisë. Kjo kurrikul kombinon dhe harmonizon dimensionin teorik në fushën e psikologjisë botërore me kontekstin Shqiptar.

Objektivi kryesor i programit të studimit Master i Shkencave në “Psikologji” me profilet “Psikologji Organizative”, “Psikologji Komunitare” dhe “Këshillim dhe Psikoterapi me Orientim Njohës Sjellor”, është të formojë profesionistë të kualifikuar dhe të specializuar në fushat e psikologjisë, të cilët do të jenë të aftë të aplikojnë njohuri dhe aftësi të thelluara shkencore dhe praktike për të adresuar dhe zgjidhur sfidat psikologjike në kontekste të ndryshme organizative, komunitare dhe klinike. Ky program ka për qëllim zhvillimin e kapaciteteve të studentëve për të aplikuar metoda të avancuara psikologjike dhe terapeutike, duke u përgatitur ata për të ofruar shërbime profesionale që kontribuojnë në mirëqenien e individëve dhe grupeve, si dhe për të mbështetur zhvillimin e kërkimeve dhe praktikën më të mira në fushën e psikologjisë. Ky program studimi i nënshtrohet procesit të vlerësimit për akreditim për herë të parë, i cili bazohet në dy grupe lëndësh të detyrueshme dhe lëndë me zgjedhje. Numri i studentëve të rregjistruar në programin e studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Psikologji” me profile “Psikologji Organizative”, “Psikologji Komunitare” “Këshillim dhe Psikoterapi me Orientim Njohës Sjellor”, për vitin akademik 2023 - 2024 është 42 studentë (12 org, 6 komunitar dhe 24 psikoterapi *(të dhëna të mara nga sekretaria mësimore)*).



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM:

Vlerësimi për programin e studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Psikologji” me profile “Psikologji Organizative”, “Psikologji Komunitare” dhe “Këshillim dhe Psikoterapi me Orientim Njohës Sjellor”, identifikimi i shkallës së përmbushjes së Standardeve Shtetërore të Cilësisë, të cilat janë në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”¹, si dhe në përputhje me Vendimin Nr. 825, datë 24.12.2021 “Për disa shtesa dhe Ndryshime në Vendimin Nr. 109, datë 15.02.2017”, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë”². Për realizimin e vlerësimit të jashtëm të cilësisë për programin e studimit “Master i Shkencave në “Psikologji” me profile “Psikologji Organizative”, “Psikologji Komunitare” dhe “Këshillim dhe Psikoterapi me Orientim Njohës Sjellor”, ofruar nga Departamenti i Psikologjisë-Sociologjisë në Fakultetin e Drejtësisë dhe Shkencave Humane të Universitetit Mesdhetar të Tiranës, ASCAL ka ngritur grupin e vlerësimit të jashtëm (GVJ), të përbërë nga ekspertët e jashtëm të vlerësimit **Prof.Asoc. Eralda Zhilla dhe Dr. Ortenca Kotherja**. Gjatë procesin të vlerësimit të jashtëm grupi i ekspertëve është asistuar nga Koordinatori Teknik i ASCAL, MSc. Arbri Ndreka.

Grupi i vlerësimit të jashtëm për hartimin e raportit të vlerësimit të jashtëm është bazuar në Raportin e vlerësimit të brendshëm (RVB) të grupit të vlerësimit të brendshëm për programin e studimit në vlerësim, për shkallën e përmbushjes në dokumentacionin shoqërues të RVB-së dhe informacionin e grumbulluar përgjatë takimeve të organizuara me aktorë të ndryshëm të përfshirë në ofrimin e programit të studimit Master i Shkencave në “Psikologji” me profile “Psikologji Organizative”, “Psikologji Komunitare” dhe “Këshillim dhe Psikoterapi me Orientim Njohës Sjellor” gjatë vizitave në Institucion të mbajtura në data 4-5 Nëntor 2024. Vizitat në institucion janë mbajtur sipas agjendës së miratuar nga ASCAL, e cila i është njoftuar paraprakisht Univeristetit Mesdhetar të Tiranës sipas parashikimeve të akteve rregullatorë të ASCAL.

Gjatë vizitës dy ditore (4-5 nëntor 2024) në Univeristetin Mesdhetar të Shqipërisë u mbajtën takime me drejtuesin e njësies kryesore dhe drejtuesin e njësies bazë ku ofrohet programi i studimit në vlerësim, me grupin e vlerësimit të brendshëm, me studentët e programit të studimit, me personelin akademik efektiv dhe me kontratë të angazhuar në mësimdhënie në programin e studimit, me sekretarinë mësimore, me përfaqësues të Zyrës së Këshillimit të Karrierës,

¹Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Shqipëri”

https://archive.org/stream/LIGJI802015PERARSIMINELARTEDHEKERKIMINSHKENCORFLETORJAEBOTIMEVEZYRTARE/LIGJI+80+2015+PER+ARSIMIN+E+LARTE+DHE+KERKIMIN+SHKENCOR+FLETORJA+E+BOTIMEVE+ZYRTARE_djvu.txt (Aksesuar më 09-09-2023).

² Vendimi Nr. 825, datë 24.12.2021 Për disa shtesa dhe Ndryshime në Vendimin Nr. 109, datë 15.02.2017 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë”

<https://arsimi.gov.al/vendim-nr-825-date-24-12-2021-per-disa-shtesa-dhe-ndryshime-ne-vendimin-nr-109-date-15-2-2017-te-keshillit-te-ministrave-per-organizimin-dhe-funksionimin-e-agjencise-se-sigurimit-te-cil-2/>. (Aksesuar më 09-09-2023).

Sigurimit të brendshëm të cilësisë, me përfaqësues së Drejtorisë së koordinimit dhe marrëdhënieve me jashtë, me përfaqësues të Drejtorisë së burimeve njerëzore, gjithashtu u zhvilluan vizita në mjedise të UMSH-së, FDSHH-së, si dhe në biblioteka, mjedise studimi, auditore, laboratorë dhe në mjediset e shërbimeve të ndryshme për studentë, etj.

GVJ ka vlerësuar në mënyrë të kujdesshme RVB-në dhe dokumentacionin shoqërues të saj, përpara vizitave në institucion në mënyrë që të zhvillonte një takim të mirëinformuar paraprakisht me aktorët e programit të studimit. Raporti përfundimtar do të shërbejë jo vetëm për akreditimin e programit bazuar në shkallën e përmbushjes së standardeve, por gjithashtu informon Universitetin Mesdhetar të Shqipërisë, Tiranë, MASR, publikun e gjerë dhe studentët e programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Psikologji” me profile “Psikologji Organizative”, “Psikologji Komunitare” dhe “Këshillim dhe Psikoterapi me Orientim Njohës Sjellor” mbi përmbushjen e standardeve. Përmes këtij raporti njësia kryesore dhe ajo bazë kanë mundësi të identifikojnë pikat e forta të tyre duke bërë të mundur fokusimin mbi to për një zhvillim cilësor dhe me standarde konform aspektit profesional dhe tregut të punës si dhe standardeve përkatëse.

Draftimi i raportit të vlerësimit të jashtëm (RVJ) ka filluar pas vizitës dy ditore në institucion dhe procesi është asistuar nga koordinatori teknik i ASCAL, MSc. Arbri Ndreka.

Më datë 11.03.2025, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr.21/7 Prot., datë 11.03.2025 dërgohet në institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. IAL, përmes sistemit AMS, më datë 05.04.2025 dhe me shkresë zyrtare Nr.1554/2 Prot., datë 03.04.2025, ka dërguar komente mbi draft raportin.

GVJ, pasi u njoh me komentet e Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë, për secilin prej standardeve, sqaron si më poshtë:

1.Lidhur me komentin për shkallën e përmbushjes së rekomandimeve akreditimi i fundit, RVJ fq. **22/116 Standarti II.1, Kriteri 3** GVJ rishqyrtoi sërish dokumentat përkatës të dërguara nga institucioni përkatës (*Evidenca 14, 14.1*) që lidhen me këtë Standard bazuar në programin mësimor në lidhje me ndarjet përkatëse të lëndëve, kreditet, përqindjet apo orët mësimore për të cilën është dhënë dhe sugjerimi dhe del në konkluzion se analiza është bërë konform këtyre dokumentacioneve. Kjo për të dhënë një rezultat me Objeksionin nr.1 (lidhet me sugjerimin) dhe Objeksionin nr.2 (lidhet me konkluzionin). Nisur nga ky fakt i qëndrohet sugjerimit dhe konkluzionit të dhënë duke theksuar dhe njëherë rishikim të lëndëve, mësimore, ndarjes së tyre në përqindje, krediteve, apo orëve individuale. Ajo që vërehet se në kthimin e përgjigjes nga insitucioni në objeksionin e dhënë në këtë standard, jepet një përshkrim i detajuar dhe konform shifrave egzakste ashtu sikurse është sugjeruar dhe nga GVJ por në planin mësimor (*Evidenca 14*) dhe në planin mësimor të ndarë në veprimtari formuese (*Evidenca 14.1*) vërehet një shpërndarje



tjetër që mund të jetë mbase dhe një lapsus. Nisur nga ky fakt në raport nuk bëhen ndryshime. (Kjo pikë i jep përgjigje Objeksionit nr.1 dhe Objeksionit nr.2)

2.Lidhur me komentin për pikën “Konkluzione” që ndodhet në Standardin II.2 fq.30/166 GVJ rishqyrtoi analizën e konkluzionit duke u bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga institucioni dhe specifikisht komponentëve që lidhen me këtë pikë. Nga rishikimi i dokumentacioneve si Evidenca (7,8,9) mbi rregulloret përkatëse si Rregulloren e departamentit, Rregulloren e programit mësimor, Rregulloren e Fakultetit DSHH për të riparë mbi përzgjedhjen, rolin, funksionin detyrat e koordinatorit të programit mësimor nga analiza rezultoi se kishte një koordinator. Nisur nga ky fakt në raport bëhen ndryshime.

3.Lidhur me komentin për pikën “Konkluzione” që është pjesë e Standardit II.4 fq.41/116 mbi hartimin e syllabuseve nga titullarët e lëndëve të kategorisë “Profesor” GVJ rishqyrtoi dhe njëherë dokumentacionin përkatës Evidenca (14.2; 16). Nga rishikimi i këtyre dokumentave dhe mënyra e hartimit të syllabuseve, lektorëve përkatës të lëndëve. Bazuar në faktin që disa aspekte të programit kërkojnë një vëmendje më të madhe, me qëllim adresimin e duhur të çështjeve kryesore zbatuese dhe praktike në programin Master Shkencor kërkohet që njësia bazë të fokusohet në rritjen e vëmendjes për hartimin e syllabuseve nga titullarët e lëndëve që përkasin kategorisë "Profesor", siç kërkohet edhe nga legjislacioni përkatës. Kjo nisur nga fakti që ky hap është thelbësor për të siguruar një përmbajtje të saktë, të strukturuar dhe në përputhje me standardet akademike dhe ligjore. Nisur nga ky fakt në raport nuk bëhen ndryshime.

4.Lidhur me objeksionin nr.5 mbi komentin e pikës “Konkluzion” pjesë e Standardit fq.44/116 Standardi II.5 mbi vendosjen apo specifikimin e akteve rregullative mbi profesionet e rregulluara dhe ligjit mbi Urdhrin e Psikologut në Republikën e Shqipërisë, në dokumenta themelore të programit të studimit dhe të Departamentit të Psikologjisë-Sociologjisë. GVJ rishikoi edhe njëherë dokumentat përkatës Evidenca (4,5, 7,8,9) dhe konkludoi në faktin duke qënë se Profesia e psikologut është një profesion i rregulluar shihet si domosdoshmëri specifikimi i akteve rregullative në dokumentacion si rregullore e departamentit, rregullore programit mësimor apo dhe në etiketimin e programit mësimor etj. Nisur nga ky fakt në raport nuk bëhen ndryshime në raport.

5.Lidhur me komentin për standardin VI.1, kriteri 2, kriteri 3 dhe kriteri 5 GVJ rishqyrtoi raportin në lidhje me rekomandimin e bërë në kërë drejtim, verifikoi sërish të gjithë dokumentacionin e dorëzuar nga institucioni (Evidenca 18, 25, 32, 34, 37, 38, 48, 50) ku në asnjë prej tyre nuk paraqitet një raport i detajuar në nivel programi studimi për secilën lëndë dhe secilin pedagog. Duke identifikuar kështu problematikat në mënyrë nominale, mund të bëhen rekomandime për përmirësime të mëtejshme. Referuar dokumentacionit të dorëzuar dhe vizitës në institucion, ritheksojmë sërish që nuk evidentohet asnjë raport lidhur me vlerësimin e pedagogëve për secilën lëndë në këtë program studimi. Kjo gjë nuk i shërben përmirësimit të

programit dhe marrjen në konsideratë të ankimeve. Mungojnë dokumente mbështetëse të punës së këtyre strukturave në formën e raporteve që prodhohen për këtë program studimi dhe departamentin. Nisur nga ky fakt në raport nuk bëhen ndryshime në raport.

6.Lidhur me komentin për standardin VI 2, Konkluzione - Grupi i vlerësimit të jashtëm rishqyrtoi raportin e vlerësimit të jashtëm i cili është në të njëjtën linjë logjike edhe me standardin VI. 1, ku ritheksohet mungesa e një dokumentacioni mbështetës që vlerëson punën e pedagogëve për secilën lëndë në nivel programi studimi dhe departamenti. GVJ ka konstatuar që nuk përmbushet me mjete dhe instrumente adresimi i mangësive dhe përmirësimi në vijim i cilësisë, si rrjedhojë nuk gjendet e aplikuar edhe motivimi i arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët. GVJ nuk gjen dokumente mbështetëse që dëshmojnë punën që bën institucioni në këtë drejtim, duke i shërbyer këtij programi studimi (me raporte specifike të vlerësimit për secilën lëndë dhe secilin pedagog), përveç raportit që është përmendur shumë herë gjatë RVB. Si konkluzion GVJ në lidhje me këtë pikë nuk bën ndryshime në raport.

7.Lidhur me komentet për standardet VI 3; VI 4 dhe VI 5 “Konkluzionet” GVJ i qëndron të njëjtit vlerësim si më sipër, ndaj nuk merr në konsideratë objeksionet e paraqitura nga institucioni. Si përfundim, GVJ në lidhje me këto standarde nuk bën ndryshime në raport.



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Psikologji” me Profile “Psikologji Organizative”, “Psikologji Komunitare” dhe “Këshillim dhe Psikoterapi me Orientim Njohës Sjellor” ofruar nga Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë”.

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Universiteti i Mesdhetar i Shqipërisë është institucion privat i arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, i cili në misionin e tij ka të përcaktuar qartë orientimin e veprimtarisë së tij për formimin e specialistëve të lartë dhe shkencëtarëve të rinj, në përputhje me prioritetet e zhvillimit kombëtar duke kontribuar në ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave kombëtare. Ky institucion është licencuar nga Qeveria, si institucion i arsimit dhe i kërkimit shkencor. Në Statutin³ e Universitetit Mesdhetar (2022), neni 4: Në misionin e tij deklarohet se: “Universiteti Mesdhetar” si institucion i arsimit të lartë ka për mision të ofrojë veprimtari krijuese në fushën e informatikës, shkencave ekonomike, juridike, ndërkombëtare, psikologjike, sociale dhe politike që realizojnë synimet e tyre profesionale si brenda dhe jashtë vendit në përputhje me kërkesat dhe nevojat e shoqërisë. Zhvillimin dhe mbrojtjen e dijeve nëpërmjet mësimdhënies dhe veprimtarisë akademike që kryhet si brenda dhe jashtë vendit, formimin e studentëve të rinj në fushat e sipër përmendura nëpërmjet programeve universitare mësimore-shkencore të një niveli të përparuar bashkëkohor si në aspektin metodik e teorik. Gjithashtu thellimin e kualifikimit profesional, shkencor te specialistët, në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit. Duke kontribuar në nritjen e standardeve të demokracisë në vend. Ky program studimi është hartuar duke u mbështetur në planin strategjik institucional⁴ dhe me misionin e institucionit⁵. Për të përmbyshur

³ Evidencë 1. Statuti I UMSH

⁴ Evidencë 4. Plani i zhvillimit strategjik UMSH

⁵ Evidencë 1. Statuti UMSH Neni 4.

	sa më mirë kontributet e tij dhe për të dhënë një panoramë më të plotë të marjes së njohurive nga ana e studentëve si dhe në përshtatje me tregun ky program Masteri Shkencor pati një riorganizim⁶ nga Master i Shkencave në “Psikologji” me profile “Psikologji Organizative” dhe “Psikologji Komunitare” në Master i Shkencave në “Psikologji” me profile “Psikologji Organizative”, “Psikologji Komunitare” dhe “Këshillim dhe Psikoterapi me Orientim Njohës dhe Sjellor”. Ky program i studimit është në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë”⁷, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore të tjera që janë aplikuar në implementimin e tij si VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”⁸ dhe Vendimi nr. 879 datë 18.12.2019⁹. Ky program¹⁰ studimi të ciklit të dytë Master i Shkencave ka si synim pajisjen e studentëve me njohuri që i formon ato në fushën e shëndetit mendor, organizativ, komunitar si dhe duke i dhënë një orientim në aspektin sjellor dhe njohës. Gjithashtu ka si qëllim të përgatisë specialistë të spikatur në sektorin privat, publik, jo fitimprurës në shëndetin mendor, komunitar si dhe në atë organizativ nëpërmjet gjenerimit të ideve që ju japin përgjigje dhe zgjidhje sfidave sociale aktuale dhe perspektive të zhvillimit kombëtar dhe rajonal.
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Program i studimit Master i Shkencave në “Psikologji ” me profile “Psikologji Organizative”, “Psikologji Komunitare” dhe “Këshillim dhe Psikoterapi me Orientim Njohës Sjellor”, është hartuar duke u bazuar mbi kuadrin ligjor në fuqi si dhe në përputhje me politikat e brendshme të institucionit dhe nevojave socio-ekonomike të vendit. Gjithashtu duke iu referuar kushteve specifike përsa i përket zhvillimit të profesioneve, ky profil ka

⁶ Evidencë 51:Urdhër për njohje Msc dhe zbatim nga MASR

⁷Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Shqipëri”
https://archive.org/stream/LIGJI802015PERARSIMINELARTEDHEKERKIMINSHKENCORFLETORJAEBOTIMEVEZYRTARE/LIGJI+80+2015+PER+ARSIMIN+E+LARTE+DHE+KERKIMIN+SHKENCOR+FLETORJA+E+BOTIMEVE+ZYRTARE_djvu.txt (Aksesuar më 09-09-2023).

⁸ VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”
<https://univlora.edu.al/ep-content/uploads/2018/02/VKM-nr.-41-date-24.1.2018.pdf> (Aksesuar më 09-09-2023).

⁹ Vendimi nr. 879, datë 18.12.2019 i Këshillit të Ministrave. Disa Ndryshime dhe Shtesa në Vendimin Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”
<https://docs.google.com/a/fshn.edu.al/viewer?a=v&pid=sites&srcid=ZnNobi5lZHUuYEx8ZnNobnxneDo3NzYxM2UeZENZhMEE1Yjdi> (Aksesuar më 09-09-2023).

¹⁰ Evidencë 5:Strategjia e Zhvillimit të Programit të Studimit Msc në Psikologji me Profile.Pdf

	prespektivë të mirë të zhvillohet me tej dhe të kontribuojë në mënyrë efikase në avancimin e kërkimit shkencorë në të tre profilet si dhe duke u përshtatur me kërkesat e tregut. Ky program ndjek të gjitha rregullat dhe ligjet e vendosura nga shteti në lidhje me arsimin e lartë. Programet e studimeve të ofruara nga UMSH, përfshirë programin e ciklit të dytë Master i Shkencave, kujdesen për ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike dhe kulturore kombëtare. Këto synime janë në përputhje me Planin Strategjik të UMSH-së 2018-2023¹¹. Gjithashtu bazuar dhe në rregulloren e organizimit të UMSH-së¹² në Nenin nr.4 Pika 1. Theksohet qartë liria akademike në a) organizimin e veprimtarisë e mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe ato krijuese, b) në hartimin dhe zhvillimin e programeve të studimit dhe në përcaktimin e fushave të kërkimit, c) organizimin e promovimit të personelit akademik.
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullore të Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike të Institucionit.	Universiteti Privat "Mesdhetar" ofron dhe synon parimin e zhvillimit dhe realizmin njohës dhe praktik në mënyrë sa më të përshtatshme me ecurinë zhvilluese si në nivel kombëtar dhe atë ndërkombëtar. Bazuar në këto elementë, Universiteti ka hartuar një sërë dokumentash që synojnë ruajtjen e linjës akademike të tij dhe prioritetet kryesore të zhvillimit. Këto dokumente përfshijnë Strategjinë e Zhvillimit Institucional¹³, Rregullore e programit Msc Psikologji me profile ¹⁴, Planin strategjik i programit të studimit¹⁵ si dhe dokumente të tjera relevant si Statuti i UMSH ¹⁶, rregullorja e njësive kryesore¹⁷, si dhe atë të njësive bazë që ofron programin e studimit¹⁸ etj. Programi i studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në "Psikologji" me profile "Psikologji Organizative", "Psikologji Komunitare" dhe "Këshillim dhe Psikoterapi me Orientim Njohës Sjellor", është në përputhje me qëllimin dhe misionin e UMSH si dhe është bazuar në fushën e studimit, bazuar në njësine bazë, Departamentit të Psikologjisë dhe Sociologjisë. Ky profil ofron perspektivë të mirë për zhvillim të mëtejshëm dhe kontribut efikas në avancimin e studimeve në

¹¹ Evidencë 4. Planin strategjik UMSH 2018-2023.

¹² Evidencë 2. Rregullore e organizimit UMSH

¹³ Evidencë 4. Planin strategjik i zhvillimit të Studimit Msc në Psikologji me Profile UMSH.

¹⁴ Evidencë 9. Rregullore e programit Msc Psikologji me Profile.

¹⁵ Evidencë 5. Planin Strategjik për Zhvillimin e Programit.

¹⁶ Evidencë 1. Statuti i UMSH

¹⁷ Evidencë 7. Rregullore e Fakultetit DSHH.

¹⁸ Evidencë 8. Rregullore Departamentit Psikologji-Sociologji .

	nivelin e tretë, në profilin klinik. Gjithashtu ka për qëllim thellimin e njohurive dhe aftësive praktike në fushat specifike të psikologjisë. Çdo profil ka fokus të veçantë si zhvillimin e aftësive të aplikueshme në mjedise organizative dhe përqendrohet në aspekte të psikologjisë që lidhen me menaxhimin e burimeve njerëzore, në aplikimin e teorive dhe teknikave të psikologjisë në kontekste komunitare dhe sociale si dhe përqendrohet në zhvillimin e aftësive për ofrimin e këshillimit dhe terapisë në kuadrin e një qasjeje njohëse-sjellore, që integron teoritë dhe teknikat që lidhen me ndryshimet në sjellje dhe proceset njohëse të individëve.
Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.	Programi i studimit Master i Shkencave në “Psikologji” me profile “Psikologji Organizative”, “Psikologji Komunitare” dhe “Këshillim dhe Psikoterapi me Orientim Njohës Sjellor”, është në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të njësisë kryesore /bazë, e cila është përgjegjëse për ofrimin e këtij programi studimi. Departamenti i Psikologjisë dhe Sociologjisë është përgjegjës për ofrimin e programit të studimit Master i Shkencave dhe është në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të njësisë kryesore dhe asaj bazë. Ky Program studimit Msc ka një strukturë që përfshin 120 kredite ECTS dhe është i organizuar në 4 semestra, ofrohet në gjuhën shqipe dhe përfundon me dhënien e diplomës sipas profileve si Master i Shkencave ¹⁹ në “Psikologji” me profil “Psikologji Komunitare”, Master i Shkencave në “Psikologji” me profil “Organizative” dhe Master i Shkencave në “Psikologji” me profil “Këshillim dhe Psikoterapi me Orientim Njohës dhe Sjellor”, e cila regjistrohet në Rregjistrin Shtetëror të Diplomave dhe Çertifikatave për Arsimin e Lartë nga QSHA. Kjo marrje e diplomës varet nga drejtimi që merr studenti në varësi të specializimit në vit të dytë. Kështu, ky program studimi respekton kërkesat në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe është në përputhje me ligjet dhe udhëzimet vendore dhe europiane në ofrimin e programit të lidhje studimit në arsimin e lartë.
Konkluzione	<i>Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) ka vlerësuar se UMSH disponon dokumentacion dhe mekanizma të mjaftueshëm që rregullojnë veprimtarinë e institucionit dhe përgatitjen e personelit akademik për programin e studimit të ciklit të dytë.</i>
Shkalla e përmbushjes së	Nuk Përmbushet Përmbushet Përmbushet

¹⁹ Evidencë 45. Model diplome MSCP.

standardit	përmbyshet	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
				X

Standardi I.2

Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Institucioni duket se përgjithësisht ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e nevojshme për të ofruar një program studimi të specializuar në këtë fushë për një zhvillim profesional si në aspektin teorik dhe atë praktik. Kjo i jep mundësi studentëve që të jenë sa më konkurrues në tregun e punës. Megjithatë ka disa aspekte që duhen marrë në konsideratë kur gjykojmë këtë kriter. Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit, një pjesë e tyre janë të pajisur me tituj akademikë dhe grade shkencore në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi në vendin tonë²⁰. Duke iu referuar formimit të mirëfilltë në fushën e Psikologjisë Organizative (PO), Komunitare (PC), Këshillim dhe Psikoterapit me Orientim Njohës dhe Sjellor (PCP) mbështetur në CV-të e stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi përgjatë dy viteve akademike 2022-2024²¹ rezulton se përgjithësisht stafi i angazhuar në mësimdhënie në këtë Master, duhet theksuar se një pjesë e stafit është në linjë me profilet e kërkuara ndërsa një pjesë jo, nisur nga fakti që në këtë profil program studimi dalin tre drejtime në nivel masteri në fushën e psikologjisë Organizative (PO), Komunitare (PC), Këshillim dhe Psikoterapit me Orientim Njohës dhe Sjellor (PCP). Megjithatë, duhet theksuar se, megjithëse personeli akademik i angazhuar në këtë program ka tituj akademikë dhe grade shkencore, ekzistojnë sfida që lidhen me ndërlidhjen e tyre me fushën e psikologjisë dhe mësimdhënien bazuar në specialitetin e tyre. Kjo vlen për situatat kur stafi ka përvojë më të kufizuar në disiplinën e tre fushave të psikologjisë dhe mund të jetë më pak i kualifikuar për të mbështetur nevojat e specifikave të këtij programi studimor. <i>Për të lehtësuar këto sfida dhe për të siguruar një mësimdhënie sa më cilësore në procesin mësimor, rekomandohet që pedagogët e lëndëve në këtë program studimi me tre profile të anagazhohen</i>

²⁰ Evidencë 16. Përmbledhëse e tabelave të programit të studimit tabela nr.

²¹ Evidencë 14.3 Curriculum Vitae e stafit akademik të programit të studimit

	<i>në një staf më të përzgjedhur me njohuri dhe kopetenca bazuar në tipologjinë e lëndës mësimore që ato mbulojnë, psh lëndët në aspektin organizativ, apo klinik. Në këtë mënyrë, angazhimi i një stafi të përzgjedhur dhe të kualifikuar, së bashku me një qasje të strukturuar dhe të integruar të mësimdhënies, mund të kontribuojë ndjeshëm në përmirësimin e cilësisë së procesit mësimor dhe në zhvillimin profesional të studentëve në programet e psikologjisë.</i>
Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Programi i studimit të ciklit të dytë Msc. në “Psikologji” me rofile “Psikologji Organizative”, “Psikologji Komunitare” dhe “Këshillim dhe Psikoterapi me Orientim Njohës Sjellor”, është hartuar duke u bazuar mbi kuadrin ligjor në fuqi si dhe në përputhje me politikat e brendshme të institucionit dhe nevojave socio-ekonomike të vendit. Ky Master i Shkencave është i pajisur me një strukturë që përputhet me fushën akademike dhe kërkimore të njësisë kryesore/bazë, e cila është përgjegjëse për ofrimin e këtij programi studimi. Programi ka një strukturë të qartë, duke përfshirë 120 kredite ECTS të organizuara në 4 semestra. Ky program ofrohet në gjuhën shqipe dhe përfundon me dhënien e diplomës në tre Profile Master Shkencor me profile “Psikologji Organizative”, “Psikologji Komunitare” dhe “Këshillim dhe Psikoterapi me Orientim Njohës Sjellor”. Përveç kësaj, programi respekton kërkesat për përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe është në përputhje me ligjet dhe udhëzimet vendore dhe europiane që rregullojnë programe të studimit në arsimin e lartë ²² . Kjo përputhje është thelbësore për sigurimin e cilësisë së lartë të mësimdhënies dhe për përmbushjen e standardit të nevojshëm për këtë program studimi.
Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë	Njësia bazë, Departamenti i Psikologjisë dhe Sociologjisë, që ofron programin e studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Psikologji” me profile “Psikologji Organizative”, “Psikologji Komunitare” dhe “Këshillim dhe Psikoterapi me Orientim Njohës Sjellor”, ka një ecure koherente me vizionin dhe strategjinë afatgjatë të institucionit ²³ , Strategjisë e Ndërkombëtarizimit ²⁴ . Përputhja me fushën akademike dhe kërkimin shkencor është thelbësore për realizimin e qëllimeve të programit. Përveç kësaj, kjo përputhje me direktivat dhe udhëzimet kombëtare dhe europiane tregon angazhimin e njësisë kryesore dhe

²² Evidencë. 14. Plani mësimor, i Programit Master i Shkencave .

²³ Evidencë 4. Plani strategjik i Zhvillimit të UMSH .

²⁴ Evidencë. 23. Strategji e Ndërkombëtarizimit

bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	Departamentit të Psikologjisë dhe Sociologjisë e cila siguron që programi të mbështetet në njohuri të përditësuara dhe të qëndrueshme, duke mundësuar zhvillimin e aftësive dhe kompetencave të studentëve në përputhje me nevojat e tregut dhe kërkesat e shoqërisë, në ruajtjen e standardeve në arsimin e lartë. Ky aspekt siguron që njësia bazë të ketë mundësinë për rritjen dhe zhvillimin e burimeve njerëzore në mënyrë që të përmirësojë cilësinë e mësimdhënies dhe të përmbushë qëllimet e saj në arsimin e lartë. Kjo do të mundësojë që studentët të kenë mundësi të merren me projekte kërkimore, të aplikojnë metodologjitë shkencore dhe të zhvillojnë aftësi të forta analitike, të cilat janë thelbësore për praktikën profesionale. Për më tepër ky program studimi është në përputhje me statutin e institucionit²⁵ dhe rregulloren e tij të brendshme²⁶, të hartuar në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”²⁷; VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”²⁸ dhe Vendimi nr. 879 datë 18.12.2019²⁹ dhe VKM Nr.185, datë 25.03.2021³⁰. Kjo përputhje është e rëndësishme për sigurimin e qëndrueshmërisë dhe përmbushjen e detyrimeve ligjore për programin e studimit në UMSH.
Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit,	Ky kriter nuk përkon me këtë program studimi duke qënë se është Master i Shkencave.

²⁵ Evidencë 1. Statuti i UMSH.

²⁶ Evidencë 2. Rregullore e UMSH.

²⁷ Ligji Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Shqipëri” https://archive.org/stream/LIGJI802015PERARSIMINELARTEDHEKERKIMINSHKENCORFLETORJAEBOTIMEVEZYRTARE/LIGJI+80+2015+PER+ARSIMIN+E+LARTE+DHE+KERKIMIN+SHKENCOR+FLETORJA+E+BOTIMEVE+ZYRTARE_djvu.txt (Aksesuar më 07-07-2024).

²⁸ VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” <https://univlora.edu.al/ep-content/uploads/2018/02/VKM-nr.-41-date-24.1.2018.pdf> (Aksesuar më 07-07-2024).

²⁹ Vendimi nr. 879, datë 18.12.2019 i Këshillit të Ministrave. Disa Ndryshime dhe Shtesa në Vendimin Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” <https://docs.google.com/a/fshn.edu.al/viewer?a=v&pid=sites&srcid=ZnNobi5IZHUuYEx8ZnNobnxneDo3NzYxM2UeZEnhMEEIYjdi> (Aksesuar më 07-07-2024).

³⁰ Vendim Nr. 185, Datë 25.3.2021 Për Disa Ndryshime Dhe Shtesa Në Vendimin Nr. 41, Datë 24.1.2018, “Për Elementet E Programeve Të Studimit Të Ofuara Nga Institucionet E Arsimit Të Lartë”, Të Ndryshuar. <https://arsimi.gov.al/vendim-nr-185-date-25-3-2021-per-disa-ndryshime-dhe-shtesa-ne-vendimin-nr-41-date-24-1-2018-per-elementet-e-programeve-te-studimit-te-ofuara-nga-institucionet-e-arsimit-te-larte/> (Aksesuar më 07-07-2024).

cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.				
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtijshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	UMSH ka realizuar aktivitete ekstrakurrikulare ³¹ që u ofrohen studentëve të këtij programi studimi për të përmbushur nevojat të cilat janë të dizajnuara për të ofruar mundësi për zhvillimin personal dhe profesional të studentëve të programit të studimit në Psikologji. Këto aktivitete janë një komponent i rëndësishëm i përgatitjes akademike, duke ndihmuar studentët të përmbushin nevojat e tyre për aftësi praktike, zhvillimin e kompetencave ndërpersonale dhe ndërveprimet në një kontekst profesional.			
Konkluzione	<i>GVJ nisur nga shyrtime dokumentacionit dhe vizitës në institucion thekson se Departamenti i Psikologjisë dhe Sociologjisë, që ofron programin e studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në "Psikologji" me profile "Psikologji Organizative", "Psikologji Komunitare dhe "Këshillim dhe Psikoterapi me Orientim Njohës Sjellor", ka një ecure koherente me vizionin dhe strategjinë afatgjatë të institucionit dhe se përputhja me fushën akademike dhe kërkimin shkencor është thelbësore për realizimin e qëllimeve të programit.</i> <i>Gjithashtu GVJ sugjeron se institucioni duhet të ndërmarrë disa hapa të rëndësishëm. Këto hapa mund të përfshijnë përmirësimin e strukturës së elementëve të programit të studimit si Përmirësimi i Strukturës dhe Përmbajtjes së Programit duke qënë se është më tre profile duhen më shumë lëndë të profilit përkatës si dhe kualifikimin me profil specifik të pedagogëve. Angazhimi i Titullarëve "Profesor", "Profesor i Asociuar" për të garantuar cilësinë e lëndëve. Kjo do të ndihmojë në përmbushjen e detyrimit ligjor për sigurimin e një kornize akademike cilësore dhe në ruajtjen e standardeve të larta të mësimdhënie për të siguruar një kornizë akademike cilësore në programin e studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe

³¹ Evidencë 39. Plan programi i veprimtarive të departamentit , Viti akademik 2023-2024

mobilitetit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Universiteti Mesdhetar mbështetet në strategjinë e tij për të siguruar funksionimin dhe mbarëvajtjen sa më cilësore të të gjithë strukturave dhe hierarkisë sociale duke pasur si qëllim realizmin e një mësimdhënie sa më cilësore duke synuar garantimin e të gjithë procesit duke përfshirë njësitë akademike dhe ato me natyrë ndihmëse. Mbarëvajtja sa më bashkëpunuese dhe cilësore bazohet në disa komponentë si: Statuti i UMSH³² që bazohet në rregullat dhe strukturën themelore të tij, duke përcaktuar misionin, vizionin, dhe funksionimin e institucionit, Gjithashu për të mbarëvajtur punën sa më mirë institucioni garanton dhe rregullore si rregullorja e njësisë kryesore³³ dhe bazë për programin e studimit³⁴ duke ofruar udhëzime të nevojshme për të ndihmuar njësitë akademike në zbatimin e detyrave të personelit akademik dhe të atij ndihmës akademik; Rregullorja e programit të studimit³⁵ e cila ndihmon në përcaktimin dhe menaxhimin e procesit mësimor, përfshirë strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimit. të realizohet në përputhje me standardet më të larta dhe për të garantuar cilësinë e mësimdhënies. Të gjithë këto rregullator sigurojnë që institucioni të bazohet në një rregullore të qartë dhe të detajuar që rregullon të gjitha aspektet e aktivitetit akademik dhe administrativ. Në të njëjtën kohë, strukturat si sekretaria mësimore³⁶ dhe njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë³⁷ luajnë një rol të rëndësishëm në sigurimin e efikasitetit dhe cilësisë së shërbimeve akademike të ofruara nga Universiteti. Ato janë të integruara në mënyrë të ngushtë me proceset e përditshme akademike dhe administrative dhe kontribuojnë në ruajtjen e standardeve të larta për programet e studimit, duke ofruar mbështetje praktike dhe administrative për studentët dhe stafin akademik. Në gamën e gjërë të dokumentacionit shihet se ka dhe rregullore për studentët me aftësi ndryshe³⁸, rregullore e funksionimit të Këshillit

³² Evidencë.1. Statuti i UMSH.

³³ Evidencë 7. Rregullore e Fakultetit (DSHH).

³⁴ Evidencë 8 . Rregullore DPS.

³⁵ Evidencë 9.Rregullore e programit të Studimit Msc

³⁶ Evidencë 26. Rregullore e sekretarisë mësimore.

³⁷ Evidencë 18. Rregullore e organizimit dhe punës NJSBC të UMSH.

³⁸ Evidencë 20. Rregullore e aftësisë ndryshe

	studentor ³⁹ të cilat luajnë një rol të rëndësishëm në përmirësimin e cilësisë së jetës akademike dhe në mbështetje të një ambienti të barabartë dhe inkluziv.
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	Për realizimin e objektivave të procesit mësimor dhe formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me struktura të ndryshme, brenda dhe jashtë universitetit. Këto marrëdhënie janë të domosdoshme për të siguruar që procesi i mësimdhënies dhe zhvillimit të studentëve të jetë efikas dhe i përputhur me kërkesat e tregut të punës, nevojat shoqërore dhe standardet akademike. Si mobiliteti i studentëve dhe stafit: Bashkëpunimi me universitete dhe institucione akademike të tjera mundëson mundësi mobiliteti për studentët dhe stafin, duke ofruar mundësi shkëmbimi, pjesëmarrjeje në programe të përbashkëta dhe rritje të kapaciteteve akademike. Projekte të përbashkëta kërkimore: Marrëdhëniet me universitete të tjera mundësojnë zhvillimin e projekteve kërkimore ndërkombëtare dhe krijimin e mundësive për studentët të përfshihen në kërkime shkencore me nivel të lartë. Kjo ndihmon në zhvillimin e aftësive kërkimore të studentëve dhe rrit cilësinë e arsimit të ofruar. Përmes analizës së dokumentacionit të disponueshëm nga UMSH dhe takimeve të mbajtura me drejtuesit e njësive kryesore dhe bazë, si dhe duke u mbështetur në mendimet e studentëve, është evidentuar se institucioni ka marrëveshje institucionale në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar ⁴⁰ . Marrëdhëniet e bashkëpunimit të ndërtuara nga institucioni janë një faktor kyç për realizimin e objektivave të procesit mësimor dhe formues të studentëve. Ky bashkëpunim krijon mundësi për zhvillim të aftësive profesionale dhe sociale të studentëve, rrit cilësinë e mësimdhënies dhe kontribuon në përgatitjen e tyre për kërkesat e tregut të punës, duke mbështetur gjithashtu një mjedis akademik të shëndetshëm dhe inovativ.
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për	UMSH ka ndërmarë një sërë iniciativash të rëndësishme për të forcuar bashkëpunimin me institucione dhe organizata të ndryshme, si brenda vendit, ashtu edhe ndërkombëtarisht, në fushën e shkencave shoqërore, dhe më tej. Këto iniciativa kanë për qëllim të ofrojnë mundësi për zhvillimin akademik, kërkimor dhe profesional të studentëve dhe stafit akademik, duke kontribuar gjithashtu në përmirësimin e cilësisë së arsimit dhe

³⁹ Evidencë 37: Rregullore e funksionimit të Këshillit SStudentor

⁴⁰ Evidencë 10. Marrëveshje Bashkëpunimi UMSH

realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.	kërkimit shkencor. Disa prej këtyre nismave janë: në drejtim të bashkëpunimit me institucione dhe organizata në fushën e shkencave shoqërore dhe më tej⁴¹. Departamenti i Psikologjisë - Sociologjisë për programin e studimit të ciklit të dytë Master Shkencor në “Psikologji” me profile “Psikologji Organizative”, “Psikologji Komunitare” dhe “Këshillim dhe Psikoterapi me Orientim Njohës Sjellor”. Këto marrëveshje janë të orientuara për të siguruar një përvojë të pasur akademike, kërkimore dhe profesionale për të gjithë të përfshirët. Praktikë profesionale dhe internshipi në organizata dhe institucione: Marrëveshjet e bashkëpunimit me organizata profesionale, kompanitë, dhe institucionet e shëndetit mendor ofrojnë mundësi për studentët të realizojnë praktika profesionale në fusha të ndryshme të psikologjisë, si në psikologjinë organizative, psikologjinë komunitare dhe terapistë psikologjike. Kjo mundëson studentëve të zhvillojnë aftësi praktike, të fitojnë eksperiencë të vlefshme dhe të krijojnë lidhje me profesionistë të fushës. Internship në shërbime shëndetësore dhe komunitare: Për studentët e profilit të psikologjisë komunitare dhe këshillimit, mundësitë për internship ofrohen në klinika, spitale, institucione arsimore, dhe shërbime për individë dhe grupe me nevoja të veçanta. Kjo i ndihmon ata të bëjnë eksperiencë të drejtpërdrejtë në trajtimin e çështjeve sociale dhe psikologjike. Marrëveshjet bashkëpunuese të Departamentit të Psikologjisë-Sociologjisë me institucione të ndryshme, si universitete, organizata profesionale dhe institucione të shëndetit mendor, i ofrojnë studentëve të programit të ciklit të dytë Master Shkencor në “Psikologji” me profile “Psikologji Organizative”, “Psikologji Komunitare” dhe “Këshillim dhe Psikoterapi me Orientim Njohës Sjellor”, mundësi të pasura dhe të ndryshme për zhvillimin e aftësive profesionale, kërkimore dhe praktike. Këto mundësi përforcojnë përgatitjen e studentëve për karrierën e tyre të ardhshme dhe u mundësojnë atyre të lidhen me profesionistët dhe rrjetet ndërkombëtare të fushës së psikologjisë.
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga	Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike që vlerësojnë përfitimet dhe ndikimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit. Këto raporte janë të rëndësishme për të siguruar transparencën, monitorimin dhe përmirësimin e

⁴¹ Evidencë 36. Raporti Vjetor i Veprimtarisë Akademike të departamentit Psikologji-Sociologji 2022-2023

marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	vazhdueshëm të cilësisë akademike dhe të shërbimeve të ofruara nga universiteti. Monitorimi dhe vlerësimi i ecurisë së përgjithshme të programit të studimit të ciklit të dytë është një aspekt i rëndësishëm për sigurimin e cilësisë së programit. Universiteti dhe Departamenti DPS ka përgjegjësi për këtë proces monitorimi dhe ka zhvilluar mekanizma monitorues të veçantë për këtë qëllim. Në dokumentacionin e prezantuar, është theksuar që Departamenti i Psikologjisë-Sociologjisë ka dokumentuar rezultatet e programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Psikologji” me profile “Psikologji Organizative”, “Psikologji Komunitare” dhe “Këshillim dhe Psikoterapi me Orientim Njohës Sjellor”, të paraqitura si në Planin strategjik për zhvillimin e programit^{42, 43}. Gjithashtu, është i rëndësishëm mobiliteti i stafit dhe studentëve në nivel institucional duke përfshirë marrëveshjet e bashkëpunimit me institucione të tjera të arsimit të lartë. Për të bërë monitorimin e ecurisë së programit më efikas dhe për të siguruar cilësi të lartë në mësimdhënie, është e rëndësishme që institucioni të dokumentojë dhe raportojë me qartësi përmbushjen e objektivave të këtyre marrëveshjeve, duke përfshirë numrin e studentëve të përfshirë, përfitimet që ata kanë dhe impaktin që këto aktivitete kanë në zhvillimin e tyre profesional. <i>Përmes një monitorimi të hollësishëm dhe raportimit të qartë, institucioni mund të sigurojë që studentët të përfitojnë në mënyrë maksimale nga marrëveshjet e bashkëpunimit dhe që cilësia e programit të studimit të rritet.</i>			
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson se standardi përmbushet plotësisht, duke u bazuar në kriteret e përcaktuara. Institucioni i arsimit të lartë zhvillon marrëdhënie bashkëpunimi të suksesshme me institucione, kompani dhe aktorë të shërbimeve në përkrahjen e aftësimit profesional, kërkimit shkencor, dhe mobilitetit të stafit dhe studentëve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
--	--	-----------------------	----------------------	-----------------------

⁴² Evidencë 5. Planin strategjik për zhvillimin e programit.

⁴³ Evidencë 36. Raporti vjetor i departamentit Psikologji dhe Sociologji 2022-2023

				X
--	--	--	--	---

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1 Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Departamenti i Psikologjisë-Sociologjisë ka të përcaktuar në rregulloren e Programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Psikologji” me profile “Psikologji Organizative”, “Psikologji Komunitare” dhe “Këshillim dhe Psikoterapi me Orientim Njohës Sjellor”, ⁴⁴ përveç të tjerash edhe aspektet që lidhen me elementët përbërës të strukturës së programit si dhe funksionon bazuar në strukturën e Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Humane ku përgjegjësi i departamentit të Psikologjisë dhe Sociologjisë është autoriteti përgjegjës për këtë program studimi ⁴⁵ . Ky program studimi i ciklit të dytë Master i Shkencave në “Psikologji” me profile ⁴⁶ ; është hartuar bazuar në legjislacionin vendas siç janë: Ligji Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” ⁴⁷ ; VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” ⁴⁸ përgjithësisht duke respektuar ndarjen e lëndëve sipas formës së tyre, duke përfshirë lëndë të formimit bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore/integruese, plotësuese dhe detyrime përmbyllëse, por duhet të sigurohet që studentët të kenë një përvojë të pasur dhe të plotë në lëndët e tyre të specializimit ⁴⁹ . Veprimtaritë formuese të programit janë të formimit të

⁴⁴ Evidencë 9:Rregullore e Master Shkencor Kreu I, neni 1,

⁴⁵ Evidencë 9. Rregullore Master Shkencor Kreu II, neni 6

⁴⁶ Evidencë. 14 Plani mësimor, i Programit Master i Shkencor me Profile.

⁴⁷ Ligji Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Shqipëri” https://archive.org/stream/LIGJI802015PERARSIMINELARTEDHEKERKIMINSHKENCORFLETORJAEBOTIMEVEZYRTARE/LIGJI+80+2015+PER+ARSIMIN+E+LARTE+DHE+KERKIMIN+SHKENCOR+FLETORJA+E+BOTIMEVE+ZYRTARE_djvu.txt (Aksesuar më 09-07-2024).

⁴⁸ VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” <https://univlora.edu.al/ep-content/uploads/2018/02/VKM-nr.-41-date-24.1.2018.pdf> (Aksesuar më 09-07-2024).

⁴⁹ Evidencë 14.Plani mësimorë I programit Master I Shkencave ne Psikologji me Profile

përgjithshëm dhe atij karakterizues gjithsej (92 ECTS), praktikë profesionale (10 ECTS) dhe Teza e diplomës (18 ECTS)⁵⁰. Ky master ka në përbërje të tij 3 profile dhe për secilin prej tyre janë dhënë tabelat përshkruese:

Të dhënat përshkruese të komponentëve mësimorë sipas kategorive për Masterin Shkencor me profil “Psikologji Komunitare” (PC)

Kategoria	Përshkrimi	Sipas VKM 185, 2021	Sipas planit mësimor
A	Lëndë bazë	5–10 % (kredite)	8 % (kredite)
B	Lëndë karakterizuese	50–60 % (kredite)	62 % (kredite)
C	Lëndë ndërdisiplinore	12–20 % (kredite)	20 % (kredite)
D	Lëndë plotësuese	10 % (kredite)	12 % (kredite)
E	Detyrime përmbyllëse	10 – 15 % (kredite)	18 % (kredite)

Të dhëna përshkruese të komponentëve mësimorë sipas kategorive për Masterin Shkencor me profil “Psikologji Organizative” (PO)

Kategoria	Përshkrimi	Sipas VKM 185, 2021	Sipas planit mësimor
A	Lëndë bazë	5–10 % (kredite)	7 % (kredite)
B	Lëndë karakterizuese	50–60 % (kredite)	62 % (kredite)
C	Lëndë ndërdisiplinore	12–20 % (kredite)	20 % (kredite)

⁵⁰ Evidencë 9: Rregullore e programit Master Shkencor në Psikologji me “Profile” Kreu 1 neni 5

	D	Lëndë plotësuese	10 % (kredite)	12 % (kredite)
	E	Detyrime përmbyllëse	10 – 15 % (kredite)	18 % (kredite)
Të dhëna përshkruese të komponentëve mësimore sipas kategorive për Masterin Shkencor me profile “Psikologji Këshillim dhe Psikoterapi me Orientim Sjellor dhe Njohës” (PCP)				
	Kategoria	Përshkrimi	Sipas VKM 185, 2021	Sipas planit mësimor
	A	Lëndë bazë	5–10 % (kredite)	7 % (kredite)
	B	Lëndë karakterizuese	50–60 % (kredite)	62 % (kredite)
	C	Lëndë ndërdisiplinore	12–20 % (kredite)	20 % (kredite)
	D	Lëndë plotësuese	10 % (kredite)	12 % (kredite)
	E	Detyrime përmbyllëse	10 – 15 % (kredite)	18 % (kredite)
Referuar strukturës, kohëzgjatjes dhe peshës në kredite për semestër sipas planit mësimor 2022-2024⁵¹ janë elemente të rëndësishme që ndihmojnë në organizimin e mësimdhënies dhe në sigurimin e qëllimeve të programit të studimit. Sigurimi që programi ka një kohëzgjatje të përshtatshme dhe se kreditë janë të ndarë në mënyrë të balancuar për çdo semestër është një ndër përgjegjësitë e rëndësishme të departamentit për programin e studimit. Studentët në përfundim të studimeve në këtë program do të marrin një diplomë Master i Shkencave në “Psikologji” me profile “Psikologji Organizative”, “Psikologji Komunitare”, “Këshillim dhe Psikoterapi me Orientim Njohës Sjellor”. Siç shihet në planin mësimor kemi një luhatje të shpërndarjes së krediteve bazur sipas Sipas VKM 185, 2021, pikërisht në				

⁵¹ Evidencë 14. Plani mësimor Master i Shkencave në Psikologji me Profile (PO), (PC), (PCP)

	detyrimet përmbyllëse dhe lëndëve karakterizuese.
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale, jep njohuri të specialitetesh, jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuar në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Programi i studimit Master i Shkencave në “Psikologji” me profile “Psikologji Organizative”, “Psikologji Komunitare” dhe “Këshillim dhe Psikoterapi me Orientim Njohës Sjellor”, synon zhvillimin e aftësive të thelluara profesionale të studentët për vlerësimin dhe ndërhyrjen në fushën e shëndetit mendor, duke adresuar nevojat e individëve në grupe të ndryshme moshe. Ky program përgatit studentët për rolin e psikologut dhe ofron mundësinë e trajtimit të çështjeve të shëndetit mendor në kontekste të ndryshme, përfshirë ato organizative, komunitare dhe ato të individëve që kërkojnë mbështetje psikoterapeutike. Përmes këtij programi, studentët do të zhvillojnë njohuri dhe aftësi të thelluara për të diagnostikuar dhe adresuar çështje të shëndetit mendor, duke përdorur metoda të njohura dhe të bazuara në evidenca të psikoterapisë dhe këshillimit, dhe gjithashtu do të angazhohen në zhvillimin e politikave dhe ndërhyrjeve në nivele më të gjera sociale dhe organizative. Kjo përgatitje synon t’u mundësojë studentëve një kuptim të thelluar të aspekteve psikologjike dhe sociale që ndikojnë në mirëqenien e individëve dhe grupeve, duke i aftësuar ata për të punuar në mënyrë efektive dhe të përgjegjshme në fushën e shëndetit mendor. Kjo përfshin aftësinë për të trajtuar nevojat dhe sfidat e individëve në nivel individual, si dhe për të adresuar çështje më të gjera në nivel grupor dhe shoqëror, duke kontribuar në zhvillimin dhe përmirësimin e politikave dhe ndërhyrjeve që ndihmojnë në përmirësimin e shëndetit mendor dhe mirëqenies sociale. Hartimi i programit të studimit, syllabuseve të lëndëve, rregullores përkatëse e dokumenteve të tjera që e shoqërojnë atë, mbajnë parasysh parimet e përgjithshme të zhvillimit të arsimit të lartë e kërkimit shkencor në Republikën e Shqipërisë. Po ashtu, zgjerimi i mundësive profesionale për studentët është një aspekt i rëndësishëm i programit. Kjo i ndihmon ata të orientohen më lehtë në tregun e punës dhe t’u hapen mundësi më të shumta për zhvillimin e karrierës së tyre, përfshirë mundësitë për vetëpunësim. Programi ofron një gamë të gjerë mundësish për t’u angazhuar në fusha të ndryshme profesionale, duke i mundësuar studentëve të bëhen më të aftë dhe të përgatitur për sfidat e karrierës së tyre.

	Po ashtu, është thelbësore që stafi akademik ⁵² ; ⁵³ ; ⁵⁴ ; të disponojë njohuri të thella dhe përvojën e nevojshme në lëndët që mbulojnë, për të garantuar një mësimdhënie të standardeve të larta.
Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	Programi i studimit i ciklit të dytë Master i Shkencave në “Psikologji” me profile “Psikologji Organizative”, “Psikologji Komunitare” dhe “Këshillim dhe Psikoterapi me Orientim Njohës Sjellor”, respekton kriteret përsa i përket elementëve që përbëjnë strukturën e programeve të studimit, të ndara sipas kategorive të përcaktuara sipas Vendimi nr. 879 datë 18.12.2019 ⁵⁵ dhe VKM Nr.185, datë 25.03.2021 ⁵⁶ , duke përfshirë respektimin e numrin e krediteve dhe kohëzgjatjen e tij bazuar edhe në aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Nga shqyrtimi i dokumentacionit ⁵⁷ ; ⁵⁸ ; GVJ evidentoi se ky program studimi parashikon për realizimin e Praktikës Profesionale 12 ECTS duke dhënë peshë 10% ECTS dhe temës së diplomës 18 ECTS me peshë 5 % ECTS shihet se ka elementë në strukturën e shpërndarjes së krediteve dhe peshës së lëndëve që ndryshojnë konform Vendimit Nr. 185, Datë 25.3.2021, Për disa Ndryshime dhe Shtesa Në Vendimin Nr. 41, Datë 24.1.2018 dhe kjo është e dukshme në lëndët bazë ku sipas këtij vendimi pesha është 5-10 % ndërsa shihet se në strukturën e programit në shpërndarjen e lëndëve lënda bazë ka peshën 15-20% dhe një ndryshim të dukshëm është dhe në peshën e detyrimeve përmbyllëse (E) ⁵⁹ ku sipas vendimit Vendimitt Nr. 185, Datë 25.3.2021 Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 41, Datë 24.1.2018 është 3-5 %. <i>Pra duhet në këtë aspekt një rishikim i këtyre elementëve.</i>

⁵² Evidencë 14.3 Curriculum Vitae e stafit akademik te programit te studimit

⁵³ Evidencë. 14. Plani mësimor, i Programit Master i Shkencave në Psikologji me Profile.

⁵⁴ Evidencë 14.1. Plani mësimor Master i Shkencave në Psikologji me Profile i ndarë në veprimtare formuese (A-E).

⁵⁵ Vendimi nr. 879. datë 18.12.2019 i Këshillit të Ministrave. Disa Ndryshime dhe Shtesa në Vendimin Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”

<https://docs.google.com/a/fshn.edu.al/vicëer?a=v&pid=sites&srcid=ZnNobi5lZHUuYWx8ZnNobnxneDo3NzYxM2UëZËNhMËE1Yjdi> (Aksesuar më 09-07-2024).

⁵⁶ Vendim Nr. 185, Datë 25.3.2021 Për Disa Ndryshime Dhe Shtesa Në Vendimin Nr. 41, Datë 24.1.2018, “Për Elementet E Programeve Të Studimit Të Ofuara Nga Institucionet E Arsimit Të Lartë”, Të Ndryshuar.

<https://arsimi.gov.al/vendim-nr-185-date-25-3-2021-per-disa-ndryshime-dhe-shtesa-ne-vendimin-nr-41-date-24-1-2018-per-elementet-e-programeve-te-studimit-te-ofruara-nga-institucionet-e-arsimit-te-larte/> (Aksesuar më 09-07-2024).

⁵⁷ Evidencë 14. Plani mësimor, i Programit Master i Shkencave në Psikologji me Profile.

⁵⁸ Evidencë 14.1 . mësimore Master i Shkencave në Psikologji me Profile me veprimtari formuese (A-E).

⁵⁹ Evidencë 14.1 Plani mësimor Msc I ndarë sipas veprimtarive formuese (A-E) 2023-2024

	Si pjesë e kategorisë së Detyrimeve Përmbyllëse Tema e diplomës parashikon 120 orë punë individuale e pavarur e studentit dhe seanca konsultimi me udhëheqësin, ndërsa praktika profesionale si pjesë e kategorisë së Lëndëve Plotësuese përfshin 300 orë⁶⁰; ⁶¹; punë në institucionet me të cilat njësia ka marrëveshje bashkëpunimi për nevojat e realizimit të praktikës. Kjo kurrikul e Studimeve i mundëson studentit që të njihet me fushat e thelluara të studimit pasuniversitar, duke bërë të mundur një informim sa më profesional me shprehi konform profesionit dhe zhvillimin sa më profesional në zhvillimin akademik. <i>Sugjerohet një rishikim i planit mësimor 2022-2024 në llogaritjen e orëve sic është te diploma pasi shihet se në total orët janë 120 në punën individuale dhe konsultimit ndërkohë në total është dhënë 410 orë.</i>
Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.	Programi i studimit i ofruar nga Departamenti i Psikologjisë-Sociologjisë ka në përmbajtjen e tij lëndë module që synojnë të japin njohuri dhe të zhvillojnë kompetenca në linjë me profilin përkatës. Duke iu referuar këtij profili ka një përputhje midis komponentëve kryesorë që e përbëjnë atë si në strukturë, përmbajtje dhe emërtimin e programit të studimit duke u përjekur për të qenë përgjithësisht konform edhe fushës së kompetencave profesionale të programit. Bazuar në ndarjen e lëndëve mësimore që e përbëjnë këtë program studimi të tipit të komponentëve mësimorë sipas ndarjes në kategoritë përkatëse. Përgjithësisht lëndët në këtë program studimi janë të bazuara në një kategori të përbashkët lëndësh dhe më pas një profil si në aspektin Organizativ, Komunitar, si dhe Këshillim dhe Psikoterapi me Orientim Njohës Sjellor”, duke zënë një peshë të konsiderueshme edhe pse profilet përkatëse duhet të kenë më shumë lëndë të profilit ku psh në psikologjinë Organizative shihen shumë pak lëndë të profilit përgjithësisht 2.
Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të	Programi i studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Psikologji” me profil si në aspektin Organizativ, Komunitar, si dhe Këshillim dhe Psikoterapi me Orientim Njohës Sjellor” është organizuar në formën e studimeve me kohë të plotë⁶², me kohëzgjatje 2 vite akademike dhe studentët duhet të kenë

⁶⁰ Evidencë 14. Plani mësimor, i Programit Master i Shkencave “Psikologji me Profile.

⁶¹ Evidencë 14.1 3.03. Plani mësimor Master i Shkencave në Psikologji me Profile me veprimtari formuese.

⁶² Eivendë 9. Rregullore e programit Msc

krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.	grumbulluar 120 ECTS në përfundim të studimeve që të mund të fitojnë një diplomë Master i Shkencave në “Psikologji” me profile “Psikologji Organizative”, “Psikologji Komunitare” dhe “Këshillim dhe Psikoterapi me Orientim Njohës Sjellor”. Programi i studimit është i organizuar në module dhe të vlerësuar në kredite (ECTS). Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara nga studenti me kohë të plotë përgjatë një viti akademik është 60 ECTS. Tërësia e veprimtarive formuese gjendet e shprehur në Planin Mësimor⁶³, i cili është dokumenti themelor i programit të studimit. Plani mësimor përbën dokumentacionin kryesor me karakter informativ, në të cilin parashtrihen në mënyrë të detajuar objektivat, përmbajtja, metodat dhe teknikat e mësimdhënies, si dhe mënyra e vlerësimit të studentëve. Ky plan ofron një udhëzues të qartë për zhvillimin e mësimeve dhe sigurimin e cilësisë në procesin edukativ, duke përcaktuar gjithashtu kohën e nevojshme për çdo aktivitet dhe rëndësinë e lëndëve të ndryshme brenda programit. Plani mësimor është një mjet kyç për organizimin dhe planifikimin e procesit mësimor, duke garantuar koherencën dhe efikasitetin e mësimdhënies dhe të nxënies. Ky plan përbën dokumentacionin kryesor me karakter të gjerë informativ, duke specifikuar emërtimin e programit të studimit, objektivat formuese, kohëzgjatja normale e studimeve, tërësia e veprimtarive formuese (disiplinave) që përbëjnë programin e studimit, të grupuara nëpër semestra dhe të renditura sipas semestrave, kreditet për çdo veprimtari formuese, shpërndarjen e krediteve brenda një disipline sipas aktiviteteve formuese të saj (leksione/ seminare/ laboratorë/ detyra/ projekte, etj), ngarkesa në auditor, ngarkesa javore në auditor, karakteristikat e tezës së diplomës.
Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në	Pranimi i kandidatëve në programin e studimi të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Psikologji” me profile “Psikologji Organizative”, “Psikologji Komunitare” dhe “Këshillim dhe Psikoterapi me Orientim Njohës Sjellor”, bëhet në përputhje me përcaktimet e legjislacionit në fuqi dhe në Statutin e UMSH. Miratimi i kuotave të pranimit për çdo program studimi bëhet me vendim senatit sipas udhëzimeve përkatëse të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, ku kriteri i pranimit për aplikim përcaktohen nga vet institucioni konform bazës ligjore në fuqi, përcaktuar me

⁶³ Evidencë 14. . Plani mësimor, i Programit Master i Shkencave në Psikologji me Profile

kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	vendimin të Këshillit të Ministrave sipas vitit përkatës. Bazuar në rregulloren e programit të studimit ⁶⁴ ⁶⁵ për programin e ciklit të dytë Master Shkencave në “Psikologji” me profile, njësia bazë ka shpallur kriteret e mëposhtme. Pranimi në ciklin e dytë të studimeve Master Shkencave në “Psikologji” me profile, studentët të cilët plotësojnë kriteret e mëposhtme: 1. Të kenë mbaruar ciklin e parë të studimeve Bachelor tre ose katër vjeçar në një nga degën e psikologjisë; 2. Pranohen gjithashtu të gjithë studentët të cilët kanë fituar një diplomë të nivelit të parë të përafërt; 3. Studentët të cilët kanë mbaruar studimin jashtë vendit duhet të kenë përfunduar procesin e njehsimit të diplomës pranë MASR dhe të kenë dëshminë përkatëse; 4. Të këtë njohje në një nga gjuhët e huaja të Bashkimit European anglisht, gjermanisht, frengjisht, italisht , spanisht (të nivelit B1) 5. Aplikuesit që janë diplomuar jashtë vendit në një program studimi të ciklit të parë, të akredituar. Në rast pranimi, kandidatin është i detyruar të kryejë njehsimin e diplomës pranë MASR-it brenda afateve kohore të legjislacionit në fuqi;
Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtësë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Lëndët në këtë program studimi kanë ngjashmëri edhe me programet e tjera në universitete brenda dhe jashtë vendit. Kjo krijon më shumë mundësi për transferime apo mobilitet të studentëve. Nga vizitat në Institucion, GVB deklaroi se program i studimit Msc me disa profile ofrohet vetëm nga UMSH. Edhe nga kërkimi i Gvj rezulton se program i studimit të ciklit të dytë “Master i Shkencave” me profile nuk ka ngjashmëri në emërtësë me ndonjë UMSH është në linjë me bazën ligjore në fuqi në lidhje me aplikimin për regjistrimin e formës së diplomës për programin e studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Psikologji” me profile “Psikologji Organizative”, “Psikologji Komunitare” dhe “Këshillim dhe Psikoterapi me Orientim Njohës Sjellor”, kohë të plotë me kodin përkatës me fushën e klasifikimit me numrin e tij unik. Ky proces i cili ka nisur nga UMSH përfshin regjistrimin e programit të studimit në regjistrin shtetëror të diplomave dhe
Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të	UMSH është në linjë me bazën ligjore në fuqi në lidhje me aplikimin për regjistrimin e formës së diplomës për programin e studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Psikologji” me profile “Psikologji Organizative”, “Psikologji Komunitare” dhe “Këshillim dhe Psikoterapi me Orientim Njohës Sjellor”, kohë të plotë me kodin përkatës me fushën e klasifikimit me numrin e tij unik. Ky proces i cili ka nisur nga UMSH përfshin regjistrimin e programit të studimit në regjistrin shtetëror të diplomave dhe

⁶⁴ Evidencë 9. Rregullore e programit Msc. KREU III

⁶⁵ Evidencë 2.Rregullore e Organizmit UMSH, KREU VII, neni 52

programit.	çertifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor. Në këtë proces, çdo program studimi identifikohet me një numër unik identifikimi të lëshuar nga Qendra e Shërbimeve Arsimore pranë Ministrisë së Arsimit. Bazuar në përcaktimin e komponentëve që përbëjnë planin mësimor të programit të studimit, kjo është një masë e rëndësishme administrative që ndihmon në identifikimin e lëndëve mësimore në programin e studimit dhe në sigurimin e qëndrueshmërisë së regjistrave dhe dokumentacionit arsimor. Bazuar në Udhëzimin Nr. 31, datë 15.11.2022 për “Procedurat për kodifikimin e programeve të studimit të ofruara institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, pika 12 theksohet se: “Për programet e studimit ekzistuese të studimit, institucionet e arsimit të lartë duhet të dërgojnë zyrtarisht në ministrinë përgjegjëse për arsimin, propozimet e tyre”. Nga shqyrtimi dokumentacionit⁶⁹⁷⁰⁷¹ vihet re që programet janë të gjitha sipas kodeve përkatëse. Këto hapa të zbatuara në përputhje me procedurat dhe rregullat ligjore tregojnë se UMSH ka vepruar në përputhje me ligjin dhe aplikuar për të siguruar dokumentacionin e nevojshëm për programin.
Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Duke iu referuar programit të studimit Master i Shkencave në “Psikologji” me profile “Psikologji Organizative”, “Psikologji Komunitare” dhe “Këshillim dhe Psikoterapi me Orientim Njohës Sjellor”, i ofruar nga Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë është një program i ciklit të dytë me një kohëzgjatje prej 2 vjetësh. Ky program nuk është i zhvilluar në bashkëpunim me ndonjë institucion tjetër të arsimit të lartë vendas ose të huaj. UMSH e mbulon këtë program studimi me burimet njerëzore dhe financiare të veta, në përputhje me rregullat dhe udhëzimet përkatëse të aplikueshme në vend.
Konkluzione	<i>Bazuar në sa më sipër, GVJ konkludon se programi i studimit organizohet me përputhje të plotë me parashikimet ligjore dhe nënligjore kombëtare, si dhe me aktet e brendshme rregullative. Pra programi i studimit i ofruar nga Departamenti i Psikologjisë-Sociologjisë ka në përmbajtjen e tij lëndë module që synojnë të</i>

⁶⁶ Evidencë 14. Plani mësimor, i Programit Master i Shkencave në Psikologji me Profile.

⁶⁷ Evidencë 14. Plani mësimor Master i Shkencave në Psikologji me Profile me ndarje të veprimtarisë (A-E).

⁶⁹ Evidencë 16: Tabela nr.11 Ascal, Plani mësimor fq.15

⁷⁰ Evidencë 16 :Tabela Ascal ,Plani mësimor bazuar në Veprimtaritë formuese Tabela nr.9;fq.9

⁷¹ Evidencë 14: Plani mësimor

	japin njohuri dhe të zhvillojnë kompetenca në linjë me profilin përkatës. Duke iu referuar këtij profili ka një përputhje midis komponentëve kryesorë që e përbëjnë atë si në strukturë, përmbajtje dhe emërtimin e programit të studimit duke u përjekur për të qenë përgjithësisht konform edhe fushës së kompetencave profesionale të programit. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vlerëson se ky standard përmbushet kryesisht dëshmuar nga zbatimi korrekt dhe në përputhje me kriteret e përcaktuara mbi hartimin e programit mesimor ku sugjerohet një rishikim i planit mesimor 2022-2024 në llogaritjen e orëve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Humane si njësi kryesore e organizuar sipas ligjeve për organizimin akademik dhe administrative të institucioneve të arsimit të lartë në UMSH ka si pjesë të saj njësinë bazë përgjegjëse, Departamentin e Psikologjisë-Sociologjisë. Mësohet nga takimi me përgjegjësen e departamentit dhe anëtarë të departamentit se njësia bazë ngre grupin e cilësisë në nivel departamenti dhe grupin e vlerësimit të brendshëm për këtë program studimi sipas detyrimeve ligjore për funksionimin normal të tij, si dhe në linjë me statutin⁷² dhe rregulloren e institucionit⁷³. Kjo njësi përmbush kushtet për vijimin e procesit të vlerësimit dhe akreditimit për këtë program studimi, referuar ndjekjes së procedurës pranë ASCAL konform Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në përputhje me Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit.

⁷² Evidencë 1. Statuti UMSH

⁷³ Evidencë 9. Rregullore e programit Msc.

Njësia kryesore që ofron këtë program studimi është Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Humane⁷⁴; ⁷⁵; për vitin akademik 2023-2024⁷⁶, ka 65 personel akademik gjithsej, ku 50 pedagogë janë me kohë të plotë dhe 15 pedagogë me kohë të pjesshme, ndërsa për vitin akademik 2022-2023⁷⁷ ka 67 personel akademik gjithsej, 51 pedagogë me kohë të plotë dhe 16 pedagogë me kohë të pjesshme.

Të dhënat e stafit akademik të Departamentit të Psikologjisë dhe Sociologjisë, sipas kualifikimit sipas viteve 2022-2023; 2023-2024 ⁷⁸, janë si më poshtë:

Departamenti i Psikologjisë dhe Sociologjisë	2023-2024		2022-2023	
	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof. Dr.	-	0	-	-
Prof. Asoc. Dr.	3	1	3	2
Dr./ Phd.	5	2	6	1
MSc.	2		2	1
Total	10	3	11	4

Njësia bazë ka ngritur grupin e vlerësimit të brendshëm⁷⁹ për këtë program studimi sipas detyrimeve ligjore për funksionimin normal të tij, si dhe në linjë me statutin dhe rregulloren e institucionit. Kjo njësi përmbush kushtet për vijimin e procesit të vlerësimit dhe akreditimit për këtë program studimi, referuar ndjekjes së procedurës pranë ASCAL konform Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", si dhe në përputhje me Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2018⁸⁰.

⁷⁴ Evidencë 14.3 Curriculum Vitae e stafit akademik të programit të studimit

⁷⁵ Evidencë 14. Plani mësimor, i Programit Master i Shkencave në Psikologji me Profile.

⁷⁶ Evidencë 16. Të dhëna tabelore ASCAL nr.1

⁷⁷ Evidencë 16. Të dhëna tabelore ASCAL nr.2

⁷⁸ Evidencë 16. Të dhënat tabelore për personelin akademik në programin e studimit nr.7 fq.9

⁷⁹ Evidencë 18. Rregullore e organizimit dhe funksionimit dhe punës së Vlerësimit të Brendshëm.

⁸⁰ Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (2017). Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit.

Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	Programi i studimit Master i Shkencave në “Psikologji” me profile “Psikologji Organizative”, “Psikologji Komunitare” dhe “Këshillim dhe Psikoterapi me Orientim Njohës Sjellor”, ofruar nga Departamenti i Psikologjisë dhe Sociologjisë në planin e tij mësimor ka të përcaktuar zhvillimin e praktikës institucionale të emërtuar Praktikë. Njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel akademik efektiv për realizimin e praktikave institucionale. Praktikë institucionale janë të rregulluara gjithashtu përmes marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione që operojnë në fushën përkatëse dhe kontribuojnë në zhvillimin e programit të studimit. Vlerësimi i praktikës bazohet në disa elemente, ku së pari kërkohet që studenti të frekuentojë praktikën, pasi ajo konsiderohet si lëndë e detyrueshme. Vlerësimi kryhet mbi bazën e raportit të praktikës që studenti paraqet para komisionit, i cili shqyrton përmbajtjen dhe cilësinë e punës së kryer gjatë periudhës së praktikës. Vlerësimi i praktikës bëhet me notë, e cila reflekton performancën dhe angazhimin e studentit gjatë kësaj periudhe. GVJ gjatë vizitës në institucion dhe bisedës me studentët e stafin akademik, u vu re realizimi i praktikave në mënyrë profesionale dhe të supervizuara nga pedagogë të kualifikuar dhe të licencuar në profesionin e Psikologut. Kjo mundëson që njohuritë e fituara në mënyrë teorike të zhvillohen dhe aplikohen në praktikë në mënyrë profesionale, duke krijuar mundësinë për një integrim të suksesshëm të teorisë dhe praktikës për studentët. Ky proces kontribuon në përgatitjen e tyre të plotë për sfidat e profesionit dhe në zhvillimin e aftësive të nevojshme për t'u angazhuar në fushën e psikologjisë.
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe	Njësia bazë që e ofron programin e studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Psikologji” me profile, është Departamenti Psikologjisë-Sociologjisë, i cili është pjesë e Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave . Bazuar në procedurat e organizimit, njësia kryesore përgjegjëse për këtë program studimi në zbatim të VKM 531, datë 11.09.2018 “Për miratimin e Kodit të Cilësisë të Arsimit të Lartë” sipas propozimit të përgjegjësit të Departamentit duhet të miratohet një kordinator. Referuar ngarkesës që ka përgjegjësi departamentit për të

<https://ëëë.asc.al/media/documents/publikime/Manual%20afatet%20e%20akreditimit%20IAL%20dhe%20programet%202017.pdf> (Aksesuar më 09.07.2024).

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	drejtuar dhe bashkërenduar veprimtarinë e kërkimit në aspektin shkencor përzgjidhet një kordinator⁸¹ i cili duhet të ketë gradën Doktor ose të jetë në process doktorature. Kordinatori propozohet nga njësia bazë dhe miratohet nga dekani. Në realizimin e detyrave të tij ai bashkëpunon dhe me kordinatorë të njësive të tjera bazë. Në dokumentat e vëna në dispozicion si dhe në rregulloren e programit nuk shihen kritere dhe mirëpërcaktim të punës së kordinatorit si dhe vendim të përcaktimit të kordinatorit të programit. Edhe pse vihet re në këtë rregullore në nënin 7. KREU II⁸² “Struktura Organizative” është e përaktuar funksioni i kordinatorit të Programit Master në nivel Fakulteti por jo specifikisht në programin e studimit Master i Shkencave në “Psikologji” me profile “Psikologji Organizative”, “Psikologji Komunitare” dhe “Këshillim dhe Psikoterapi me Orientim Njohës Sjellor”. <i>GVJ rekomandon, që në cilësinë e kordinatorit të programit të studimit i cili është i mirëpërcaktuar për lehtësimin e punës së kërkimit shkencor të njësisë bazë në Rregulloren e departamentit, u vu re që nuk kishte specifikim të detyrave dhe përgjegjësisë së kordinatorit të programit.</i> Koordinatori i programit referuar informacioneve të marra gjatë vizitës në institucion realizohet në vijimësi përmes një sërë formash për koordinimin e veprimtarisë mësimore dhe kujdesin në përgatitjen e procesit mësimorë dhe etiketimi tij është Tutor, dhe raportin në mënyrë periodike të drejtuesi i njësisë përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit.
Konkluzione	<i>Në konkluzion, njësia kryesore/bazë për programin e studimit demonstroi përmbushjen e kërkesave ligjore dhe standardeve të cilësisë. GVJ, bazuar në informacionet e paraqitura në këtë standard, vlerëson se kriteret ligjore janë përgjithësisht në përputhje me direktivat e manualit të sigurimit të cilësisë dhe Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”⁸³.</i>

⁸¹ Evidencë 8:Rregullore e departamentit neni 13

⁸² Evidencë 9.Rregullore e programit të Studimit Msc në Psikologji me Profile

⁸³Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Shqipëri”




	<i>Për sa më sipër ky standart përmbushet plotësisht por theksohet ne vazhdimësi dhe hartimi i nje dokumentacion sic hartimi i nje vendimi mbi kete pozicion.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Mbështetur në shqyrtimin e dokumentacionit institucional nga GVJ, rezulton se njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë disponon informacionin e nevojshëm për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit. Struktura dhe përmbajtja e programit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Psikologji” me profile, të ofruar nga UMSH mbështetet në 4 dokumente kryesore që janë: a) Plani mësimorë i programit të studimit^{84, 85} b) Syllabuset e lëndëve mësimore etj⁸⁶ c) Rregullorja e programit të studimit d) Strategjia e zhvillimit të programit të studimit Msc në Psikologji me profile⁸⁷ Nga takimet me dekanin e institucionit, përgjegjësen e departamentit apo zyra e ndihmës akademike, mësohet se protokollat e institucionit dhe burimet njerëzore e materiale në funksion të organizimit të këtij programi studimi duket se i japin mundësi institucionit të avancojë në drejtim të realizimit të tij konform rregullave që i lejojnë funksionimin normal, në përputhje me statutin e tij të brendshëm⁸⁸, rregulloren e UMSH⁸⁹ e hartuar

https://archive.org/stream/LIGJI802015PERARSIMINELARTEDHEKERKIMINSHKENCORFLETORJAEBOTIMEVEZYRTARE/LIGJI+80+2015+PER+ARSIMIN+E+LARTE+DHE+KERKIMIN+SHKENCOR+FLETORJA+E+BOTIMEVE+ZYRTARE_djvu.txt (Aksesuar më 07-07-2024).

⁸⁴ Evidencë 14. Plani mësimor, i Programit Master i Shkencave “Psikologji me Profile .

⁸⁵ Evidencë 14.1 Plani mësimor Master i Shkencave në Psikologji me Profile me veprimtari formuese.

⁸⁶ Evidencë 14.2. Syllabuse të lëndëve mësimore Msc në Psikologji me Profile

⁸⁷ Evidencë 5. Strategjia e zhvillimit të programit të Studimit Msc në Psikologji me Profile

⁸⁸ Evidencë 1. Statuti i UMSH.

⁸⁹ Evidencë 2. Rregullore e UMSH”.

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

	në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” ⁹⁰ ; VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” ⁹¹ dhe Vendimi nr. 879 datë 18.12.2019 ⁹² . Kjo është evidentuar edhe në Rregulloren e njësisë kryesore ⁹³ dhe bazë ⁹⁴ , si dhe atë të programit të studimit.
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Bazuar në planin mësimor të programit të studimit ⁹⁵ ; ⁹⁶ ; rezulton se kurrikula e programit të studimit është e organizuar në lëndë, module, praktika, laboratore, orë të studimit individual, projekte etj, të cilat janë të shtrira në 2 vite akademike dhe të ndara në 2 semestra për çdo vit akademik. Përqindjet sipas tipologjive të lëndëve mësimore të përlllogaritura bazuar në Planin mësimor 2022-2023, të cilat krahasur me përcaktimet në VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” ⁹⁷ dhe Vendimin nr. 879 datë 18.12.2019 ⁹⁸ , Vendimin Nr. 185, datë 25.03.2021 ⁹⁹ , janë konform tyre.

⁹⁰ Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Shqipëri”

https://archive.org/stream/LIGJI802015PERARSIMINELARTEDHEKERKIMINSHKENCORFLETORJAEBOTIMEVEZYRTARE/LIGJI+80+2015+PER+ARSIMIN+E+LARTE+DHE+KERKIMIN+SHKENCOR+FLETORJA+E+BOTIMEVE+ZYRTARE_djvu.txt (Aksesuar më 09-07-2024).

⁹¹ VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”<https://univlora.edu.al/ep-content/uploads/2018/02/VKM-nr.-41-date-24.1.2018.pdf> (Aksesuar më 09-07-2024).

⁹² Vendimi nr. 879, datë 18.12.2019 i Këshillit të Ministrave. Disa Ndryshime dhe Shtesa në Vendimin Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”

<https://docs.google.com/a/fshn.edu.al/viewer?a=v&pid=sites&srcid=ZnNobi5lZHUUyE8ZnNobnxneDo3NzYxM2UeZEHhMEE1Yjdi> (Aksesuar më 09-07-2024).

⁹³ Evidencë 7. Rregullore e Fakultetit (DSHH).

⁹⁴ Evidencë . 8. Rregullore Departamentit Psikologji-Sociologji

⁹⁵ Evidencë 14 Plani mësimor, i Programit Master i Shkencave “Psikologji me Profile.

⁹⁶ Evidencë 14.1 Plani mësimor i ndarë në veprimtari formuese mësimore Master i Shkencave në Psikologji me Profile

⁹⁷ VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”<https://univlora.edu.al/ep-content/uploads/2018/02/VKM-nr.-41-date-24.1.2018.pdf> (Aksesuar më 09-07-2024).

⁹⁸ Vendimi nr. 879, datë 18.12.2019 i Këshillit të Ministrave. Disa Ndryshime dhe Shtesa në Vendimin Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”<https://docs.google.com/a/fshn.edu.al/viewer?a=v&pid=sites&srcid=ZnNobi5lZHUUyE8ZnNobnxneDo3NzYxM2UeZEHhMEE1Yjdi> (Aksesuar më 09-07-2024).

⁹⁹ Vendimin Nr. 185, datë 25.03.2021. Për Disa Ndryshime dhe Shtesa në Vendimin Nr.41, Datë 24.1.2018, "Për Elementët e Programeve të Studimit Të Ofuara nga Institucionet e Arsimit të Lartë", Të Ndryshuar.
<https://arsimi.gov.al/vendim-nr-185-date-25-3-2021-per-disa-ndryshime-dhe-shtesa-ne-vendimin-nr-41-date-24-1->

Të dhënat tabelore për kategorizimin e lëndëve mësimore në Msc “Psikologji” me profile Psikologji Organizative, Psikologji Komunitare, Këshillim dhe Psikoterapi me Orientim Njohës dhe Sjellor, janë si më poshtë:			
Kategori	Përshkrimi	Sipas VKM 185, 2021	Sipas planit mësimor
A	Lëndë bazë	5-10 % (kredite)	8 % (kredite)
B	Lëndë karakterizuese	50-60 % (kredite)	62 % (kredite)
C	Lëndë ndërdisiplinore	12-20 % (kredite)	20 % (kredite)
D	Lëndë plotësuese	10 % (kredite)	12 % (kredite)
E	Detyrime përmbyllëse	10-15 % (kredite)	18 % (kredite)
Programi i studimit është i organizuar në module dhe të vlerësuar në kredite (ECTS) duke respektuar ndarjen e veprimtarive formuese sipas tipit të komponentëve mësimor në kategoritë e lëndëve bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore/ integruese, lëndë plotësuese (praktika) dhe detyrime përmbyllëse.			
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Universiteti Mesdhetar nëpërmjet dokumentacionit që shoqëron bazën materiale të këtij programi studimi siç janë Rregullorja e Programit ¹⁰⁰ , Rregullore e Organizimit të UMSH ¹⁰¹ , Rregulloren e studentëve me aftësi ndryshe ¹⁰² etj, përshkruan procedurat e procesit të rekrutimit, aplikimit, regjistrimit, transferimit ¹⁰³ dhe për aplikantët për një program të dytë studimi. Të gjitha procedurat që lidhen me këtë proces realizohen përmes Zyrës së sekretarisë mësimore ¹⁰⁴ .		

2018-per-elementet-e-programeve-te-studimit-te-ofruara-nga-institucionet-e-arsimit-te-larte/. (Aksesuar më 09-07-2024).

¹⁰⁰ Vizita dyditore në IAL dhe dokumentacioni. Rregullore e programit të studimit Master Shkencor në “Psikologji me Profile”

¹⁰¹ Evidencë 2. Rregullore e Organizimit UMSH

¹⁰² Evidencë 20. Rregullore e Studentëve me Aftësi Ndryshe

¹⁰³ Evidencë 2. Rregullore e Organizimit UMSH, neni 70

¹⁰⁴ Evidencë 26. Rregullore e sekretarisë mësimore.

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. “Q. Stafa”, Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

35

Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Programi i studimit ciklit të dytë Master i Shkencave në “Psikologji” me profile, është program studimesh i organizuar në lëndë dhe vlerësuar me kredite sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të krediteve ECTS. Bazuar në Planit Mësimor¹⁰⁵; ¹⁰⁶ të programit të studimit dëshmohet se komponentët mësimorë (lëndët/modulet) janë klasifikuar dhe vlerësuar me kredite, sipas sistemit vendas e evropian, të ndara në dy vite dhe dy semestra për çdo vit akademik. Ky program studimi ka një informacion të detajuar konform rregullave në fuqi ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve, kreditet dhe ndarjen sipas semestrave akademike edhe në syllabuset e lëndëve mësimore etj. Në funksion të këtij procesi është dhe rregullorja e këtij program studimi¹⁰⁷, në të cilën specifikohen rregullat e frekuentimit të procesit mësimor dhe mënyrat e kontrollit dhe vlerësimit të dijeve. Nga kjo pikëpamje, programi i studimit i marrë në vlerësim rezultoi në përputhje me VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”¹⁰⁸ dhe Vendimi nr. 879 datë 18.12.2019¹⁰⁹, Vendimin Nr. 185, datë 25.03.2021¹¹⁰.
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen	Mbështetur në procedurat që ndjek institucioni në drejtim të përmirësimit të programit të studimit kemi një informacion me të dhëna që rregullojnë punën në drejtim të hartimit të syllabuseve të lëndëve sipas ligjeve shtetërore dhe sipas formatit të miratuar nga MASR dhe i njëjti drejtim ndiqet edhe nga rregullorja mësimore e programit të studimit, e cila përcakton parimet e përgjithshme për

¹⁰⁵ Evidencë 14. Plani mësimor, i Programit Master i Shkencave “Psikologji” me Profile.

¹⁰⁶ Evidencë 14. Plani mësimor Msc në Psikologji me Profile të ndarë në veprimtari formuese (A-E)

¹⁰⁷ Vizita dyditore në IAL dhe dokumentacioni Rregullorë e programit të studimit Master Shkencor në “Psikologji me Profile”

¹⁰⁸ VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” <https://univlora.edu.al/ep-content/uploads/2018/02/VKM-nr.-41-date-24.1.2018.pdf> (Aksesuar më 09-07-2024).

¹⁰⁹ Vendimi nr. 879, datë 18.12.2019 i Këshillit të Ministrave. Disa Ndryshime dhe Shtesa në Vendimin Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”

<https://docs.google.com/a/fshn.edu.al/viccer?a=v&pid=sites&srcid=ZnNobiSlZHUuYEx8ZnNobnxneDo3NzYxM2UeZEnhMEE1Yjdi> (Aksesuar më 09-07-2024).

¹¹⁰ Vendimin Nr. 185, datë 25.03.2021. Për Disa Ndryshime dhe Shtesa në Vendimin Nr.41, Datë 24.1.2018, “Për Elementët e Programeve të Studimit Të Ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, Të Ndryshuar. <https://arsimi.gov.al/vendim-nr-185-date-25-3-2021-per-disa-ndryshime-dhe-shtesa-ne-vendimin-nr-41-date-24-1-2018-per-elementet-e-programeve-te-studimit-te-ofruara-nga-institucionet-e-arsimit-te-larte/>. (Aksesuar më 09-07-2024).

ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.	këtë program studimi. Përmbajtja e programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Psikologji” me profile, duket se është objekt monitorimi nga njësia bazë lidhur me përmirësimin e vazhdueshëm në drejtim të planeve mësimore çdo vit akademik dhe miratimit të tyre nga njësia bazë, me qëllim përmirësimin e cilësisë në mësimdhënie.			
Konkluzione	<i>Në konkluzion, programi i studimit paraqitet i detajuar, informues, i strukturuar dhe i organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të ciklit të dytë. GVJ, duke u bazuar në vlerësimin e kriterëve për secilin aspekt, konkludon se ky standard përmbushet plotësisht, dëshmuar nga niveli i përshtatshëm i informacionit për çdo kriter të përcaktuar.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Emërtimi, struktura e aktiviteteve, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave të ofruara, krijojnë mundësi për zhvillimin dhe thellimin e njohurive dhe aftësive që janë thelbësore për avancimin në studime të tjera dhe për përgatitjen e studentëve për futjen në tregun e punës. Ky organizim ofron një bazë të fortë për karrierën e ardhshme profesionale të studentëve, duke i mundësuar atyre të përballen me sfidat e fushës së tyre dhe të kontribuojnë në zhvillimin e saj. Programi i studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Psikologji” me profile, respekton rregulloren dhe vendimet zyrtare, përfshirë VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” ¹¹¹ dhe Vendimi nr. 879 datë 18.12.2019 ¹¹² ,

¹¹¹ VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” https://univlora.edu.al/ep-content/uploads/2018/02/VKM-nr_41-date-24.1.2018.pdf (Aksesuar më 04-07-2024).

¹¹² Vendimi nr. 879, datë 18.12.2019 i Këshillit të Ministrave. Disa Ndryshime dhe Shtesa në Vendimin Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”

<https://docs.google.com/a/fshn.edu.al/viewer?a=v&pid=sites&srcid=ZnNobi5lZHUUyYEx8ZnNobnxneDo3NzYxM2UëZËNhMEE1Yjdi> (Aksesuar më 04-07-2024).

	Vendimin Nr. 185, datë 25.03.2021¹¹³, dhe përfshirjen në tregun e punës në fushën e psikologjisë, duke mundësuar që studentët të bëhen profesionistë të kualifikuar dhe të gatshëm për t'u angazhuar në rolet dhe përgjegjësitë e ndryshme që kërkon ky sektor. Ai ofron një përgatitje të thelluar, duke integruar njohuri teorike dhe praktike, si dhe mundësi për zhvillimin e karrierës në nivele të ndryshme profesionale, nga sektori privat në atë publik. Përmes përmbajtjes së tij, aktiviteteve dhe strukturës së lëndëve dhe praktikave, ky program duhet të krijojë mundësi për të ndihmuar studentët të ndërtijnë një profil të specializuar që mundëson sukses në fushën e psikologjisë klinike, organizative, komunitare. Liçencimi dhe e drejta për të ushtruar profesionin janë të mundura vetëm për studentët që kanë përfunduar të dyja ciklet e studimit në fushën e psikologjisë, ndërkohë që profilet e tjera të ngjashme nuk ofrojnë mundësinë e ushtrimit të profesionit të psikologut në mënyrë të rregullt dhe të liçencuar. Kjo siguron një formim të thelluar dhe të përshtatshëm për ata që dëshirojnë të bëhen profesionistë të kualifikuar në këtë fushë.
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.	Lëndët dhe modulet, shpërndarja e tyre në vite dhe semestra, si dhe vlerësimi në kredite dhe orë mësimore, krijojnë mundësinë për arritjen e objektivave edukative të programit të studimit. Ky organizim lehtëson zhvillimin e rezultateve të pritshme të të nxënit dhe avancimin në kërkimin shkencor, duke siguruar një strukturë të qartë dhe të integruar që mbështet zhvillimin e njohurive dhe aftësive të nevojshme për suksesin akademik dhe profesional të studentëve. Programi i studimit Msc. në "Psikologji" me profile, reflekton një koherencë me parashkimet e akteve ligjore referuar planit mësimorë përse i përket numrit të krediteve 120 ECTS, me 60 kredite për çdo vit akademik, duke respektuar ndarjen e ECTS me nga 30 ECTS në semestër, me kohëzgjatje normale në 2 vite akademike, tipologjia e lëndëve sipas veprimtarive formuese që karakterizojnë programin duke u mbështetur në VKM.Nr. 41, dt.24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë" dhe legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë, në Statutin dhe Rregulloren e UMSH. Shpërndarja e lëndëve në përgjithësi i

¹¹³ Vendimin Nr. 185, datë 25.03.2021. Për Disa Ndryshime dhe Shtesa në Vendimin Nr.41, Datë 24.1.2018, "Për Elementët e Programeve të Studimit Të Ofuara nga Institucionet e Arsimit të Lartë", Të Ndryshuar. <https://arsimi.gov.al/vendim-nr-185-date-25-3-2021-per-disa-ndryshime-dhe-shtesa-ne-vendimin-nr-41-date-24-1-2018-per-elementet-e-programeve-te-studimit-te-ofruara-nga-institucionet-e-arsimit-te-larte/>. (Aksesuar më 09-07-2024).

	jep mundësi studentit të marrë njohuri nga disiplina të psikologjisë, praktika gjithashtu bazuar në mënyrën e organizimit të japin mundësi për qartësi brenda fushës dhe thellim të njohurive dhe kompetencave praktike në profilin klinik.																								
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.	Struktura e programit të studimit duke iu referuar lëndëve ngarkesës në kredite, raporti teori-praktikë është në përputhje me profilin e programit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Psikologji” me profile. Veprimtaritë formuese të ndara sipas komponentëve mësimorë janë konform ligjit për arsimin e lartë¹¹⁴ dhe respektojnë elementët e veprimtarisë formuese në emërtim dhe në ndarjen me kredite. Tabela me ndarje të tipit të komponentëve mësimorë sipas kategorisë: <table><tr><th>Kategoria</th><th>Përshkrimi</th><th>Sipas VKM 185, 2021</th><th>Sipas planit mësimor</th></tr><tr><td>A</td><td>Lëndë bazë</td><td>5–10 % (kredite)</td><td>8 % (kredite)</td></tr><tr><td>B</td><td>Lëndë karakterizuese</td><td>50-60% (kredite)</td><td>62 % (kredite)</td></tr><tr><td>C</td><td>Lëndë ndërdisiplinore</td><td>12-20% (kredite)</td><td>20 % (kredite)</td></tr><tr><td>D</td><td>Lëndë plotësuese</td><td>10% (kredite)</td><td>12 % (kredite)</td></tr><tr><td>E</td><td>Detyrime përmbyllëse</td><td>10-15% (kredite)</td><td>18 % (kredite)</td></tr></table> Po ashtu, programi ofron njohuri dhe aftësi profesionale që e mbështesin studentin në zhvillimin e një baze të gjerë njohurish në fushën e psikologjisë, duke e pajisur atë me të dhëna të mjaftueshme dhe të detajuara për të përmbyllur kërkesat e një profili të specializuar, veçanërisht në fushën klinike, në studimin e sjelljes së individëve dhe grupeve brenda një organizate si dhe fokusohet në studimin e marrëdhënieve ndërmjet individëve dhe grupeve brenda konteksteve të komunitetit dhe shoqërisë. Ky strukturim i mundëson studentëve të ndihmojnë individët që	Kategoria	Përshkrimi	Sipas VKM 185, 2021	Sipas planit mësimor	A	Lëndë bazë	5–10 % (kredite)	8 % (kredite)	B	Lëndë karakterizuese	50-60% (kredite)	62 % (kredite)	C	Lëndë ndërdisiplinore	12-20% (kredite)	20 % (kredite)	D	Lëndë plotësuese	10% (kredite)	12 % (kredite)	E	Detyrime përmbyllëse	10-15% (kredite)	18 % (kredite)
Kategoria	Përshkrimi	Sipas VKM 185, 2021	Sipas planit mësimor																						
A	Lëndë bazë	5–10 % (kredite)	8 % (kredite)																						
B	Lëndë karakterizuese	50-60% (kredite)	62 % (kredite)																						
C	Lëndë ndërdisiplinore	12-20% (kredite)	20 % (kredite)																						
D	Lëndë plotësuese	10% (kredite)	12 % (kredite)																						
E	Detyrime përmbyllëse	10-15% (kredite)	18 % (kredite)																						

¹¹⁴ Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Shqipëri. https://archive.org/stream/LIGJI802015PERARSIMINELARTEDHEKERKIMINSHKENCORFLETORJAEBOTIMEVEZYRTARE/LIGJI+80+2015+PER+ARSIMIN+E+LARTE+DHE+KERKIMIN+SHKENCOR+FLETORJA+E+BOTIMEVE+ZYRTARE_djvu.txt (Aksesuar më 09-07-2024).

	përballen me çështje të aspekteve të ndryshme jetësore, duke ofruar një përgatitje të plotë që përfshin aspektet teorike dhe praktike të kësaj fushe.
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Duke u mbështetur në disa aspekte kyçe që lidhen me përmbajtjen e programit, mund të theksohet se ky program studimi, në një masë të caktuar, i pasqyron këto elemente si pjesë të strukturës dhe përmbajtjes së tij. Kjo tregon që programi është i projektuar për të adresuar nevojat dhe kërkesat e fushës, duke siguruar një formim të plotë dhe të balancuar për studentët në përputhje me standardet dhe praktikatat e njohura. Ka një balancë të mirë ndërmjet mënyrës së organizimit dhe paraqitjes së informacionit lidhur me ngarkesën mësimore, shpërndarjen e lëndëve sipas semestrave, orët në auditor dhe frekuentimin e aktiviteteve, si dhe vlerësimin e dijeve të studentëve. Këto janë të kombinuara me aktivitete specifike që synojnë të mbështesin përvetësimin praktik të njohurive të akumuluar nga studentët. Në lidhje me arritjen e objektivave formues, transferimin e studimeve dhe mundësitë e mobilitetit të studentëve, si brenda ashtu edhe jashtë vendit, mund të konkludohet se këto aspekte janë të arritshme, duke u mbështetur në përmbajtjen e syllabuseve të lëndëve ¹¹⁵ , emërtimin e tyre dhe lidhjen e drejtpërdrejtë me njohuritë dhe kompetencat profesionale që studentët do të fitojnë në përfundim të këtij programi studimi.
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	Mbështetur në syllabuset e lëndëve mësimore ¹¹⁶ të vëna në dispozicion shihet se programi studimit Msc në “Psikologji” me profile, është në rishikim nga njësia bazë dhe strukturat e sigurimit të cilësisë përmes përmirësimit të planeve mësimore si dhe për të rishikuar ecurinë e ndryshimit të riorganizimit të programit ¹¹⁷ . Duke iu referuar syllabuseve të lëndëve evidentohen disa problematika të cilat duhen adresuar: 1. Syllabuset në një pjesë të tyre janë hartuar nga titullare me gradën Dr. ¹¹⁸ ; etj, duke shkruar ndesh me diraktivat dhe ligjin për sa i përket titullarëve të lëndëve mësimore, të cilët duhet t’i përkasin kategorisë “Profesor”; 2. Syllabuset e lëndëve duhet të kenë një përditësim të literaturës pasi shihen syllabuse me një literaturë të hershme.

¹¹⁵ Evidencë 14.2.Syllabuse të lëndëve Msc në Psikologji me “Profile” 2023-2024

¹¹⁶ Syllabus i Lëndës Ndërhyrja në kriza e trauma.

¹¹⁷ Evidencë 6: Propozim mbi riorganizimin e programit

¹¹⁸Evidencë 14.2 Syllabuset e lëndëve

	Literatura e përdorur përgjithësisht është në përputhje me tipologjinë e lëndës dhe përmbush kërkesat e nevojshme për thellimin e njohurive teorike dhe praktike të studentëve. Ajo ofron një bazë solide të burimeve shkencore dhe praktike që mbështesin zhvillimin e kompetencave në fushën përkatëse, duke i mundësuar studentëve të kenë një kuptim të thelluar dhe të aplikuar të materialeve të studiuara. Literaturat janë të përzgjedhura në mënyrë që të pasqyrojnë standardet ndërkombëtare dhe kërkesat e fushës, duke kontribuar kështu në formimin e një njohurie të gjithanshme dhe të përshtatshme për kërkesat profesionale. <i>GVJ, duke u mbështetur në çështjet e evidentuara më sipër, sugjeron që njësisia bazë të rrisë vëmendjen në hartimin e syllabuseve nga titullarët e lëndëve që përkasin kategorisë "Profesor", për të siguruar një përmbajtje të plotë dhe të strukturuar mirë.</i>
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Duke iu referuar rregullores së programit të studimit, qëllimi kryesor është ofrimi i njohurive themelore në fushat që lidhen drejtpërdrejt me shkencën e psikologjisë klinike, psikoterapeutike, organizative, komunitare, që shfaqen tek grupmosha të ndryshme, diagnostikimin dhe trajtimin e personave me probleme të shëndetit mendor, duke i mbështetur me terapi psikologjike. Programi gjithashtu synon të pajisë studentët me aftësitë thelbësore të një psikologu klinik. Strukturimi i moduleve të lëndëve duhet t'i ofrojë mundësinë studentëve për të fituar shprehuri shkencore dhe profesionale. Aktivitetet e formimit teorik dhe praktik duhet të fokusohen në hapësirat e nevojshme për të zhvilluar aftësitë dhe shkathtësitë që janë të domosdoshme për të mundësuar psikologut klinik të realizojë kompetenca profesionale të lidhura me procesin e vlerësimit dhe ndërhyrjes psikologjike, duke i ofruar kështu mundësi më të mëdha për integrimin në tregun e punës. Implementimi i ideve inovative dhe studimeve të avancuara kërkimore dhe shkencore në planin mësimor duhet të mbështesë nevojat e studentëve për avancimin e njohurive, duke kërkuar një angazhim të vazhdueshëm nga ana e stafit akademik.
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve	Përmbajtja e programit të studimit ofron mundësi të vazhdimin të studimeve në përputhje me pritshmëritë dhe kërkesat e tregut të punës për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë, duke i përgatitur studentët për të përmbushur kriteret për

dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	liçencimin e psikologëve, siç përcaktohen nga Urdhri i Psikologut në Republikën e Shqipërisë. Ky program është i strukturuar për të siguruar që studentët të zhvillojnë aftësi dhe njohuri që janë të domosdoshme për të realizuar kërkesat e profesioneve të liçencuara, duke i mundësuar atyre integrimin e suksesshëm në tregun e punës dhe përmbushjen e standardeve të kërkuara për praktikën profesionale. Nëse i referohemi planit mësimor¹¹⁹, ¹²⁰, ¹²¹ kemi një ndarje midis veprimtarive formuese të cilat zhvillohen në auditor dhe jashtë tij si në aspektin teorik dhe atë praktik. Praktika profesionale gjithashtu kontribuon në zhvillimin e kompetencave dhe aftësive të nevojshme, duke ofruar mundësinë për njohjen e terrenit të punës. Sipas marrëveshjeve institucionale për praktikën, studentët kanë mundësinë të përzgjedhin institucione praktike që përputhen me interesat e tyre kërkimore dhe profesionale, duke i ofruar mundësi për t'u thelluar në fushën e psikologjisë klinike dhe për të sqaruar më tej rolin dhe përgjegjësitë e psikologut klinik në kontekste reale pune. Kjo i ndihmon ata të zhvillojnë një kuptim të thellë të praktikave profesionale dhe të krijojnë lidhje të rëndësishme për karrierën e tyre të ardhshme. Duke iu referuar përmbajtjes së programit, ai mundëson vijimin e procesit të liçencimit pas përfundimit të studimeve në ciklin e dytë konform rregullave për profesionet e rregulluara. Pas përfundimit të dy cikleve të studimit, studentët mund të kryejnë praktikën profesionale nën supervizionin e një psikologu të liçensuar, duke aplikuar njohuritë dhe aftësitë e fituara gjatë studimeve. Pas përmbylljes me sukses të kësaj praktike, ata mund të paraqiten për provimin e shtetit. Vetëm pas kalimit të provimit të shtetit, kandidatët mund të fitojnë liçencën për ushtrimin e profesionit të psikologut klinik në Republikën e Shqipërisë. Ky proces është një hap i rëndësishëm në rrugën profesionale të psikologëve, duke siguruar që ata të jenë të përgatitur për të ofruar shërbime profesionale në përputhje me standardet dhe rregulloret e vendit. Programi është i strukturuar për të siguruar që studentët të zhvillojnë aftësitë dhe kompetencat e nevojshme për të kaluar me sukses këtë fazë të liçencimit dhe për t'u integruar në tregun e punës si profesionistë të liçencuar.
Konkluzione	<i>GVJ thekson se nga shyrtimi dokumentacionit si dhe nga vizita në</i>

¹¹⁹ Ev. 3. 04. Plan i mësimor, i Programit Master i Shkencave "Psikologji Klinike.

¹²⁰ Ev. 3.03. Struktura mësimore Master i Shkencave në Psikologji Klinike.

¹²¹ Dosja C. Didaktike për Programin e studimit Msc. në Psikologji Klinike.

	<i>institucion se përmbajtja e programit të studimit ofron mundësi të vazhdimit të studimeve në përputhje me pritshmëritë dhe kërkesat e tregut të punës për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë, duke i përgatitur studentët për të përmbushur kriteret për liçencimin e psikologëve, siç përcaktohen nga Urdhri i Psikologut në Republikën e Shqipërisë. Ky program është i strukturuar për të siguruar që studentët të zhvillojnë aftësi dhe njohuri që janë të domosdoshme për të realizuar kërkesat e profesioneve të liçencuara, duke i mundësuar atyre integrimin e suksesshëm në tregun e punës dhe përmbushjen e standardeve të kërkuara për praktikat profesionale.</i> <i>Gjithashtu GV gjykon se disa aspekte të programit kërkojnë një vëmendje më të madhe, me qëllim adresimin e duhur të çështjeve të evidentuara më sipër. Në këtë kuadër, do të sugjeronte që njësia bazë të fokusohet në rritjen e vëmendjes për hartimin e syllabuseve nga titullarët e lëndëve që përkasin kategorisë "Profesor", siç kërkohet nga legjislacioni përkatës. Ky proces është thelbësor për të siguruar një përmbajtje të saktë, të strukturuar dhe në përputhje me standardet akademike dhe ligjore. Përveç kësaj, do të ishte e dobishme që të krijohen mekanizma të rregullt për vlerësimin e cilësisë së syllabuseve dhe për përmirësimin e vazhdueshëm të tyre, duke siguruar që ato të jenë të përditësuara dhe të përshtatura me zhvillimet më të fundit shkencore dhe praktike në fushën e psikologjisë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë	Programin e studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në "Psikologji" me profile "Psikologji Organizative", "Psikologji Komunitare" dhe "Këshillim dhe Psikoterapi me Orientim Njohës Sjellor", është Departamenti i Psikologjisë-Sociologjisë i cili duhet të konsultohet dhe mbështetet në përmirësimin e këtij program studimi dhe në përshtatjen e tij me kërkesat e tregut të punës në strukturën e ngritur nga UMSH siç është Alumnit dhe i

përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Karrierës apo takimet me Alumni apo dhe përfshirja e përfaqësuesve të institucioneve në përbërje të të cilit janë drejtues të institucioneve me të cilat UMSH ka marrëveshje bashkëpunimi¹²² duke zhvilluar takime me institucione dhe subjekte të ndryshëm të përfshirë në realizimin e programit të studimit si: personeli akademik me kohë të pjesshme, focus grupe¹²³ rrjeti ALUMNI, institucionet partnere të praktikave dhe aktorë të tjerë të tregut të punës. Për realizimin e misionit të tij si në aspektin e përmbushjes së aspekteve kurrikulare edhe të angazhimit me profil shoqëror, Departamenti i Psikologjisë-Sociologjisë zhvillon <i>marrëveshje bashkëpunimi</i> në funksion të programit të studimeve të ciklit të parë. Duke u bazuar në dokumentacionin e shqyrtuar mbetet disi i paqartë sesi do të përdoren këto element në drejtim të përmirësimit të përmbajtjes së programit të studimit.
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	Njësia bazë monitoron në vijimësi përshtypjet e studentëve të këtij program studimi përmes rolit procesit monitories mbi të cilin hartohet dhe një raport¹²⁴, raportimit të supervizorit¹²⁵ përmes pyetësorëve për studentët¹²⁶; vlerësim i pedagogut nga autoritet drejtuese¹²⁷, raport i vetëvlerësimit individual¹²⁸ dhe strukturave monitoruese në të cilat studentët janë pjesë e tyre etj. Në takimet me drejtuesen e njësisë bazë, GVJ u informua se njësia bazë organizon takime periodike me studentët për të marrë feedback-un e tyre për mënyrën e realizimit të procesit mësimor dhe aspektin e realizimit të eksperiencave të praktikës profesionale pranë institucioneve me të cilat UMSH ka marrëveshje përmes koordinatorsit dhe drejtuesit të njësisë. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë¹²⁹ dhe strukturat përkatëse, si Njësia e Sigurimit të Cilësisë në Fakultet dhe Grupi i Vlerësimit të Brendshëm të cilët raportojnë¹³⁰ dhe kanë një rol të rëndësishëm

¹²² Evidencë 10. Marrëveshje bashkëpunimi

¹²³ Evidencë 34.: Procedura e punës me fokus grupeve DSP

¹²⁴ Evidencë 32. Format raporti monitorimi

¹²⁵ Evidencë 49. Format raportimi të supervizorëve

¹²⁶ Evidencë 25. Formulari i vlerësimit të pedagogut dhe lëndës nga studenti.

¹²⁷ Evidencë 31. Formular vlerësimi i pedagogëve nga autoritet drejtuese

¹²⁸ Evidencë 41. Aneksi A. Raporti i vetëvlerësimit individual

¹²⁹ Evidencë 48. Plani veprimi NJSBCZHK

¹³⁰ Evidencë 50. Raport raportimi NJSBCZHK

	në monitorimin dhe përmirësimin e cilësisë akademike. Koordinator¹³¹ i programeve në nivel fakulteti, në bashkëpunim me njësitë përkatëse, realizojnë mbledhje informacioni përmes pyetësorëve të studentëve¹³² për të vlerësuar lëndët dhe pedagogët. Zyrat e Alumni dhe Karrierës kontribuojnë në zhvillimin e vazhdueshëm të kompetencave të studentëve dhe ish-studentëve, duke mbështetur lidhjet me institucionin dhe duke ofruar mundësi për shfrytëzimin e burimeve të tij njerëzore. Të gjitha këto struktura dhe nisma kanë një ndikim pozitiv në mbështetjen e alumnit, pasi ato krijojnë mundësi për zhvillimin e vazhdueshëm të kompetencave të ish-studentëve dhe ofrojnë lidhje të ngushta mes institucioneve arsimore dhe komunitetit të alumnëve. Këto mekanizma ndihmojnë në krijimin e mundësive për rritjen e angazhimit të alumnëve dhe përdorimin e burimeve të tyre për nevoja të ndryshme institucionale, duke kontribuar në përmirësimin e cilësisë dhe zhvillimin e institucioneve arsimore.
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	Programi i studimit MSC. në “Psikologji” me profile, është një program i ciklit të dytë të studimeve në fushën e Psikologjisë. Profesia e psikologut është në listën e profesioneve të rregulluara dhe rregullohet nëpërmjet Urdhrit të Psikologut. GJV sugjeron se njësia përgjegjëse duhet të rishikojë paketën e dokumenteve të programit të studimit MSC. në “Psikologji” me profile, duke konsideruar Ligjin nr. 10 171, datë 22.10.2009, “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe Ligjin Nr. 40/2016 për Urdhrin e Psikologut në Republikën e Shqipërisë¹³³. <i>Sugjerojmë se këto baza ligjore të referohen dhe konsiderohen me kujdes në punën e Departamentit Psikologji-Sociologjisë, duke u reflektuar në rregulloren e Departamentit¹³⁴ të Psikologjisë-Sociologjisë, në Strategjinë e Zhvillimit të Departamentit¹³⁵, në strategjinë e programit të studimit dhe strategjitë e zhvillimit të programeve të tjera të ofruara në këtë departament, pasi lidhen drejt për së drejti me përshtatjen dhe harmonizimin e programeve të studimit me aktet ligjore në fuqi dhe ndihmon në harmonizimin e ofertës së programeve të studimit me kërkesat e tregut.</i>

¹³¹ Evidencë 9. Rregullore e programit Msc.Psikologji me Profile KREU II neni 6,7

¹³² Evidencë 25. Formular vlerësimi i pedagogëve dhe lëndës nga studenti

¹³³ https://ëëë.urdhriipsikologut.al/ëp-content/uploads/2019/10/LIGJ_Per-Profesionet-e-Rregulluara.pdf

¹³⁴ Evidencë 8. Rregullore DSP

¹³⁵ Evidencë 5. Strategjia e zhvillimit të programit Msc. në Psikologji me Profile

Konkluzione	GVJ vëren se Departamenti i Psikologjisë-Sociologjisë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, në diskutime me studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit dhe programeve lëndore, dhe i reflekton ato kur janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit. GVJ sugjeron gjithashtu konsiderim të kujdesshëm të akteve rregullative mbi profesionet e rregulluara dhe ligjit mbi Urdhrin e Psikologut në Republikën e Shqipërisë, në dokumenta themelore të programit të studimit dhe të Departamentit të Psikologjisë-Sociologjisë. Ky sugjerim është i rëndësishëm për të siguruar që programi i studimit dhe dokumentacioni i Departamentit të Psikologjisë-Sociologjisë të jenë në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet profesionale. Për të përmirësuar programin, është e rëndësishme që këto propozime të reflektohen dhe të përfshihen në mënyrë të duhur në dokumentet dhe politikat që drejtojnë aktivitetin akademik të departamentit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.6	
Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	Programi i studimit Master i Shkencave në “Psikologji” me profile, ofron një qasje të thelluar dhe të specializuar në fushën e psikologjisë, duke u fokusuar në zhvillimin e aftësive të nevojshme për aplikimin e njohurive teorike dhe praktike në fushat e ndryshme të psikologjisë. Programi promovon zhvillimin e kërkimit shkencor dhe avancimin e shprehive profesionale, duke mundësuar që studentët të përvetësojnë kompetenca të avancuara që i mundësojnë atyre të bëhen të licencuar në fushën e psikologjisë pas përfundimit të studimeve. Ky program është i orientuar drejt përgatitjes së profesionistëve të kualifikuar që mund të kontribuojnë në fusha të tilla si psikologjia klinike, konsulencë dhe terapitë psikologjike, komunitare si dhe organizative. GVJ konstaton se në strategjinë e programit të studimit MSc. në “Psikologji” me profile, përcaktohen qartë objektivat dhe prioritetet kryesorë të studimit dhe të kërkimit

	shkencor. Në Misioni dhe Vizioni të strategjisë¹³⁶ evidentohen disa nga objektivat kryesorë të programit të studimit që synojnë: 1- Përmirësimin e cilësisë së vazhdueshme të mësimdhënies 2- Përmirësimin e vazhdueshëm të kurrikulës 3- Formimin e specialistëve të lartë në fushën e psikologjisë së edukimit dhe në përputhje me zhvillimin e vendit. 4- Përmirësimi i vazduesshëm i anës profesionale të stafit akademik 5- Arritjen e standardeve akademike më të larta bashkëkohore kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe përkrahjen e aspiratave dhe rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe sigurimin e cilësisë.
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit. GVJ konstaton se në rregullore të programit të studimit MSC. në "Psikologji" me profile, se në Rregulloren e departamentit¹³⁷ të Psikologjisë-Sociologjisë neni 6 në veprimtarinë akademike theksohet se departamenti nxit, bashkërendon, organizon dhe administron punën kërkimore dhe mësimdhënies në profilin e psikologjisë dhe sociologjisë në bazë të parimeve: të lirisë akademike, të autonomisë institucionale, të cilësisë. Duke iu referuar rolit të njësive kryesore¹³⁸ dhe asaj bazë¹³⁹ këto stuktura kanë një bashkërendim të mirë të punës në drejtim të monitorimit dhe zhvillimit të veprimtarisë mësimore, kërkimore - shkencore dhe veprimtarive të tjera ekstrakurrikulare^{140, 141}; etj. Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe praktikave të punës të prezantuara gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se Fakulteti Drejtësisë dhe Shkencave Humane dhe Departamenti Psikologjisë-Sociologjisë nxisin, bashkërendojnë dhe administrojnë veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.
Kriteri 3. Programi i	Ky program studimi përfiton nga një gamë e gjerë aktivitete

¹³⁶ Evidencë 5.Strategjia e zhvillimit të programit Msc në Psikologji me Profile

¹³⁷ Evidencë 8.Rregullore e DPS NENI 6

¹³⁸ Evidencë 7. Rregullore e Fakultetit (DSHH)

¹³⁹ Evidencë 8. Rregullore Departamentit Psikologji-Sociologjisë

¹⁴⁰ Evidencë 28. Programi i trajnimeve.

¹⁴¹ Evidenca 10. Marrëveshje bashkëpunimi

studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	ekstrakurrikulare të organizuara nga njësia bazë gjatë vitit akademik, duke përfshirë bashkëpunime me partnerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë në çështje të ndryshme me natyrë psiko-sociale. Këto aktivitete ofrojnë mundësi për zhvillimin e aftësive të studentëve jashtë kurrikulës dhe i ndihmojnë ata të përballen me sfida të ndryshme sociale dhe profesionale, duke përmirësuar përgatitjen e tyre për tregun e punës dhe jetën e ardhshme. Përgjatë veprimtarisë akademike të programit të studimit MSc. në “Psikologji” me profile, studentët kanë një vëmendje të dedikuar që është shprehje e prioritetëve të Universitetit Mesdhetar të Tiranës, Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Humane dhe punës së Departamentit të Psikologjisë-Sociologjisë. Studentët nxiten dhe motivohen për të qënë pjesë aktive e trajnimeve dhe projekteve të ndryshme me fokus studentët¹⁴² si dhe realizimi i pjesëmarrjes në aktivitete të ndryshme nëpërmjet institucioneve¹⁴³ që ka institucioni.
Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.	GVJ konstaton se njësia bazë e Departamentit të Psikologjisë-Sociologjisë, mbështetet financiarisht nga institucioni për realizimin e veprimtarive studimore, kërkimore e shkencore në forma të ndryshme, si mbështetja¹⁴⁴¹⁴⁵ ¹⁴⁶financiare në realizimin e konferencave shkencore kombëtare e ndërkombëtare, duke mbuluar konstat administrative dhe konstat e botimit të paketës së dokumentave të konferencës për pjesëmarrësit. Gjithashtu fakulteti mbështet financiarisht pasurimin e fondit të librave¹⁴⁷¹⁴⁸ dedikuar profilit të studimeve psikologjike-sociologjike në mbështetje të veprimtarisë studimore të programit të studimit MSC. në “Psikologji” me profile si dhe Departamentit të Psikologjisë-Sociologjisë
Konkluzione	<i>Në përfundim të analizës së kriterëve të standartit II.6, GVJ konkludon se Departamenti i Psikologjisë-Sociologjisë që ofron programin e studimit “Master i Shkencave” në “Psikologji” me profile, garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor, duke siguruar lirinë akademike, autonominë, mbështetjen e duhur për realizimin e objektivat e studimit,</i>

¹⁴² Evidencë 17. Leksione të hapura DPS

¹⁴³ Evidencë 10. Marrëveshje bashkëpunimi

¹⁴⁴ Evidencë 47. Lëvizja e stafit akademik dhe administrativ

¹⁴⁵ Evidencë 19.1 Tabelat e raportit financiar

¹⁴⁶ Evidencë 19.2 Pasqyrat financiare

¹⁴⁷ Evidencë 43. Material për bibliotekën

¹⁴⁸ Evidencë 44. Kërkesë për bibliotekën

	<i>kërkimit shkencor dhe mbështetjen për realizimin e prioriteteve strategjike të programit të studimit mbi studimet, kërkimin shkencor dhe mbështetjen e studentëve. Pra si përfundim programi i studimit siguron orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor, duke theksuar bashkërendimin efikas të njësisë kryesore dhe asaj bazë në monitorimin dhe zhvillimin e veprimtarisë mësimore.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.7

Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	GVJ konstaton se zhvillimi i partneriteteve për të realizuar veprimtari kërkimore shkencore të përbashkëta është në fokus të prioriteteve strategjike të Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë, Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Humane dhe Departamentit të Psikologjisë-Sociologjisë. Në gjithë hierarkinë e strukturave të Universitetit Mesdhetar shihet një frymë bashkëpunimi. Ky program studimi përfiton nga një gamë e gjerë aktiviteteve ekstrakurrikulare të organizuara nga njësia bazë gjatë vitit akademik, duke përfshirë bashkëpunime me partnerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë në çështje të ndryshme me natyrë psiko-sociale. Këto aktivitete ofrojnë mundësi për zhvillimin e aftësive të studentëve jashtë kurrikulës dhe i ndihmojnë ata të përballen me sfida të ndryshme sociale dhe profesionale, duke përmirësuar përgatitjen e tyre për tregun e punës dhe jetën e ardhshme. GVJ konstaton se zhvillimi i partneriteteve për të realizuar veprimtari kërkimore shkencore të përbashkëta është në fokus të prioriteteve strategjike të Universitetit "Mesdhetar i Shqipërisë", Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Humane, si dhe Departamentit të Psikologjisë-Sociologjisë. Në gjithë hierarkinë e strukturave të Universitetit Mesdhetar shihet një frymë bashkëpunimi, e cila mbështet realizimin e këtyre aktiviteteve dhe rrit zhvillimin e mëtejshëm të institucionit. Edhe në nivel Fakulteti dhe departamenti mbështesin grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe sigurojnë bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e

	objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor. Në realizimin e veprimtarive me karakter kërkimor shkencor vihen re bashkëpunime ¹⁴⁹¹⁵⁰ të konsoliduara me: Universitete si Brenda vendit dhe jashtë vendit.
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit Master i Shkencave në “Psikologji” me profile “Psikologji Organizative”, “Psikologji Komunitare” dhe “Këshillim dhe Psikoterapi me Orientim Njohës Sjellor” dhe Departamenti i Psikologjisë-Sociologjisë rezulton të jenë të angazhuar në përgjigjen e kërkesave të aktorëve të tjerë për analiza, kërkime, studime e projekte kërkimore shkencore në të cilin angazhojnë edhe studentë. Nga të dhënat rezulton se¹⁵¹¹⁵²: 1- Numri i botimeve nga personeli akademik efektiv për programin e studimit është 6; 2- Numri i aktiviteteve shkencore të organizuara në rang departamenti, Fakulteti për programin e studimit është 7; 3- Numri i pjesëmarrësve si partnerë në projektë Kombëtare dhe Ndërkombëtare rezulton të jetë 1 (një); 4- Numri i pjesëmarrjeve në aktiveitete shkencore jashtë IAL/ jashtë vendit për prezantime të punimeve kërkimore shkencore rezulton të jetë 20 (njëzet);
Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.	Në vijim të analizës së përmbushjes së standardeve të vlerësimit, GVJ vlerëson se në fushën e programit të studimit DPS/DSHH/UMSH organizojnë konferenca dhe aktivitete që ndihmojnë arritje ne objektivave të programit të studimit për studentët dhe personelin akademik. Përsa i përket aktivitetete shkencore, kërkimit shkencor të stafit akademik janë organizuar 5 tavolina të referimeve të pedagogëve në nivel të programit të studimit ¹⁵³ nëpërmjet platformave elektronike bashkohore ku një ndër to është nëpërmjet platformës WEBINAR, janë organizuar debate shkencore të organizuar nga Departamenti Psikologjisë-Sociologjisë me temë “Raportet mes Racionales dhe Emocionales”, “Empatia dhe Sjellja Njerëzore”. Gjithashtu departamenti organizon aktivitete ku përfshihen dhe studentë siç janë leksione të hapuara me lektorë si brenda vendit dhe jashtë tij,

¹⁴⁹ Evidencë 10. Marrëveshje bashkëpunimi

¹⁵⁰ Evidencë 16.Tabela përmbledhëse ASCAL Tab.nr.19. tab.nr.20

¹⁵¹ Evidencë 16.Tabela përmbledhëse ASCAL NR.19; NR.20

¹⁵² Evidencë 36.Raporti vjetor I departamentit Psikologji-Sociologji 2022-2023

¹⁵³ Evidencë 36.Raporti vjetor I departamentit Psikologji-Sociologji 2022-2023 pika nr.1, 2

	si dhe trajnime të akredituara nga Urdhri psikologut me tema që ndikojnë te studentët në thellimin e njohurive. ¹⁵⁴
Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.	GVJ vlerëson se programi studimit¹⁵⁵ MSc në “Psikologji” me profile, ofron një kurrikul me element të profilit dhe të mirëorganizuar për të formuar profesionistë konkurrues për tregun e punës vendas e të huaj, duke ofruar dije të kombinuara teorike dhe praktike në fushën e psikologjisë në përgjithësi dhe në fushë e psikologjisë së edukimit në veçanti. Gjithashtu GVJ vlerëson se programi studimit MSc në “Psikologji” me profile, ofron një kurrikulë të strukturuar dhe të balancuar, që synon zhvillimin e profesionistëve të kualifikuar dhe konkurrues për tregun e punës, si në nivel lokal ashtu edhe ndërkombëtar. Ky program kombinon dijet teorike dhe praktike në fushën e psikologjisë në përgjithësi, me një fokus të veçantë në psikologjinë e edukimit, duke mundësuar formimin e ekspertëve të aftë për të adresuar nevojat dhe sfidat e ndryshme në këtë fushë. Në vlerësimet e tregut të punës¹⁵⁶ dhe punësimit të të diplomuarve, të realizuara nga DPS, rezulton një nivel i kënaqshëm i punësimit të të diplomuarve nga programet e studimit të psikologjisë-sociologjisë. Sipas këtij raporti, më shumë se gjysma e studentëve të diplomuar në vitet e fundit, që kanë marrë pjesë në studim, raportojnë se janë të punësuar aktualisht si dhe kanë pasur të paktën një punë deri në momentin e anketimit. Ky tregues tregon një lidhje të fortë mes formimit akademik dhe mundësive të punësimit në këtë fushë. <i>GVJ sugjeron se në këtë program studimi duhet riparë kurrikula ku të jepen më shumë lëndë të profileve përkatëse të programit duke qënë se studentët përgjatë studimit të këtij program studimi profilizohen.</i>
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme	Programi i studimit MSc. në “Psikologji” me profile, ofruar nga Departamenti i Psikologjisë-Sociologjisë sipas akteve ligjore Kombëtare është i rregulluar me anë të Ligjin¹⁵⁷ nr. 10 171, datë 22.10.2009, “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe Ligjin Nr. 40/2016 për Urdhrin e Psikologut në Republikën e Shqipërisë. <i>GVJ konstaton se Departamenti i Psikologjisë-Sociologjisë</i>

¹⁵⁴ Evidencë 36. Raporti vjetor I departamentit Psikologji-Sociologji nr.4,5,6,7,8

¹⁵⁵ Evidencë 14.Plani mësimor Msc në psikologji me Profile

¹⁵⁶ Evidencë 15.Analiza e tregut të punës

¹⁵⁷ https://eë.arsimi.gov.al/ep-content/uploads/2017/10/LIGJ_NR_10_171_PRR.pdf

për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.	<i>duhet të rishqyrtojë dhe të përmirësojë elementë të punës së tij, si dhe akteve rregullatore, në përputhje me kërkesat, kritere dhe rekomandime të akteve ligjore të sipërcituara.</i> Ky rishikim duhet të bëhet në kuadër të dokumenteve strategjike themelore të Departamentit dhe programeve që ofron, duke marrë gjithashtu parasysh kërkesat e Urdhrit të Psikologut, veçanërisht për sa i përket kritereve të pranimit të studentëve, për të siguruar një nivel të lartë cilësie dhe përputhshmërie me standardet profesionale.			
Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (<i>p.sh. Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).	Programi i studimit Master i Shkencave në “Psikologji” me profile përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare, siç është direktiva e Bashkimit Evropian, 36/2006 ¹⁵⁸ , për profesionet e rregulluara, që shërbejnë si dëshmi e përgjegjësisë dhe përkushtimit të institucioneve të arsimit të lartë për sigurimin e cilësisë në arsim dhe për përgatitjen e studentëve për karrierë profesionale të suksesshme. Përshtatja me ligjet dhe standardet kombëtare dhe ndërkombëtare ndihmon në garantimin e kushteve të nevojshme për marrjen e licencës profesionale dhe për mbrojtjen e interesave të studentëve dhe publikut. Kjo gjithashtu tregon aftësinë e institucioneve të arsimit të lartë për të ndjekur zhvillimet e reja në fushën profesionale dhe për të përditësuar programet e studimit, në mënyrë që ato të përmbushin kërkesat e ndryshme të studentëve dhe të tregut të punës. Përmbushja e këtyre standardeve është thelbësore për sigurimin e cilësisë së lartë të arsimit dhe për përgatitjen e studentëve që të jenë të gatshëm dhe konkurrues në profesionet e tyre të zgjedhura.			
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson se programi i studimit garanton njohuri të thelluara në fushën e studimeve mbi psikologjinë në profile kominutare, organizative, këshilluese e psikoterapiste si dhe ofron mundësi për t’u integruar në mjedisin kërkimor shkencor në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar duke siguruar nëpërmjet marrëveshjeve të bashkëpunimit si dhe veprimtarive me karakter kërkimor shkencor të përbashkëta nga UMSH dhe DSHH.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së	Nuk	Përmbushet	Përmbushet	Përmbushet
---------------------------------	------------	-------------------	-------------------	-------------------

¹⁵⁸ Torres, R. (2016). The European recognition of professional qualifications—a legal framework for European citizenship. *UNIO–EU Law Journal*, 2, 71-81.

standardeve të fushës II	përmbushet	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
			X	

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Rregullorja e programit ¹⁵⁹ ka të paraqitura “Format e mësimdhënies” duke i përshkruar veprimtaritë mësimore si aktivitete që realizohen nëpërmjet orëve teorike dhe praktike, leksioneve, seminareve, detyrave të kursit, prezantimeve, projekteve të kërkimit, praktikës. Një informacion më i detajuar lidhur me elementët e lëndëve mësimore është paraqitur edhe në syllabuset ¹⁶⁰ ; etj e këtij programi studimi. Në vijim të saj “Praktika profesionale” parashikon të mundësojë përdorimin e kompetencave të fituara në kurset teorike në një kontekst praktik profesional, ku udhëzimet më të hollësishme lidhur me praktikën jepen në paketën e praktikës ¹⁶¹ . Departamenti i Psikologjisë-Sociologjisë ka hartuar udhëzues për praktikën ku janë përcaktuar kriteret për zgjedhjen e institucioneve të praktikës, procedurat e vlerësimit të dosjes së praktikës dhe përmbajtja e saj, vlerësimi i praktikës, detyrimet e studentit, aspekte që lidhen me respektimin e kodit etik të profesionit, detyrimet e supervisorit të praktikës, grafiku i shlyerjes së detyrimeve, institucionet e mundshme për praktikën, si dhe literatura e nevojshme për çdo lëndë mësimore të cilat janë pjesë e syllabuseve të lëndës. Gjithashtu nga ana tjetër, programi i lëndës përmban objektivat, konceptet themelore të lëndës, metodat e mësimdhënies dhe të vlerësimit, detyrimet e studentit për punime individuale si ese ose detyra kursi, detajimin e përmbajtjes së lëndës sipas orëve në dispozicion për

¹⁵⁹ Vizita dyditore në IAL dhe dokumentacioni shtesë. Rregullore e programit të studimit Master Shkencor në “Psikologji ” me profile

¹⁶⁰Evidencë 14.2 Syllabus i Lëndëve.

¹⁶¹ Evidencë 13. Udhëzues për praktikat dhe formularët e praktikës profesionale

	cilindo komponent mësimit si leksione, seminare, praktika e laboratore. Të gjithë komponentët e planit mësimit të programit të studimit MSc. në “Psikologji” me profile dhe të programeve lëndore janë të miratuara nga institucioni në fillim të çdo viti akademik.
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	Personeli akademik duket se ka kërkesa të vazhdueshme¹⁶² në drejtim të përmirësimit¹⁶³; ¹⁶⁴ të lëndës/modulit me forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies¹⁶⁵ gjithashtu liria akademike në drejtim të organizimit të orëve mësimore sipas nevojave dhe nivelit të studentit i jep mundësi pedagogut të aplikojë forma ndërveprimi që nxisin të menduarit kritik mbi çështje të caktuara, përdorimi i teknologjisë së informacionit ¹⁶⁶ për nevojat mësimore si videoprojektori, diskutimi në grup, role play janë aktivitete që lehtësojnë procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Liria akademike në organizimin e orëve mësimore, e cila mund të përshtatet sipas nevojave dhe nivelit të studentëve, i jep mundësi pedagogut të përdorë metoda të ndërveprimit që inkurajojnë mendimin kritik dhe një diskutim të thelluar mbi çështje të ndryshme profesionale dhe teorike. Ky fleksibilitet dhe adaptim i procesit mësimit ka si qëllim jo vetëm zhvillimin e njohurive të studentëve, por gjithashtu formimin e shprehisë për të menduar dhe vepruar si profesionistë të ardhshëm, duke u përgatitur për sfidat që mund të hasin në karrierën e tyre.
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.	Institucioni ofron mbështetje të vazhdueshme për personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike¹⁶⁷, ¹⁶⁸ jo vetëm përmes strukturave monitoruese që sigurojnë vlerësimin dhe përmirësimin e procesit mësimit, por edhe përmes udhëzuesve të detajuar për mësimdhënien. Këto udhëzues janë të dizajnuar për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies dhe për të mundësuar përdorimin e metodave të ndryshme dhe fleksible pedagogjike, të cilat janë të përshtatshme dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe

¹⁶² Ev. 2.22. Të dhënat e plota të aktiviteteve për kualifikimit shkencor të stafit akademik.

¹⁶³ Evidencë 36. Analiza vjetore e departamentit

¹⁶⁴ Evidencë 39. Plan-programi i punës së veprimtarive të Departamentit të Psikologjisë-Sociologjisë.

¹⁶⁵ Evidencë 5. Plani Strategjik për zhvillim programi.

¹⁶⁶ Evidencë 35. Manual i përdorimit të portalit studentor.

¹⁶⁷ Evidencë 43. Material për bibliotekën

¹⁶⁸ Evidencë 44. Kërkesë për bibliotekën

	kërkesat e tregut të punës jo vetëm përmes strukturave monitoruese¹⁶⁹ në drejtim të përmirësimit¹⁷⁰; ¹⁷¹ por edhe përmes udhëzuesve për mësimdhënien. Këto udhëzues¹⁷²; synojnë përmirësimin e cilësisë në mësimdhënie për stafin akademik të UMSH duke mundësuar përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxëniet, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Mbështetur në raportin e fushës kërkimore të stafit akademik^{173,174}; ¹⁷⁵ dhe të mobilitetit të tyre, krijohen kushte për rritjen e kompetencave profesionale dhe cilësisë në mësimdhënie.
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Personeli akademik¹⁷⁶ i angazhuar në mësimdhënie duke iu referuar syllabuseve¹⁷⁷; etj, metodat e mësimdhënies të aplikuara sipas tematikave të ndryshme në programin e studimit të UMSH krijojnë kushte të favorshme për një të nxënë efektiv, duke u mbështetur në titujt dhe gradat e personelit akademik të angazhuar. Ky proces i mësimdhënies pasqyrohet në diskutimet pozitive të studentëve dhe stafit akademik, të cilët vlerësojnë cilësinë e mësimdhënies. Gjithashtu, duke iu referuar syllabuseve të dërguara, ku përveç të dhënave të tjera përmendet edhe titulli i lëndës, është e rëndësishme që profili i tyre të integrohet plotësisht me nevojat e programit të studimit dhe me kërkesat e fushës së kompetencës së personave të angazhuar në lëndë dhe module specifike. Kjo siguron një koherencë dhe përputhje të plotë mes përmbajtjes së lëndëve dhe kërkesave profesionale që lidhen me zhvillimin e aftësive dhe kompetencave të studentëve. Bazuar në rregulloren e programit të studimit, ofrohet një shumëllojshmëri metodash mësimdhënieje, si role-play, studim raste dhe fokus-grupe, të cilat i mundësojnë studentëve të jenë aktivë gjatë procesit të mësimit. Këto metoda janë të përshtatshme për disiplinën e

¹⁶⁹ Evidencë 16. Tabela ASCAL Të dhënat e plota të aktiviteteve për kualifikimit shkencor të stafit akademik.nr.19,20

¹⁷⁰ Evidencë 36. Analiza vjetore e departamentit të psikologjisë-sociologjisë 2022-2023.

¹⁷¹ Evidencë 39. Plan-programi i punës i Departamentit të Psikologjisë-Sociologjisë 2023-2024

¹⁷² Evidencë 13. Udhëzues për praktikën dhe formularët e praktikës profesionale profesionale për studentët

¹⁷³ Ev 2.09. Model plani individual akademik shkencor I pedagogut per vitin 2022-2023.

¹⁷⁴ Ev 2.10. Analiza vjetore e departamentit të psikologjisë 2022-2023.

¹⁷⁵ Ev 2.08. Plani i punës i Departamentit të Psikologjisë.

¹⁷⁶ Evidencë 14.23Curriculum Vitae e stafit akademik te programit te studimit 2023-2024

¹⁷⁷ Evidencë 14.2 Syllabus i Lëndëve të programit psikologji-sociologji 2022 2023

	psikologjisë dhe ndihmojnë studentët të zhvillojnë aftësi praktike dhe të thellojnë njohuritë e tyre në këtë fushë. Format dhe metodat e përdorura nga stafi akademik janë të dizajnuara për të inkurajuar një sens të autonomisë te studentët, duke u siguruar që ata të kenë mbështetje dhe udhëzim të vazhdueshëm nga pedagogu, që të mund të aplikojnë njohuritë e tyre në kontekste reale dhe profesionale. Kjo qasje ndihmon në rritjen e aftësive analitike dhe kritike të studentëve, duke i përgatitur ata për sfidat e ardhshme profesionale. Mbështetur në informacionin e marrë nga takimi me studentët dhe pedagogët, por edhe nga rregulloret dhe udhëzimet e institucionit mbi rregullat e ndërtimit të marrëdhënies pedagog-student, respektohet dinjteti dhe integriteti i çdo studentit¹⁷⁸.
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Vlerësimi i këtij kriteri mbështet në kërkesën e zyrës së zhvillimit, kurrikulës dhe cilësisë për përmirësimin e formave dhe metodave në mësimdhënie ndërsa përsa i përket përfshirjes së studentëve në këtë proces ka një përpjekje përmes rolit të kordinatorit të departamentit dhe komisionit të sigurimit të cilësisë në nivel institucional ^{179,180} si dy struktura që monitorojë kompetencat e personelit akademik të përfshirë në mësimdhënie përmes një sërë formash monitorimi¹⁸¹. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, Departamenti i psikologjisë-sociologjisë dëshmon se në komponentët e vlerësimit të punës së departamentit mësimdhënia dhe cilësia e saj është një nga shtyllat bazë. Ky komponent është një nga elementët e diskutimit në raportet vjetore të punës së departamentit dhe të programit të studimit. Në praktikat e punës DPS dëshmon se si njësia përgjegjëse e programit të studimit ka ndërmarrë iniciativa për të vlerësuar format dhe metodat e mësimdhënies, duke përfshirë studentët dhe duke reflektuar sugjerimet e tyre në procesin e punës. Përfshirja e studentit në vlerësimin periodik^{182, 183}, të formave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve dhe përdorimi i formatit të vlerësimit të pedagogëve nga studentët realizohet në fund të çdo semestri. Studenti ka mundësi të shprehet në mënyrë anonime

¹⁷⁸ Evidencë 44. Kodi I Etikës.

¹⁷⁹ Evidencë 48. Plan veprimi Njësia e Sigurimit të brendshëm të cilësisë.

¹⁸⁰ Evidencë 49. Format raportimi supervizori

¹⁸¹ Evidencë 32. Format plani monitorimi/kontrolli DPS

¹⁸² Evidencë 25. Formular i vlerësimit të pedagogut nga studentët

¹⁸³ Evidencë 31. Vlerësimi I pedagogut nga autoritetet drejtuese

	për pedagogët e angazhuar në mësimdhënie, por edhe për stafin ndihmës në mbështetje të mësimdhënies që ofron mbështetje në procesin e mësimdhënies, duke mundësuar një vlerësim të ndershëm dhe të paanshëm të cilësisë së mësimdhënies dhe mbështetjes së ofruar.
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	Institucioni ka ngritur disa struktura, të cilat kanë një rol të rëndësishëm në drejtim të përmirësimit të vazhdueshëm në mësimdhënie, përmes Zyrave studentore¹⁸⁴, Alumni dhe Karrierës¹⁸⁵, Njësisë për zhvillimin kurrikularë dhe Cilësisë¹⁸⁶,¹⁸⁷. Puna e këtyre strukturave synon monitorimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në mësimdhënie duke përshtatur kurrikulën e programeve të studimit me standardet shtetërore dhe ato ndërkombëtare, në funksion të kësaj çështje është hartuar edhe rregullorja për standartet e cilësisë¹⁸⁸. Të gjitha strukturat drejtuese (autoritetet dhe organet drejtuese), janë përgjegjëse për ndjekjen e përditshme të sigurimit të cilësisë nëpërmjet planifikimit, organizimit, zbatimit dhe monitorimit të zbatimit të politikave, strategjive dhe procedurave drejt arritjes së vizionit të UMSH. Strukturat përgjegjëse për monitorimin e sigurimin e cilësisë dhe respektimin e standardeve të reja për rritjen e cilësisë në mësimdhënie, kanë ndërmarrë disa nisma që synojnë të ndihmojnë institucionin në këtë drejtim. Përmes raportit të vlerësimit të studentëve¹⁸⁹,¹⁹⁰, që lejonë mbledhjen e një informacion të detajuar mbi një sërë aspektesh si vështrimi i përgjithshëm i gjendjes së programit të studimit, ndryshimet apo praktikën profesionale, plani i veprimit për vitin e ardhshëm, raportimi mbi veprimtaritë e ndërmarra, feedback-u i marrë nga studentët dhe stafi akademik në nivel institucional, statistika të regjistrimit të studentëve dhe të kalueshmërisë së tyre, burimet mbështetëse të programit të studimit, vlerësimi i jashtëm, karriera dhe alumnit, profesionet e rregulluara si dhe praktikrat e mira nga institucionet e tjera. Ky vlerësim është jashtëzakonisht i rëndësishëm, pasi ai ofron një pasqyrë të

¹⁸⁴ E1.07. Rregullore e komisionit për marrëdhëniet me studentët publikun, kordinimin.

¹⁸⁵ E 1.16. Rregullore e zyrës së këshillimit të karrierës dhe jetës studentore.

¹⁸⁶ E. 1.09. Rregullore e komisionit për mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe kurrikulës.

¹⁸⁷ E 1.08. Rregullore e komisionit për garantimin e standarteve të cilësisë

¹⁸⁸ E 1.08. Rregullore e komisionit për garantimin e standarteve të cilësisë.

¹⁸⁹ Evidencë.25. Model i vlerësimit të pyetësorit pedagogëve dhe lëndëve nga studentët.

¹⁹⁰ Evidencë 31. Formual vlerësimi i pedagogëve nga autoritet drejtuese.

	detajuar dhe të saktë të gjendjes aktuale të programit të studimit dhe ndikimit të tij te studentët. Vlerësimi i bërë përmes raportit të studentëve ndihmon në identifikimin e forcave dhe dobësive të programit, duke mundësuar ndërmarrjen e masave për përmirësimin e tij në mënyrë të vazhdueshme. Për më tepër, ky proces i vlerësimit siguron një lidhje të fortë midis institucioneve akademike dhe studentëve, duke lejuar që ata të kontribuojnë me mendimet dhe sugjerimet e tyre për zhvillimin e programit. Gjithashtu, mbledhja e të dhënave si regjistrimi i studentëve, kalueshmëria dhe vlerësimi i jashtëm është jetike për të siguruar që programet e studimit të përmbushin standardet akademike dhe kërkesat e tregut të punës, duke garantuar një arsimim të cilësisë së lartë dhe përgatitjen e studentëve për karrierat e tyre profesionale.			
Konkluzione	<i>Bazuar në këtë, standardi përgjithësisht kemi një përmbushje të kriterëve, por një çështje e rëndësishme që ka nevojë të adresohet nga ana e institucionit ka të bëjë me kujdesin në përzgjedhjen e stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi për lëndët, por vlen të theksohet se Departamenti i Psikologjisë-Sociologjisë, Universiteti Mesdhetar garantojnë krijimin e strukturave, politikave dhe mundësive që krijojnë kushte të përshtatshme për mësimdhënie inovative dhe në respekt të diverzitetit të studentëve, si dhe nxisin procesin e të mësuarit efektiv dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve, elementëve të rëndësishëm.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore	Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë ka hartuar dhe zbaton një rregullore të posaçme mbi studimet në FDSHH në kreun IX ¹⁹¹ të së cilës trajtohen elementët e kontrollit të dijeve dhe vlerësimit. Në nenin 62 nenin 63 të saj shprehet se: “Kontrolli i

¹⁹¹ Evidencë 2.Rregullore e organizimit të UMSH

përcaktohen në Rregulloren e studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	dijeve realizohet nëpërmjet testeve/ provimeve me shkrim/ me gojë, kombinim me shkrim me gojë. Në programin e lëndës shprehen modalitetet e vlerësimit dhe detyrimet e studentit, të cilat i bëhen të njohura studentëve me fillimin e procesit mësimor. Vlerësimi i studentit bëhet në pikë që më pas konvertohet në notë. Ky proces kalon disa elementë të cilët janë të përcaktuar në programin e lëndës/ modulit. Këto elementë të kontrollit të dijes janë të mirëspecifikuara në rregullore si në nivel universitar, fakultet¹⁹², departamenti¹⁹³, program.¹⁹⁴ Elementët e mësipërm, Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen edhe në rregulloren e studimeve në FDSHH dhe në rregulloren e programit të studimit MSC në Psikologji me profile dhe janë publike dhe njihen nga studentët.
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Nga dokumentacioni i prezantuar me RVB-në, rezulton se në zbatim të akteve të brendshme rregullatore të planit mësimor¹⁹⁵ të programit të studimit¹⁹⁶ MSc në “Psikologji” me profile, përmban formën e vlerësimit përfundimtar të njohurive në përfundim të lëndës. Gjithashtu, rezulton se në çdo program lënde të hartuar nga titullarët e lëndëve është parapërcaktuar dhe miratuar metodologjia e testimit dhe e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara për lëndën. Nga takimet me studentë¹⁹⁷ rezultoi se në javën e parë të çdo semestri studentëve ju prezantohen nga pedagogët e lëndës syllabuset e lëndëve/ moduleve duke konsideruar në mënyrë të kujdesshme kompetencat e lëndës, objektivat dhe qëllimet lëndore, rezultatet e të mësuarit, metodat e mësimdhënies, metodologjinë dhe komponentët e vlerësimit të studentit dhe dijeve të tij profesionale në përfundim të lëndës, si dhe literaturën bazë dhe e rekomanduar për studim.
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive	Vlerësimi i njohurive¹⁹⁸ aftësive profesionale dhe shkencore të studentëve realizohet nëpërmjet vlerësimit të vazhdueshëm dhe

¹⁹² Evidencë 7.Rregullore e FDSHS

¹⁹³ Evidencë 8.Rregullore DSP

¹⁹⁴ Evidencë 9.Rregullore e programit Msc, në Psikologji me Profile

¹⁹⁵ Evidencë 14.Plani mësimor 2023-2024

¹⁹⁶ Evidencë -Programi mësimor atashuar në dokumentat shtesë

¹⁹⁷ Informacion nga vizita në institucion

¹⁹⁸ Evidencë 2.Rregullore e organizimit UMSH

profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	vlerësimit përfundimtar. Qëllimi kryesor i metodave të vlerësimit është t'u mundësojë studentëve të tregojnë njohuritë dhe kompetencat e fituara gjatë periudhës së studimeve. Për këtë arsye, përdoren forma të ndryshme vlerësimi si detyrat e kursit, provimet e ndërmjetme, projektet, analizimi i rasteve, esetë, dorëzimi i dosjeve, praktika profesionale, etj. Këto metoda ofrojnë mundësi për një vlerësim të plotë dhe të gjithanshëm të përgatitjes së studentëve. Kontrolli i njohurive realizohet sipas rregulloreve të studimeve të FDSHH ¹⁹⁹ -së dhe të Programit të Studimit ²⁰⁰ të Masterit të Shkencave në "Psikologji" me profile. Testimi përfundimtar mund të zhvillohet në formë të shkruar, me gojë, ose në një format të kombinuar, sipas kërkesave të parashikuara dhe miratuara në programet përkatëse të lëndëve ose moduleve.			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se UMSH, FDSHH në rregulloren e studimeve dhe DPS në rregulloren e programit të studimit për MSc. në "Psikologji" me profile, kanë hartuar dhe zbatojnë procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore të studentit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3 Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari	Sipas nenit 20 të Rregullores të programit të studimit ²⁰¹ ²⁰² , vlerësimi i studentit bëhet në sistem prej dhjetë notash. Në syllabuset ²⁰³ e lëndëve vlerësimi bazohet në 3-4 detyra kontrolli në 2-3 tema, detyrë kursi dhe provim përfundimtar. Elementët, pesha specifike në përqindje të notës përfundimtare dhe format e vlerësimit të vazhdueshëm dhe testimit përfundimtar shprehen në mënyrë eksplicite në programet e lëndëve. Në rregulloren e programit të studimit MSc. në "Psikologji" me profile, shprehet

¹⁹⁹ Evidencë 7.Rregullore e DSHH

²⁰⁰ Evidencë. Programi studimit në dokumntat shtesë

²⁰¹ Evidencë 9. Rregullore e programit të Msc. Në Psikologji me Profile

²⁰² Evidencë-Të dhëna të mara nga diskutimet me studentët në vizitën në institucion

²⁰³ Evidencë 14.2 Syllabuset e lëndëve për vitin 2023-2024

i lëndës/modulit.	qartë se vlerësimi përfundimtar i shprehur në notë i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë semestrit, bëhet pas përfundimit të procesit të korrigjimit të provimit si dhe pas mbledhjes së rezultateve të grumbulluara nga studenti përgjatë semestrit si pjesë e vlerësimit të vazhdueshëm.
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Elemente kryesore të kontrollit të vazhdueshëm mësohet të jenë: provimet e ndërmjetme, detyra kursi, provimi përfundimtar. Provimi synon vlerësimin e njohurive dhe të aftësive të studentëve ku pyetjet që testimi përmban janë me natyrë përshkuese, shpjeguese dhe vlerësuese e cila zhvillon aspektin e njohurive si në aspektin teorik dhe atë praktik ²⁰⁴ . Llojet e provimeve që zhvillohen për kontrollin e dijeve janë: Provimi i ndërmjetëm, Provimi përfundimtar, Riprovimi, Përmirësimi, Diploma për programin e studimit Master Shkencor në “Psikologji” me profile. Nëpërmjet platformave ²⁰⁵ të ndryshme elektronike pedagogët zhvillojnë dhe quize të ndryshme.
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Në Programin e studimit Master i Shkencave në Psikologji me profile, “Organizative”, “Komunitare” dhe “Këshillim dhe Psikoterapi me Orienim Njohës Sjellor”, vlerësimi për secilën lëndë mësimore kryhet pas përfundimit të saj dhe kur studenti ka shlyer të gjitha detyrimet e parashkruara në rregulloren e studimeve dhe në programin e lëndës. Shkalla e përvetësimit të programit mësimor vlerësohet sipas sitemit të vlerësimit me dhjetë nota, nga 1-shi tek 10-ta, ku 10-ta është vlerësimi maksimal. Nota më e ulët për kalim në një lëndë është nota 5 (pesë). Në rregulloren e UMSH, në rregulloren e DPS, programit Msc. në “Psikologji” me profile, theksohet gjithashtu se vlerësimi ²⁰⁶ është ekuivalenca sipas vlerësimit të njohurive apo dijeve të grumbulluara nga studenti dhe të materializuara në tezën e provimit dhe nota është rezultat i kombinimit të elementëve të procesit mësimor. Tezat e provimit hartohen nga titullari lëndës së bashku me pedagogun që zhvillon mësimin dhe miratohet nga përgjegjësi i departamentit dhe në mungesë të tij firmoset nga përgjegjësi gruplëndës. Pasi ka filluar provimi në sallë nuk mund të hyjë askush përveç Dekanit ose Rektorit për të kryer një kontroll ²⁰⁷ . Nga dokumentacioni

²⁰⁴ Evidencë 24:Model teze

²⁰⁵ Evidencë 35.Manual përdorimi platforme elektronike

²⁰⁶ Evidencë 8:Rregullore e Departamentit DPS neni 19, neni 20

²⁰⁷ Evidencë 8:Rregullore e Departamentit neni neni 21

	zhvilluar nga GJV theksohet se nuk kemi evidenca për përdorimin e mjeteve të tjera tëurvejimit të provimit me qëllim që të shmangen abuzimet.
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxëniet për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	GVJ konstaton se në të gjitha format e vlerësimit të njohurive të fituara, vlerësimi i studentit shoqërohet me komente mbi pikat e forta dhe pikat e dobëta në dijet e mësuarat dhe aftësitë e përvetësuarat në mënyrë që të ndërtohen strategji të suksesshme për të rirorientuar të mësuarin efektiv për të arritur rezultate më të larta në vijim. Vlerësimi i vazhdueshëm dhe provimet e ndërmjetme u evidentuan nga takimet me studentët dhe personelin akademik si element të rëndësishëm të procesit të “korrigjimit” të mangësive nëpërmjet shkëmbimit të komenteve të vazhdueshme, duke synuar përmirësimin e rezultateve të studentit në provën finale dhe në të ardhmen. Nëse studenti ²⁰⁸ ²⁰⁹ ²¹⁰ ²¹¹ ka ankesë për notën ai bën një ankimmim me shkrim të cilën e dorëzon në sekretarinë mësimore drejtuar dekanit. Nëse dekani verifikon se ka vlerësim të gabuar ngrihet komisioni i posaçëm i cili bën rivlerësimin e tezës ose rimer studentin në provim. Realizimi i vlerësimit në mënyrë të copëzuar dhe në mënyrë të strukturuar që t’u japë mundësi studentëve që iu përshtaten stileve të ndryshme të të nxëniet.
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Në Kodin e Etikës ²¹² përcaktohet qartë se studenti nuk duhet të kopjojë gjatë procesit mësimor. Respektimi i procedurave dhe realizimi me korrektësi nga stafi akademik synojnë që përmes rregullave të zhvillohet me përpikmëri provimi. Gjithashtu në Kodin e Etikës parashikohen parimet e etikës gjatë veprimtarisë studentore ndër të cilat edhe ndalesat ndaj plagjiaturës dhe kopjimit në detyra e provime. Kriteret dhe kërkesat mbi sjelljet etike janë të parashtruara edhe në programet e lëndëve të programit të studimeve sipas VKM 41 të ndryshuar në seksionin “kodi i etikës”.
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në	Transparenca me studentët në lidhje me komponentët e vlerësimit dhe peshën specifike të secilit komponent në vlerësim e bën rezultatin e kontrollit të dijeve dhe të aftësive profesionale të bazuar në meritë dhe në skema racionale që minimizojnë ndikimet subjektive. Korrigjimet e automatizuara

²⁰⁸ Evidencë 2. Rregullore e Organizimit UMSH KREU IX, neni 67

²⁰⁹ Evidencë 7. Rregullore e Faakultetit DSHH ,Kreu VIII neni 42

²¹⁰ Evidencë 9. Rregullore e programit të studimit Kreu V, neni 23

²¹¹ Evidencë 8. Rregullore e DPS neni 23

²¹² Evidencë 5. Kodi etikës neni 7 pika f

rregulloret përkatëse.	të provimeve rritin objektivitetin në vlerësim gjithashtu. Rregullorja e organizimit në UMSH²¹³ parashikon të drejtën për ankimim të rezultatit dhe procedurës së vlerësimit dhe realizimit të provimit nga ana e studentit, duke garantuar të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. Procedura që zbatohet nga institucioni përfshin rregullat sipas përcaktimeve përkatëse sesi bëhet kontrolli i vazhdueshëm i dijeve, hyrjen në provim dhe gjithçka tjetër që i përket këtij procesi të përcaktuar në rregulloren e departamentit²¹⁴ dhe në syllabusin e lëndës²¹⁵. Gjithashtu kontrolli i cilësisë realizon kontrolle lidhur me transparencën në vlerësimin me notë duke monitoruar komponentët e caktuar të krahasimit të vlerësimit të realizuar nga stafi akademik për lëndë specifike. Në praktikën e komunikimit të vlerësimit në programin e studimit, evidentohen aspekte të komunikimit të hapur dhe konstruktiv, që lehtësojnë një marrëdhënie të drejtpërdrejtë dhe pozitive mes studentëve dhe pedagogëve. Ky komunikim mundëson që studentët të jenë ballë për ballë me pedagogun gjatë procesit të vlerësimit, duke krijuar mundësi për konsultime të menjëhershme mbi çdo paqartësi ose pakënaqësi që mund të lindin lidhur me vlerësimin. Kjo qasje ndihmon në zgjidhjen e problemeve në kohë reale dhe rrit transparencën dhe besimin në procesin e vlerësimit.
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Çdo student ka të drejtë të konsultoj tezën, të kërkoj sqarim për notën, të kërkoj rivlerësim të notës. Ankimi kryhet me shkrim dhe dorëzohet në sekretarinë mësimore drejtuar dekanit i cili bën një vlerësim dhe nëse është gabuar në vlerësim ngrihet komisioni të posaçme konform rregullave ligjore dhe në mbështetje të të drejtave të studentit. Nga shqyrtimi dokumentacionit dhe nga takimet e zhvilluara në ambjentet e UMSH me stafin akademik dhe studentët u vu re se Institucioni respekton procedurat e njohjes me vlerësimin, kushtet dhe hapat për rishikimin e vlerësimit. Këto procedura janë konform legjislacionit në fuqi dhe rregullores së programit të studimit²¹⁶. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me

²¹³ Evidencë 2: Rregullore e organizimit të UMSH

²¹⁴ Evidenca 8. Rregullore Departamentit Psikologji-Sociologji.

²¹⁵ Evidencë 14.2-Syllabuset Msc.në Psikologji me "Profile"

²¹⁶ Evidencë 9. Rregullore Msc. në Psikologji me Profile

	vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. Komunikimi i vlerësimeve bëhet në respektim të plotë të privatësisë së studentit.			
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Studenti njihet me rezultatet në portalin e studentit ose përmes sekretarisë mësimore. Çdo student ka të drejtë të konsultoj tezën, të kërkoj sqarim për notën, të kërkoj rivlerësim të notës përmes komisioneve të posaçme që ngrihen nga njësia bazë për këtë qëllim. Duke u bazuar te rregullorja e njësisë bazë ²¹⁷ por edhe te rregullorja e programit ²¹⁸ dhe dokumenti mbi sistemin e vlerësimit të studentëve ekziston një procedurë, e cila i jep mundësi studentëve të ndjekin këtë proces në mënyrë korrekte. Rivlerësimi i testimit bëhet nga një komision i posaçëm konform rregullave ligjore dhe në mbështetje të të drejtave të studentit.			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se Departamenti i Psikologjisë dhe Sociologjisë nëpërmjet hartimit dhe zbatimit të rregullores së posaçme të studimeve në UMSH siguron një mjedis ndërveprimi ndërmjet pedagogëve dhe studentëve që mundëson dhe garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4	
Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	Programi i studimit MSc ²¹⁹ . në “Psikologji” me profile është një program i ciklit të dytë të studimeve, i cili synon të ofrojë një formim të thelluar shkencor dhe profesional për studentët. Ky program është hartuar mbi një kurrikul të pasur dhe të balancuar, që kombinon aspektet teorike dhe praktike, duke i mundësuar studentëve të zhvillojnë njohuri të thella dhe aftësi të avancuara në fushën e psikologjisë. Analiza e planit mësimor dhe

²¹⁷ Evidencë 8. Rregullore Departamentit Psikologji.-Sociologji

²¹⁸ Vizita dy ditore në IAL dhe dokumentacioni shtesë. Rregullore e programit të studimit Master Shkencor në “Psikologji” me Profile

²¹⁹ Evidencë . Programi studimit mësimor në dokumentat shtesë të atashuar

	programeve të lëndëve/modulesh tregon se programi është i strukturuar në mënyrë që të garantojë përgatitjen e studentëve për t'u përballur me kërkesat e tregut të punës dhe të kontribuoni në avancimin e fushës shkencore. Programi i studimit ofron një kurrikul²²⁰, e cila në mënyrë të përshkallëzuara dhe të strukturuar integron dijet e formimit metodologjik shkencor psikologjik nëpërmjet lëndëve të profilit organizativ, komunitar apo dhe këshillues. Për thellimin e dijeve në praktikën profesionale, studentëve ju garantohen praktika institucionale ku njihen dhe zhvillojnë praktika pune e cila është arritur falë marrëveshjeve të bashkëpunimit²²¹ që ka institucioni. Aftësitë shkencore dhe dijet në fushën e kërkimit studentët i testojnë në mënyrë të vazhdueshme gjatë procesit të zhvillimit të lëndëve nëpërmjet projekteve të kursit dhe detyrave kërkimore për t'u finalizuar me temën e diplomës si një tezë complete kërkimore individuale e çdo student që ndjek programin.
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Programi i studimit²²² MSc. në "Psikologji" me profile "Organizativ", "Komunitar", "Këshillim dhe Psikoterapi" me Orientim Njohës dhe Sjellor", nëpërmjet planit mësimor^{223, 224, 225} strukturës së tij formative dhe përmbajtësore, synon të formojë profesionistë të specializuar në fushën e psikologjisë që do të jenë të aftë të përballojnë sfidat e ndryshme të tregut të punës. Ky program ofron një përzierje të shkëlqyer të njohurive teorike dhe praktikave profesionale, duke mundësuar zhvillimin e aftësive të thelluara për të trajtuar dhe zgjidhur çështje komplekse në ambientet organizative, komunitare dhe klinike. Aftësitë dhe kompetencat që fitohen gjatë këtij programi janë të orientuara në krijimin e mundësive për të ndihmuar individët dhe grupet në përballimin e sfidave psikologjike dhe sjellore, duke kontribuar kështu në zhvillimin e shëndetit mendor dhe përmirësimin e jetës sociale. Teknologjia e informacionit luan një rol kyç në mbështetje të programit të studimit, duke ofruar mundësi për përdorimin e burimeve të informacionit të nevojshme për zhvillimin e aftësive profesionale dhe akademike. Ajo gjithashtu kontribuon në përmirësimin e aftësive të

²²⁰ Evidencë 14. Plani mësimor në Msc, në psikologji me Profile

²²¹ Evidencë 10. Marrëveshje bashkëpunimi

²²² Evidencë -Programi mësimor në Msc. Në Psikologji me Profile

²²³ Evidencë 14. Plani mësimor Msc. Në Psikologji me Profile

²²⁴ Evidencë 14.1 Plani mësimor i ndarë në veprimtare formuese (A-E)

²²⁵ Evidencë 14.2 Syllabuset e lëndëve 2023-2024

	komunikimit digjital, të cilat janë thelbësore për profesionistët në fushën e psikologjisë. Programi i studimit, përmes literaturës së detyrueshme dhe atij të rekomanduar, i cili shpesh është në gjuhë të huaj, kryesisht në anglisht, ofron mundësinë që studentët të përmirësojnë njohuritë e tyre gjuhësore. Ky integrim i literaturës ndërkombëtare jo vetëm që pasuron njohuritë akademike, por gjithashtu i ndihmon studentët të zhvillojnë aftësi për të komunikuar dhe operuar në një mjedis global dhe profesional.
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmblylëse.	Nga shqyrtimi i materialeve të ofruara dhe dokumentacionit përkatës, vizitës në insitucion ²²⁶ GVJ-ja vëren se në çdo syllabus të lëndës ²²⁷ , në fund të procesit mësimor është parashikuar një temë përmblylëse që ka për qëllim rishikimin dhe përmbledhjen e koncepteve, kompetencave dhe aftësive kryesore të fituara nga studentët gjatë kursit. Gjatë javës së fundit të mësimin, personeli akademik thekson çështjet më të rëndësishme të trajtuara gjatë kursit dhe ofron orientime të qarta për aplikimin e këtyre njohurive. Po ashtu, në këtë fazë, pedagogët japin udhëzimet përkatëse për detyrat përfundimtare të lëndës/modulit. Ky proces është vërtetuar gjithashtu gjatë diskutimeve me studentët, të cilët shprehën se janë ndihmuar në mënyrë të qartë dhe të strukturuar për realizimin e detyrimeve përfundimtare. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës përmes udhëzimeve të veçanta dhe vlerësimit të njohurive në përfundim të semestrit përkatës. UMSH dhe njësia kryesore/bazë përmes strukturave të saj synon të angazhohet në monitorim dhe nxitje të stafit në drejtim të vlerësimit dhe përmirësimit të formave të mësimdhënies. Raporti i punës semestrale analizohet nga ana e çdo pedagogu në përfundim të lëndës së tij duke u ndalur në një sërë aspektesh që kanë të bëjnë me mësimdhënien, mësimnxënien, rezultatet e dala nga feedback-u i studentëve të cilat më tej përmbledhen në analizën vjetore të departamentit ²²⁸ .
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë	Metodat e mësimdhënies në programin e studimit MSc. në "Psikologji" me profile, janë të orientuara me në qendër studentin dhe synojnë të krijojnë mundësi për një mësim aktiv.

²²⁶ Informacion i marë nga vizita në insitucion

²²⁷ Evidencë 14.2. Syllabus të lëndëve 2023-2024

²²⁸ Evidencë36:Analizë e punës vjetore Departamentit të Psikologjisë-Sociologjisë.

studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Këto metoda inkurajojnë studentët të jenë pjesëmarrës aktivë në procesin e mësimdhënies, duke përdorur teknika të ndryshme si diskutime në grup, analizë rastesh, role-play dhe studime individuale, për të zhvilluar aftësitë e tyre kritike dhe praktike. Kjo qasje e orientuar drejt studentëve synon të krijojë një mjedis ku ata mund të aplikojnë njohuritë e fituara dhe të zhvillojnë kompetenca të thella dhe të qëndrueshme për profesione të specializuara. Në funksion të këtij qëllimi zhvillimi i mësimdhënies mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/ çështjeve të servirura për diskutim nga përvoja të punës duke krijuar klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që u jep studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë dhe zhvillimin e shprehive duke prekur aspektet praktike në një gamë lëndësh të detyruara dhe me zgjedhje. Kjo u bazua në bisedat e zhvilluara nga stafi dhe takimi me studentët. Përsa i përket referimit të syllabuseve të lëndëve mësimore²²⁹ ku një pjesë e madhe të tyre nuk përmbajnë elementë praktik të zhvillimit të leksioneve si prezantim në power-point, role play, punë në grupe etj. Përsa i përket bashkëpunimit në drejtim të mësimdhënies me institucionet e tjera ka nisma me institucione si brenda dhe jashtë vendit të organizuara nga UMSH si konferenca, workshop-e, leksione të hapura, trajnime të stafit lidhur me rritjen e cilësisë në mësimdhënie²³⁰ Gjithashtu ka një klimë pozitive të ndërveprimit midis stafit dhe studentëve për çështjet mësimore. Gjatë vizitave në institucion rezultoi se studentët kanë qënë të angazhuar në veprimtari të ndryshme të karakterit kërkimor dhe profesional dhe njohuritë e fituara gjatë programit të studimit kanë qënë një bazë e shëndetshme që ata të kishin kompetenca profesionale për të çuar përpara angazhimet e marra në veprimtari si konferenca, punë në institucionet shkollore gjatë praktikave në institucion, dhe zhvillimin e seancave terapeutike me nxënës me problematika të ndryshme. Në mjediset e institucionit ka një mjedis laboratorik, pajisje dhe aparatura të cilët vihen në
--	---

²²⁹ Evidencë 14.2 Syllabuset Msc. në Psikologji me Profile

²³⁰ Evidencë 36: Analizë e punës vjetore e Departamentit të Psikologjisë-Sociologjisë.

	përdorim të studentëve sipas kërkesave të tyre për realizimin e detyrave të kursit ose edhe për aktivitete të tjera jashtëshkollore dhe aktivitete të ndryshme studentore. Labororet e teknologjisë së informacionit që janë në funksion të zbatimit të këtij program studimi²³¹, janë të kompletuar me pajisje kompjuterike (video-projektor dhe kompjutera të lidhur me internet) dhe janë të aksesueshëm për të gjithë studentët. Laboratori ishte në dispozicion të studentëve për të realizuar detyrat, disa orë edhe për mësimdhënie edhe për takimet apo projektet e ndryshme studentore. Studentët dhe stafi akademik kanë akses në një sërë aplikacionesh dhe programesh teknologjike si SPSS, Jetstore, ESC apo dhe Exceller, T-Translator, Ginger.
Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Personeli akademik i programit të studimit MSc. në “Psikologji” me profile, është gjithmonë i angazhuar në zhvillimin e mëtejshëm të njohurive dhe aftësive profesionale, duke marrë pjesë në diskutime shkencore, trajnime²³² dhe aktivitete të ndryshme²³³ brenda dhe jashtë vendit. Ata janë të përkushtuar për të qëndruar të informuar mbi zhvillimet më të fundit në fushën e psikologjisë dhe për të kontribuar në avancimin e kërkimit shkencor. Ky angazhim i vazhdueshëm në aktivitete²³⁴ profesionale dhe shkencore i mundëson stafit akademik të mbajë lidhje të ngushta me komunitetin ndërkombëtar të profesionistëve dhe të sjellë në programin e studimit²³⁵ praktikat më të mira dhe informacionet më të reja nga fusha e psikologjisë, duke përmirësuar kështu cilësinë e mësimdhënies dhe hulumtimeve.
Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	Në strategjinë e zhvillimit të UMSH²³⁶, strategjinë e zhvillimit të DPS²³⁷ dhe strategjinë e zhvillimit të programit të studimit MSc. në “Psikologji” me profile, studentët dhe veprimtaritë që kanë në fokus studentin janë prioritet kyç, të cilat synohen të realizohen përmes mbështetjes së zhvillimit të ideve, projekteve dhe studimeve kërkimore nga studentët. UMSH, FDSHH dhe DPS kanë realizuar praktika²³⁸ pozitive në këtë drejtim, duke

²³¹ Evidenca 16. Permbledhese e Tabelave.pdf

²³² Evidencë 28. Programi trajnimeve 2022-2023

²³³ Evidencë 47. Lëvizja e stafit akademik dhe administrativ

²³⁴ Evidencë 36. Raporti vjetor I DPS

²³⁵ Evidencë -Dokument Shtesë programi studimit

²³⁶ Evidencë 4. Strategjia e zhvillimit UMSH

²³⁷ Evidencë 5. Strategjia e zhvillimit të programit Msc. në psikologji me Profile

²³⁸ Evidencë 10. Marrëveshje bashkëpunimi

	përfshirë studentët në projekte kërkimore të mbështetura nga personeli akademik dhe duke ofruar mundësi financimi për konferenca studentore dhe forume diskutimi, që mundësojnë prezantimin e kërkimeve dhe përvojave të studentëve në fushën e psikologjisë. Kjo mbështetje ka për qëllim jo vetëm rritjen e kompetencave kërkimore të studentëve, por edhe krijimin e mundësive për ata që të zhvillojnë projekte të avancuara dhe të kontribuojnë në zhvillimin e mëtejshëm të fushës.			
Konkluzione	GVJ bazuar në analizën e kriterëve të standartit III.4 konkludon se programi i studimit MSc. në "Psikologji" përmbush plotësisht kriterin III.4, pasi ofron një balancë të shkëlqyer mes përgatitjes teorike dhe praktike, duke i mundësuar studentëve të zhvillojnë aftësi kërkimore dhe profesionale. Ata angazhohen në aktivitete praktike, studime të rastit dhe projekte kërkimore që kontribuojnë në rritjen e aftësive krijuese dhe analitike. Programi gjithashtu nxit përdorimin e metodave inovative dhe zgjidhjeve kreative për probleme komplekse. Përmes mundësive të praktikës dhe trajnimeve, studentët zhvillojnë aftësi profesionale që janë të nevojshme në tregun e punës. Po ashtu, programi është i orientuar drejt standardeve ndërkombëtare, duke përgatitur studentët për të kontribuar në nivele globale. Kjo qasje e integruar dhe e thelluar siguron një zhvillim të plotë të kompetencave shkencore dhe profesionale të studentëve NE programin e studimit MSc. në "Psikologji" me profile, garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe duke realizuar zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët. Bazuar në këto elemente thkesohet se ky standart plotësohet plotësisht konform kriterëve.			
Shkalla e përmbushjes së standartit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për	Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë, në Rregulloret përkatëse si në Rregulloren e organizimit UMSH ²³⁹ , kreu VI, neni 73

²³⁹ Evidencë 2. Rregullore e organizimit UMSH KREU X neni 73




detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.	Rregulloren e studimeve²⁴⁰ Kreu VI, neni 24, përcakton qartë komponentë si: Diplomimi, procedurat dhe detyrimet përmbyllëse. Hapat për mbrojtje diplome me mikrotezë për këtë program studimi bëhen të ditura përmes njësisë bazë dhe koordinatorit të programit. Rregullorja e diplomimit vendos rregullat normative të marrëdhënieve midis subjekteve të përfshira në procesin e diplomimit, të cilat përcaktojnë të drejtat e detyrimet e diplomantëve, rregullat për organizimin e procesit. Rregullorja ka si qëllim të sigurojë kuadrin e brendshëm rregullator të nevojshëm për mbarëvajtjen e procesit të diplomimit, si dhe të garantojë standarde të cilësisë në udhëheqjen e mikrotezës së diplomës. Rregullorja e diplomimit mbështetet në ligjin Nr. 80, datë 22.07. 2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” si dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, ligjin nr.8576, datë 03.02.2000 për bibliotekat, Statutin, Rregulloren e këtij universiteti dhe në VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”. Mbrojtja e diplomës realizohet: Në përfundim të programit të plotë të studimeve, studenti ka të drejtë të diplomohet për të fituar titullin Master i Shkencave në “Psikologji” me profile “Organizativ”, “Komunitar”, “Këshillim dhe Psikoterapi” me Orientim Njohës dhe Sjellor”, UMSH ka një udhëzues²⁴¹ të qartë e cila specifikon detajet mbi përgatitjen e diplomës.
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.	Departamenti i Psikologjisë-Sociologjisë në Fakultetin e Drejtësisë dhe Shkencave Humane si struktura përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit siguron që personeli akademik të supervizojë në mënyrë të vazhdueshme diplomantët duke ju vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse. Njësia bazë dhe personeli akademik supervizojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të mbrojtjes së diplomës. Departamenti, me fillimin e semestrit të parë të studimit, informon studentët për procedurat e diplomimit nëpërmjet tezës së diplomës.

²⁴⁰ Evidencë Rregullore e programit Msc.në psikologji me profile Kreu 6, neni 24

²⁴¹ Evidencë 21.Udhëzues për përgatitjen e diplomës

	Njësia bazë përcakton udhëheqësit për studentët të cilët miratohen nga dekani ²⁴² mund të diplomohen me mbrojtje teze diplome. Temat e diplomës udhëhiqen nga lektore që kanë titull ose gradë shkencore (së paku Dr. për programet e ciklit të dytë Master Shkencor), nga punonjësit shkencorë të njësisë bazë që i përshtaten studimeve të ofruara nga UMSH dhe që kanë kualifikim të lartë, si dhe nga kërkues shkencor të fushës përkatëse të diplomimit.
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Bazuar në udhëzimin ²⁴³ e lidhur me procedurat e përgatitjes dhe mbrojtjes së temës për diplomimin e studentëve Msc në “Psikologji” me profile, njësia bazë ngre një komision shkencor jo më pak se 3(tre) anëtarë, i cili është përgjegjës për të gjitha procedurat që lidhen me diplomimin e studentëve që përmbushin detyrimet përmbyllëse me mbrojtje teme diplome. Mbrojtja përpara komisionit është e hapur dhe studenti ka të drejtë të referojë punimin e tij, në jo më pak se 15 minuta. Anëtarët e komisionit dhe dëgjuesit në sallë rezervojnë të drejtën për t’i drejtuar pyetje studentit në lidhje me tezën e diplomës ²⁴⁴ .
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t’u paraqitur para komisionit.	Nga takimi me stafin akademik u vu re se stafi akademik ofron mbështetjen e duhur akademike dhe konsulencën e nevojshme që t’i mundësojë kandidatit të arrijë standarde të larta në provimin e mbrojtje të punimit të diplomës. Ata i pajisin studentët me udhëzuesin e përgatitjes së diplomës ²⁴⁵ . Kjo përfshin ndihmë si dhe realizimin në mënyrë rigoroze të mbështetur në procedurat e njësisë bazë mbi administrimin e punimit të diplomës ku komisioni i ngritur për këtë qëllim ndjek parimin e respektimit të kriterëve. Në udhëzuesin e punimit të diplomës për programin e studimit Master i Shkencave në “Psikologji” me profile, përcaktohen qartë struktura dhe plan veprimi që studenti do të ndjekë përgjatë punimit të diplomës.

²⁴² Evidencë 2: Rregullore e Organizimit UMSH Kreu X, neni 74

²⁴³ Ev. 3.05. Rregullore e diplomimit.

²⁴⁴ Vizita dy ditore në IAL dhe dokumentacioni shtesë. Rregullore e programit të studimit Master Shkencor në “Psikologji” me Profile”

²⁴⁵ Evidencë 21: Udhëzues orientuese për mbrojtjen e temës së diplomës

Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Sipas Rregullores së Studimeve të UMSH²⁴⁶ dhe FDSHH²⁴⁷ si dhe Manualit²⁴⁸ të punimit të diplomës rezultojnë se Departamenti i Psikologjisë-Sociologjisë, ka gjithë suportin e FDSHH dhe UMSH për të asistuar studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit. Përsa i përket përgatitjes së temës së diplomës kemi një procedurë formale të përcaktuar nga rregullorja e programit të studimit dhe monitoruar nga njësia bazë, e cila detyron studentin të paraqesë një projektpropozim pranë njësisë bazë dhe më pas përcaktohet nga komiteti shkencor dhe pedagogu udhëheqës. Për studentit dhe pedagogun udhëheqës janë të detyrueshme seancat e konsultimit individuale përgjatë gjithë procesit të përgatitjes së punimit, si dhe të nënshkrimit nga pedagogu udhëheqës të punimit final para se të dorëzohet tek komisioni i mbrojtjes. Udhëheqësi i diplomës përmes seancave të konsultimit individual i ofron mundësi studentit të ndjekë kriteret në përcaktimin e metodave kërkimore që i lejojnë të mbledh, të administrojë dhe përpunojë të dhënat në mënyrë shkencore
Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Nga biseda me anëtarët e stafit të Departamenti të Psikologjisë-Sociologjisë u theksua fakti që Komisioni i vlerësimit përbëhet nga jo më pak se tre anëtarë. Përbërja e komisionit të vlerësimit dhe kryetari i tij propozohen nga Përgjegjësi i Departamentit dhe i përcillet Dekanit të Fakultetit për miratim. Komisioni në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës/provimit të formimit bën vlerësimin e punës së tyre me notë. Notat regjistrohen në procesverbalin përkatës të firmosura nga anëtarët e komisionit dhe u komunikohen studentëve. Nota përfundimtare si rregull përcaktohet me pëlqimin e të gjithë anëtarëve të Komisionit
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të	Në Rregulloren e studimeve në UMSH²⁴⁹, neni 75,76 dhe në Rregulloren e studimeve në FDSHH²⁵⁰, neni 54 me objekt lëshimin e diplomave, certifikatave dhe suplementi i diplomës përcaktohen procedurat dhe kriteret për pajisjen e studentit në përfundim të studimeve të cilit të dytë me diplomën dhe suplementin e diplomës, të cilat janë të miratuara nga ministria

²⁴⁶ Evidencë 2 Rregullore e Organizimit UMSH

²⁴⁷ Evidencë 7.Rregullore e DSHH

²⁴⁸ Evidencë 21.Udhëzues për përgatitjen e diplomës

²⁴⁹ Evidencë 2.Organizimi UMSH Kreu X, NENI 75, 76

²⁵⁰ Evidencë 7. Rregullore e DSHH, Kreu X, NENI 54

studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	përgjegjëse për arsimin, të cilat janë dokumente me të cilat studenti në mënyrë zyrtare pajiset në përfundim të studimeve. Programi i studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Psikologji” me profile, është konform ligjeve dhe procedurave të QSHA-së për miratimin e Suplementit të diplomës dhe aneksin e listës së notave. Forma²⁵¹ e paraqitjes së diplomës është konform profilin dhe njohurive të fituara përgjatë këtij rrugëtimi profesional të studentëve. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën, listë notash dhe suplementin e diplomës²⁵²; në programin e studimit Master i Shkencave në “Psikologji” me profile “Organizativ”, “Komunitar”, “Këshillim dhe Psikoterapi me Orientim Njohës dhe Sjellor”. Kjo formë e paraqitjes së diplomës është konform dokumentacionit që shoqëron këtë rrugëtim profesional të studentëve. Ky kualifikim emërtohet në të njëjtën formë si në modelin e diplomës dhe në listën e notave e suplementin e diplomës dhe janë të unifikuara dhe me emërtimin e tij. Ky program studimi synon ndërthurjen midis kompetencave kërkimore e profesionale të studentit dhe pajisjen me diplomë referuar nivelit të 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve ku pasqyrohen të detajuara të dhënat mbi kualifikimin e arritur (në gjuhët shqip dhe anglisht).
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Institucioni për ruajtjen dhe arkivimin e informacionit dhe paisjen e studentit me informacionin e nevojshëm ndjek rregullat që i dikton legjislacioni. Pas përfundimit të studimeve nga studenti, kopje e dokumentacionit të tij të regjistrimit arkivohet dhe ruhet. Nga takimi me aktorët përkatës mësohet se institucioni disponon një databazë të plotë të të dhënave të studentëve dhe përpunon të dhëna statistikore sipas kërkesave të Ministrisë përgjegjëse për arsimin, Agjencisë për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë, apo nevojave të vet institucionit.
Konkluzione	<i>Universiteti Mesdhetar i Tiranës implementon një procedurë të qartë për detyrimet përmbyllëse të studentit në programin e studimit, duke siguruar përgatitjen e tyre me dokumentacionin e nevojshëm. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ), bazuar në të dhënat e evidentuara mësipër, konkludon se kriteret e lidhura me këtë standard janë të realizuar në bazë të rregullave dhe ligjeve përkatëse.</i>

²⁵¹ Evidencë 45. Modeli diplomës Msc në Psikologji me Profile

²⁵² Evidencë 46. Suplement diplome Msc. Në Psikologji me Profile




Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6

Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfutimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	Nuk aplikohet për këtë program studimi.
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	Nuk aplikohet për këtë program studimi.
Kriteri 3. Praktikantët profesionalë, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	Nuk aplikohet për këtë program studimi.
Konkluzione	
Shkalla e përmbushjes së	Nuk Përmbushet Përmbushet kryesisht Përmbushet plotësisht

standardit	përbushet	pjesërisht	kryesisht	plotësisht

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1

Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																																		
Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	Të dhënat e stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi, sipas kualifikimit sipas viteve 2022-2023; 2023-2024²⁵³, janë si më poshtë: <table><tr><th rowspan="2">Stafi i Programit të Studimit</th><th colspan="2">2023-2024</th><th colspan="2">2022-2023</th></tr><tr><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th></tr><tr><td>Prof. Dr.</td><td>1</td><td>0</td><td>1</td><td>-</td></tr><tr><td>Prof. Asoc. Dr.</td><td>3</td><td>1</td><td>1</td><td>2</td></tr><tr><td>Dr./ Phd.</td><td>7</td><td>2</td><td>10</td><td>1</td></tr><tr><td>MSc.</td><td>0</td><td>0</td><td>0</td><td>1</td></tr><tr><td>Total</td><td>11</td><td>3</td><td>12</td><td>4</td></tr></table> Konfirmojmë se personeli akademik i angazhuar në programin e studimit i përshatet kërkesave të këtij programi studimi. Janë angazhuar staf akademik me tituj dhe grada shkencore sipas kërkesave të Ligjin nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Instituconet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”. Në Rregullore Universiteti Mesdhetar ka parashikuar të gjitha modalitetet që sigurojnë zbatimin e kërkesave të Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe	Stafi i Programit të Studimit	2023-2024		2022-2023		PAE	PAK	PAE	PAK	Prof. Dr.	1	0	1	-	Prof. Asoc. Dr.	3	1	1	2	Dr./ Phd.	7	2	10	1	MSc.	0	0	0	1	Total	11	3	12	4
Stafi i Programit të Studimit	2023-2024		2022-2023																																
	PAE	PAK	PAE	PAK																															
Prof. Dr.	1	0	1	-																															
Prof. Asoc. Dr.	3	1	1	2																															
Dr./ Phd.	7	2	10	1																															
MSc.	0	0	0	1																															
Total	11	3	12	4																															

²⁵³ Evidencë 16. Të dhënat tabelore për personelin akademik në programin e studimit nr.7 fq.9

	Kërkimin Shkencor në Instituconet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” për rekrutimin dhe punësimin e personelit akademik me nivelin e duhur të kualifikimit akademik dhe fushën kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.
Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.	Personeli akademik efektiv i përfshirë në këtë program studimi mbulon ngarkesën mësimore sipas kornizës ligjore në fuqi, ku mbulon 76.6% të ngarkesës së orëve mësimore, (PAE 1230orë dhe PAK 375orë, nga totali 1605 orë gjithsej). Stafi me kohë të plotë i angazhuar ka tituj dhe grada shkencore por jo në të gjitha rastet është në përputhje me fushën e studimit. Ky master ka disa specifika në varësi të drejtimeve që ai ka, ndaj dhe fushat e mbulimit të stafit akademik duhet të përputhen me secilin drejtim, duke mbajtur në konsideratë faktin që 70% duhet të jetë personel akademik me kohë të plotë. <i>Ngarkesa mësimore e personelit akademik.</i>
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit (kontratat, mbështetja me projekte afatgjata, etj.) institucioni përgjithësisht garanton dhe dëshmon qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv ²⁵⁴ , ²⁵⁵ , ²⁵⁶ që janë pjesë e njësisë bazë. Lidhur me stafin e angazhuar në programin e studimit ²⁵⁷ , për të gjithë periudhën e akreditimit vlerësojmë këtë si aspekt pasi të dhënat përgjithësisht dëshmojnë qëndrueshmërinë e personelit akademik ²⁵⁸ efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore ²⁵⁹ . Edhe nga takimi me pedagogët gjatë vizitës në institucion ²⁶⁰ na u konfirmua si qëndrueshmëria shumë vjeçare e tyre por dhe plotësimi i dokumentacioneve ligjore mbi punësimin. GVJ konstatoi që procedura e rekrutimit është në përputhje me Ligjin 80/2015 ²⁶¹ , Kodin e Punës në RSH dhe aktet ligjore e normative në fuqi. Gjithashtu edhe sektori i burimeve njerëzore

²⁵⁴ Evidencë 2. Rregullore e organizimit UMSH.pdf

²⁵⁵ Evidencë 3. Organigrama.pdf

²⁵⁶ Evidencë 13.3. Cv e stafit akademik.pdf

²⁵⁷ Evidenca 40. Kontratat e Punes tip.pdf

²⁵⁸ Evidenca 16. Permbledherse e Tabelave.pdf tabelat 6.1, 6.2.

²⁵⁹ Shënime nga vizita në institucion.

²⁶⁰ Shënime nga vizita në institucion.

²⁶¹ Evidenca-60-Ligji i Arsimit të Lartë nr.80, dt.22_07_2015.pdf

	ka të standartizuar politikat dhe procedurat për qëndrueshmërinë dhe statusin e personelit ²⁶² .
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Institucioni në fillim të vitit akademik nëse ka nevoja për pedagogë efektivë ose me kohë të pjesshme publikon kriteret dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik. Kriteret që duhet të përmbushin kandidatët për pedagogë përcaktohen nga departamenti. Kandidati konkuron pas identifikimit të nevojave për të mbuluar ngarkesën mësimore. Të interesuarit pas marrjes së njoftimit në faqen zyrtare të universitetit, depozitojnë në zyrën e BNj dosjen me të gjitha dokumentet e kërkuara. Zyra e burimeve njerëzore pranon aplikimet, verifikon dokumentacionin e paraqitur, nëse është në përputhje me dokumentacionin e shpallur në thirrjen për aplikim dhe njofton Departamentin përkatës për përmbylljen e kësaj faze. Më pas është një komision <i>ad hoc</i> i cili ka në përbërjen e tij një shumicë të përfaqësuesve të departamentit, i cili vijon me procedurat, siç janë intervistat dhe vlerësimet e tjera. Sipas dokumentacionit të dorëzuar ky komision ka përgjegjësinë të kujdeset për rekrutimin e stafit me aftësi, njohuri dhe ekspertizë e eksperiencën e duhur për të ndihmuar UMSH dhe Departamentin në arritjen e objektivave të tij. Kjo zyrë kujdeset që njësia bazë të marr vendimin në bazë të kriterëve të përcaktuara nga baza ligjore në fuqi mbi rregullat dhe procedurat e rekrutimit të stafit akademik ²⁶³ , Ligjin Nr.80/2015 datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë, Ligji për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë, Ligji Nr.9887 dt.10.03.2008 ndryshuar me ligjin Nr.48/2012 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” etj. Procedurat e përcaktuara nga institucioni në lidhje me afatet, kriteret e përgjithshme dhe specifike për tu bërë pjesë e stafit akademik të UMSH-së janë konform rregullores për burimet njerëzore dhe rregullores së institucionit dhe në linjë me udhëzimet dhe legjislacionin për arsimin e lartë në vend. Kriteret shpallen publikisht në faqen online të Institucionit dhe përzgjedhja bëhet me dy faza. Faza e parë është vlerësimi i dosjes, pasi secili kandidat paraqet personalisht kërkesën dhe dokumentacionin përkatës pranë Zyrës

²⁶² Evidenca 2. Rregullore e organizimit UMSH.pdf

²⁶³Evidenca-25- Rregullore e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore.pdf

	së Burimeve Njerëzore, ku komisioni i ngritur nga Rekrori bën vlerësimin paraprak të kandidaturave sipas kërkesave. Faza tjetër është ajo e intervistimit të kandidatëve, në përfundim të së cilës komisioni dërgon në formë propozimi për miratim në Rektorat kandidatin e përzgjedhur. Kriteret që duhet të përmbushin kandidatët për pedagogë përcaktohen nga departamenti konform ligjit për arsimin e lartë dhe udhëzimeve të tjera në fuqi.
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar, edhe gjatë vizitës në institucion u evidentuan laboratorë brenda institucionit, por që nuk lidheshin drejtpërdrejtë me programin e studimit. Këto laboratorë i shërbejnë programeve të edukimit, që janë pjesë e institucionit në tërësi. Ndërkohë mjediset e tjera mësimore janë të përshtatshme për natyrën dhe organizimin e programit të studimit. <i>Megjithatë, GJV sugjeron që është e domosdoshme krijimi i një laboratorit me të gjitha mjetet dhe pajisjet e nevojshme që do i shërbejë këtij programi studimi. Departamenti ka menduar krijimin e laboratorit në lidhje me psikologjinë, kryesisht atë të njohjes dhe të sjelljes, por që ende nuk është finalizuar dicka. Për studentët e masterit është shumë e rëndësishme zhvillimi i orëve praktike në ambiente pune me klientë.</i>
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarit në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	GVJ gjatë vizitës në institucion dhe shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar, evidentoi që UMSH ruan dhe përditëson pranë zyrës së burimeve njerëzore të gjithë dokumentacionin e nevojshëm të personelit akademik. GJV zgjodhi disa dosje dhe shqyrtoi të gjitha të dhënat e përfshira në të, të cilat janë konform rregullave dhe kodit të punës. U konstatua gjithashtu që për të gjithë universitetin ka vetëm një zyrë burimesh njerëzore që përgjigjet për dokumentacionin e të gjitha departamenteve. <i>GVJ sugjeron që edhe në departament të ketë një dosje për secilin anëtar të personelit akademik ku ata të pasqyrojnë çdo vit kërkimet në fushë dhe kualifikimet e tyre.</i> Zyra e sekretarisë mësimore është përgjegjëse për ndjekjen e procesit të matrikullimit për të gjithë studentët e UMSH-së; monitoron databazën elektronike qendrore të UMSH-së; kontrollon e mban përgjegjësinë për hedhjen e të dhënave në Regjistrin themeltar, Regjistrin e arritjeve akademike dhe Regjistrin e lëshimit të diplomave; merr masat e duhura për ruajtjen dhe mbrojtjen e dokumentacionit sipas legjislacionit;

	përpilon statistikën dhe të dhënat rreth studentëve; mbajtjen e dokumentacionit të plotë dhe të rregullt mbi të dhënat biografike, të kualifikimit dhe të aktivitetit mësimor-shkencor dhe të administratës qendrore, mbi bazën e analizës së të dhënave që disponon.; ndjek daljet në pension të të gjithë personelit sipas legjislacionit dhe kryen veprimet përkatëse; nxjerr të dhënat e personelit që i nevojiten drejtuesve të institucionit, si dhe strukturave të tjera në kuadrin e studimeve të aktiviteteve të miratuara nga Rektorati;
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	UMSH ka nënshkruar marrëveshje me një sërë institucionesh dhe organizatash të tjera me qëllim krijimin e gjithë infrastrukturës së nevojshme për realizimin e praktikave profesionale, përmbylljen e studimeve të diplomës dhe të aktiviteteve të tjera formuese për programin e studimit. Institucioni është i angazhuar në krijimin e një mjedisi të përshtatshëm pune dhe me mundësi të barabarta për të gjithë personelin e angazhuar. Bazuar në informacionin e dosjes së vetëvlerësimit dhe takimeve apo informacioneve të marra gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi për përmbushjen e objektivave të këtij program studimi. UMSH-ja ka angazhuar personel akademik dhe kërkues, personel ndihmës akademik dhe personel administrativ.
Kriteri 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	UMSH-ja ka nënshkruar një sërë marrëveshjes institucionale ²⁶⁴ të lidhura me institucione dhe organizata në funksion të realizimit të filozofisë së tij, e cila është ndërtimi i një komuniteti, mësimi dhe krijimi në të cilin respektohet, vlerësohet dhe besohet çdo pjestar dhe zhvillohen pritshmëri të larta për veten dhe të tjerët, nëpërmjet inspirimit, arritjeve dhe ekselencës. Mbështetja e studentëve është e pakushtëzuar nga ana e UMSH-së duke ju mundësuar atyre një sërë kontaktesh ²⁶⁵ , ndërsa duke qenë se ky program nuk ka një fokus të mirëfilltë aplikativ, ende nuk ka strukura të mirëfillta për të garantuar praktikën profesionale të studentëve të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale <i>GVJ i sygjeron institucionit të ndërtojë politika specifike për organizimin e praktikës duke përcaktuar në to dhe mënyrën e përzgjedhjes së personelit mbikqyrës në ambientin pritës që</i>

²⁶⁴ <https://www.umsh.edu.al/c/183/bashkepunime-dypaleshe>

²⁶⁵ <https://www.umsh.edu.al/c/124/kontakte-te-nevojshme>

	<i>angazhohet në realizimin e praktikave profesionale, me detyrimet përkatëse të studentëve për t'u përmbushur gjatë praktikave dhe me kriteret e vlerësimit</i>			
Konkluzione	<i>GVJ nga analiza e dokumentacionit dhe gjatë vizitës në institucion, e klasifikon këtë standard të përmbushur kryesisht pasi referuar dokumentacionit në lidhje me ngarkesën e stafit akademik të angazhuar në këtë programi studimi na lejon që të shprehemi se ai përmbush standardet sasiore, ndërsa përsa i përket kualifikimit të posaçëm akademik gjykojmë se një pjesë e konsiderueshme e tyre kanë kualifikimin akademik në profilin psikologjik dhe vetëm një pjesë e vogël në disiplina të përfaqëta, jo veçanërisht sociale. Gjithashtu, mungojnë laboratorët që i vijnë në ndihmë këtij programi studimi. Pjesa e rekrutimit dhe ruajtjes së dokumentacionin është në nivele të duhura në zyrën e burimeve njerëzore në rektorat.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Fakulteti ka në dispozicion të procesit mësimor: auditore për leksione, auditore për seminare, zyra për personelin akademik dhe atë administrativ, sekretarinë mësimore, zyra për përgjegjësit e departamenteve, zyra e dekanit etj. Mjediset dhe ambjentet ishin të mjaftueshme dhe në përputhje me të gjitha kërkesat për një mësimdhënie optimale, duke respektuar kështu edhe hapësirat për çdo student. Të gjitha sallat e leksioneve dhe seminareve janë të mjaftueshme për numrin e studentëve për këtë program studimi. Kushtet janë optimale dhe në përputhje me kërkesat që ka vetë institucioni. Ambjentet janë në përputhje me kërkesat e programit duke krijuar mundësinë e krijimit të tryezave të rrumbullakta, fokus - grupeve etj <i>Të dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturën e fakultetit.</i>
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e	Gjatë vizitës në institucion, GVJ pati mundësinë të shihte ambjentet ku zhvillohej mësimi, zyrat e personelit e më gjerë.

mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Në tërësi universiteti zotëron ambiente komode, sallë konferencash etj. Studentët zhvillojnë orët e leksionit në salla të përshtatshme për një numër të lartë studentësh dhe orët e seminarit në salla më të vogla. Vlen të përmendet fakti se institucioni ka një vlerësim ndaj të gjithë nevojave të studentëve, duke ju krijuar akses në të gjithë mjediset e tij edhe studentëve me nevoja të veçanta ²⁶⁶ .
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Nga vizita në institucion, por edhe nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se mjediset mësimore të ofruara nga UMSH janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme ²⁶⁷ , të pajisura me infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e veprimtarisë akademike. <i>Mjediset mësimore në fakultet përmbajnë laboratorë të ndryshëm, por nuk janë në funksion të këtij programi studimi.</i> Ndërkohë laboratorit informatikës është i vetmi që është në dispozicion për studentët e këtij programi studimi. Do ishte në interes të studentëve për këtë program krijimi laboratorëve të dedikuar për to. Sallat e leksioneve dhe seminareve janë të mjaftueshme, por mungojë laboratorët më specifik për këtë program studimi si psh zyra këshillimi, vlerësimi etj. <i>Mjediset e fakultetit njësi bazë.</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Në mjediset e institucionit ka një mjedis laboratorik, pajisje dhe aparatura të cilët vihen në përdorim të studentëve ²⁶⁸ sipas kërkesave të tyre për realizimin e detyrave të kursit ose edhe për aktivitete të tjera jashtëshkollore dhe aktivitete të ndryshme studentore. Laboratorët e teknologjisë së informacionit që janë në funksion të zbatimit të këtij programi studimi ²⁶⁹ , janë të kompletuar me pajisje kompjuterike (video-projektor dhe kompjutera të lidhur me internet) dhe janë të aksesueshëm për të gjithë studentët. Laboratori ishte në dispozicion të studentëve për të realizuar detyrat, disa orë edhe për mësimdhënie edhe për takimet apo projektet e ndryshme studentore. Studentët dhe stafi akademik kanë akses në një sërë aplikacionesh dhe programesh teknologjike si SPSS, Jetstore, etj.
Kriteri 5. Institucioni	Praktika mësimore zhvillohet pranë institucioneve dhe shoqërive

²⁶⁶ Evidenca 20. Rregullore per studentet me aftesi ndryshe.pdf

²⁶⁷ Evidenca 27. Relacion i Verifikimit te godines.pdf

²⁶⁸ Evidenca 27. Relacion i Verifikimit te godines.pdf

²⁶⁹ Evidenca 16. Permbledherse e Tabelave.pdf

garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorie me kapacitetet e nevojshme.	shtetërore ose/dhe private, me të cilat UMSH ka marrëveshje në përputhje me profilin e programit të këtij masteri me disa drejtime. Të gjitha marrëveshjet janë në përputhje me programin e studimit. Ato janë marrëveshje në nivel universiteti ku secili departament i përdor në varësi të programeve dhe nevojave që ka. Ajo që i mungon këtij programi studimi është një laborator ose një zyrë këshillimi për të gjithë studentët, ku mund të punojnë me raste reale.			
Konkluzione	<i>Nga vizita në institucion, por edhe nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se mjediset mësimore të ofruara nga UMSH janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme, të pajisura me infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e veprimtarisë akademike. Në tërësi universiteti zotëron ambiente komode, sallë konferencash etj. Studentët zhvillojnë orët e leksionit në salla të përshtatshme për një numër të lartë studentësh dhe orët e seminarit në salla më të vogla.</i> <i>GVJ e klasifikon të përmbushur plotësisht këtë standard, me përjashtim të laboratorëve dhe zyrës së këshillimit që lidhet drejtpërdrejtë me këtë program studimi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
----------	------------------------

Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Literatura bazë në gjuhën shqipe²⁷⁰, e cila është dhe gjuha e realizimit të këtij programi studimi përfshin tekste të cilat nëse i referohemi syllabuseve të lëndëve mësimore të vënë në dispozicion krijojnë hapësira për përmirësim. Një pjesë e literaturës bazë gjykohet si literaturë akademike dhe pse jo e 5 viteve të fundit, jo e përditësuar duke mos plotësuar marrjen e dijeve bashkëkohore nëpërmjet leksioneve të vënë në dispozicion nga pedagogu i lëndës. Përsa i përket literaturës në formë elektronike²⁷¹ në gjuhë të huaj mund të thuhet se është bërë një përpjekje pozitive përmes abonimit në bibliotekën online²⁷² rezulton se për nevojat e studentëve janë vënë në dispozicion një sërë platformash elektronike si Open Dissertation dhe Directory of Open Access Journals, të cilat mund të lehtësojnë aksesin në burime bibliografike të viteve të fundit dhe që janë publikime shkencore të indexuara dhe me faktor impakti. Sfidë për studentët e këtij programi studimi mbetet niveli i njohurive në gjuhën angleze me qëllim që të përfitojnë nga këto mundësi që u krijohen nga insititucioni, të cilat vijojnë të përmirësohen²⁷³.
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar, por edhe gjatë intervistës me grupet e punës, nuk u evidentua një përpjekje konkrete lidhur me përditësimin e literaturës për këtë program studimi. Një pjesë e lëndëve mbulohen me leksione të përgatitura nga pedagogu ose libra të cilat kanë kohë që janë botuar. <i>GVJ sugjeron që kjo të mbahet në konsideratë për vazhdimësinë e këtij programi. Të përditësohet literatura me zhvillimet e fundit në fushë.</i>
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Kapaciteti që ka biblioteka nuk garanton mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga të gjithë studentët e programit të studimit. Për fushën e psikologjisë janë më shumë libra në versionin online sesa në atë të printuar dhe në gjuhën shqipe. Biblioteka e vizituar nga GVJ-ja ndodhej në katin 0 të godinës qendrore të universitetit, mbulon një sërë shërbimesh si arkivim të çdo kopje të libri të ri fizik që hyn, dixhitalizim të skedarëve,

²⁷⁰ Evidenca 14.2. Syllabuse 2.pdf ; Evidenca 14.2. Syllabuse 3.pdf & Evidenca 14.2. Syllabuse 4.pdf

²⁷¹ Evidenca 43. Material per biblioteken.pdf

²⁷² <http://biblioteka.umsh.edu.al:8020/EbooksServer/user-registration/index.php>

²⁷³ Evidenca 43. Kerkese per libra.pdf

	arkivim të punimit të diplomës, vendadresim i stafit dhe studentëve për nevojat që lidhen literaturën mësimore²⁷⁴, kërkimore dhe ekstrakurrikulare. Oraret për ditët e javës dhe gjatë fundjavës janë 8.00-16.00. <i>GVJ sugjeron që është e nevojshme që Fakulteti të bëjë përpjekje të mëtejshme për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit pasi është i varfër dhe jo i pajisur me literaturë bashkëkohore.</i> <i>Fondi librit.</i>²⁷⁵
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Institucioni siguron tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse në gjuhën shqipe dhe të huaj. Në fondin e bibliotekës gjenden libra në fushën e psikologjisë në veçanti dhe shkencave sociale në tërësi. Literatura është fizikisht dhe online në gjuhën shqipe dhe gjuhë të huaja. Në bibliotekë ka gjithashtu revista, buletine shkencore në format hardcopy dhe elektronik, fond ky që plotëson nevojat e të gjithë përdoruesve. Vihet re nevoja e pajisjes me libra në fushën e psikologjisë së edukimit, të përditësuara të viteve të fundit. <i>GVJ sugjeron pajisjen me libra që lidhen me programin e studimit ku studentët të kenë mundësi t'i aksesojnë fizikisht në gjuhën shqipe.</i>
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Kapacitetet e bibliotekës garantojnë mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë e pa pagesë nga të gjithë studentët e programit të studimit dhe nga i gjithë stafi akademik. Biblioteka përfaqësohet në Bibliotekën Virtuale të Shqipërisë "COBISS.AL" dhe koleksioni i saj përpunohet nga ana shkencore bibliografike konform standardeve ndërkombëtare duke përdorur UDC (sistemi i klasifikimit), ISBD (International Standard Bibliographic Description), formatin MARC, Z39.50 SRU. Institucioni ofron platformën e bibliotekës digjitale ULibrary në linkun http://biblioteka.umsh.edu.al:8020/EbooksServer/user-registration/index.php me kredencialet e vete universitetit. Shërbimi i informacionit elektronik ofrohet me e-mail/katalog elektronik. Çdo student ka të drejtën e anëtarësimit falas në bibliotekë dhe te aksesit të platformat online.

²⁷⁴ Shënime gjatë vizitës në institucion

²⁷⁵ <http://biblioteka.umsh.edu.al:8020/EbooksServer/user-registration/index.php>

Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Biblioteka e Universitetit ka hapësira dhe u jep mundësi studentëve të bëjnë kërkime online apo të studiojnë materiale fizike në një mjedis me hapësira dhe kushte komode për studim. Ajo është e pajisur me tavolina studimi, kompjutera dhe internet pa limit përmes sistemit wi-fi për të gjithë studentët dhe anëtarët e personelit që duan të shfrytëzojnë mjediset e bibliotekës për shfletim të literaturës për nevoja të ndryshme. Çdo student ka të drejtën e anëtarësimit falas në bibliotekë dhe të aksesojë bibliotekën online.
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Biblioteka qëndron e hapur çdo ditë nga ora 08.00 – 16.00, në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj. Oraret e shërbimit janë të shpallura në hyrje të bibliotekës, e cila ka një hapësirë të dedikuar. Nga vizita në bibliotekë konfirmohet se punonjëset e saj ishin duke kryer procese pune, të gatshme t'i shërbenin të interesuarve. Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar, por edhe gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton që orari përdorimit të bibliotekës është në përshtatje me zhvillimin e procesit mësimor. <i>Të dhëna mbi orarin e shërbimit të bibliotekës</i>
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	Gjatë vizitës në institucion u konstatua se pranë bibliotekës kishte një numër të konsiderueshëm tekstesh online dhe fizik në fushën e psikologjisë, të cilat mund të përdoren nga stafi dhe studentët. Fakulteti bën përpjekje për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit, duke përfituar edhe nga donacionet e pedagogëve me botimet e tyre. GVJ gjatë vizitës dhe intervistave të zhvilluara evidentoi një kërkesë në rritje për pasurimin e fondit ekzistues në këtë drejtim. Prania e një reviste periodike krijon mundësi për stafin akademik të botojë gjetjet e tyre, por jo vetëm. Universiteti ka zhvilluar edhe konferenca studentore duke krijuar një hapësirë të vogël studimi edhe për punimet e studentëve.
Konkluzione	<i>GVJ nga analiza e dokumentacionit ekzistues, vizitës në</i>

	<i>institucion dhe intervistave të zhvilluara sugjeron që të pasurohet edhe më shumë me libra në fushën e psikologjisë biblioteka në nivel universiteti, duke i ardhur kështu në ndihmë këtij programi studimi. Gjithashtu do ishte në interes të studentëve shtimi posteve të punës me kompjutera dhe programe kompjuterike që mund të përdoren për analizat sasiore dhe cilësore në fushën e psikologjisë. Këto rekomandime i shërbejnë përmirësimit të cilësisë së shërbimit për këtë program studimi, edhe pse aktualisht nga vizita në institucion kushtet janë në tërësi të përshtatshme.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Referuar RVB-së, dhe vizitave në Institucion i gjithë informacioni në lidhje me studentët menaxhohet nëpërmjet sistemit nga sekretaria mësimore. Sekretaria mësimore regjistron elektronikisht të dhënat e studentëve duke ndjekur të gjitha procedurat sipas rregullave në fuqi. Ajo mban në dosje dhe arkivon dokumentet e çdo studenti të regjistruar, të ç’regjistruar apo që kanë përfunduar studimet. Gjithashtu, sekretaria bën kalimin e studentëve në vite pasardhëse sipas numrit të parashikuar, ruan në formë elektronike procesverbalet e vlerësimit. Gjithashtu, falë këtij sistemi informatik sekretaria nxjerr dokumente elektronike mbi bazën e të dhënave, siç janë vërtetime në lidhje me statusin e studentit; lista notash të studentit, raporte statistikore në lidhje me ecurinë e studentëve si dhe në lidhje me numrin e studentëve sipas programeve mësimore. Gjithashtu për çdo pamundësi apo shqetësim studentët kanë të mundur të kontaktojnë në çdo kohë institucionin dhe t’u ofrohet ndihmë edhe për sistemin²⁷⁶. Sistemi është i konfiguruar me role të përcaktuara dhe informacioni ruhet në një bazë të dhënash

²⁷⁶ <https://www.umsh.edu.al/c/12/kontakt>

	të centralizuar. Sistemi ofron informacione të ndryshme për vijueshmërinë e vitit aktual akademik.
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Fakulteti nuk ka një platformë e cila ti shërbejë drejtpërsëdrejti sistemit të brendshëm të menaxhimit që administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit. I gjithë dokumentacioni dhe aktiviteti i personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrative menaxhohet dhe ruhet në zyrën e Burimeve Njerëzore e cila është vetëm në nivel Rektorati. Në këtë zyrë secili pedagog ka dosjen e tij personale të përditësuar me zhvillimet që stafi ka bërë gjatë punës së tij kërkimore-shkencore, në drejtim të fitimit të gradës apo titujve akademik. GVJ gjatë vizitës në këtë zyrë dhe intervistës me personelin, konstatoi që i gjithë universiteti ishte i përmbledhur vetëm në një zyrë. Për këtë arsye, nisur nga numri i madh i stafit që punon në UMSH, GVJ sugjeron krijimin e strukturave të vogla pranë secilit fakultet, për të lehtësuar dhe kontrolluar më mirë punën në këtë sektor. 277
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Institucioni zbaton me rigorozitet detyrimet ligjore për mbrojtjen e të dhënave personale që lindin nga Ligji Nr.9887, datë 10.03.2008 dhe gjithë akteteve të tjera ligjore ²⁷⁸ mbi përpunimin e të dhënave të punonjësve të sektorit privat. Referuar dokumentacionit të dorëzuar evidentohet që sistemi menaxhimit siguron akses për informacione dhe dokumente për studentët dhe pedagogët. Rregullorja EMS.
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	GVJ konstaton se institucioni ka vënë në dispozicion për komunikimin e brendshëm interaktiv të stafit akademik dhe studentëve platformën SMS, që prej vitit 2017 dhe në vitin 2020 kjo platformë edhe është përmirësuar me module të tjera shtesë si Zoom Cloud Meeting dhe G-Suite. Sistemi i menaxhimit komfirmohet edhe nga studentët se ju ofron akses në një fushë të gjerë informacioni si regjistrimi i në lëndët përkatëse, akses i plotë në literaturën e lëndëve që ndjekin dhe në informacionet shtesë dhe ndihmëse, vlerësimet e vijueshme nga pedagogu, vlerësimet përfundimtare të lëndës. Çdo pedagog mund të shohë vetëm lëndët e veta dhe të menaxhojë krejt lehtësisht gjithë

²⁷⁷ Evidenca 2. Rregullore e org te UMSH

²⁷⁸ Evidenca 31. Manual i përdorimit te platformes elektronikt.pdf

	literaturën e lëndëve përkatëse. Gjithashtu departamenti komunikon edhe me platforma të tjera ²⁷⁹ , të hapura e publike, kryesisht ne rrjetet sociale me informacione më të përgjithshme e në kohë reale. Të gjithë përdoruesit kanë akses në informacion dhe mund të menaxhojnë detyra dhe aktivitete në lidhje me punën, sipas rolit dhe pozicionit të tyre të punës.
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktiviteteve akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit shoqërues të programit të studimit, GVJ konstatoi se aktualisht nuk ka një sistem institucional funksional që të mund të monitoroj në kohë reale aktivitetin mësimor të personelit akademik dhe administrativ. Raportimi i aktiviteteve të ndryshme realizohet vetëm në faqen zyrtare të UMSH <i>GVJ sugjeron krijimin e një portali të dedikuar për studentët të cilët do të kenë mundësi të informoheshin në kohë reale për procesin e mësimin, programet, materialet lëndore, literaturën e rekomanduar etj.</i>
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Në faqen zyrtare të UMSH-së https://ëëë.umsh.edu.al/ paraqitet një informacion i plotë mbi historikun, misionin dhe filozofinë, partnerët, stafin drejtues dhe administrimin, guidat për studentët e ardhshëm si dhe mbi programet, së bashku me bio të detajuara të personelit akademik etj. Përmes saj, por edhe rrjeteve sociale, institucioni promovon veprimtaritë e ndryshme me karakter akademik por edhe social-kulturor. Kjo faqe bën publikimin në dy gjuhë, shqip dhe anglisht ²⁸⁰ . Faqja Web paraqet në mënyrë të strukturuar informacione mbi universitetin, pranimet, fakultetet, programet e studimit, për studentët ²⁸¹ , si jeta studentore, klubi studentor, këshillat, financimet, projektet dhe shërbimet për studentë. Informacioni është lehtësisht i aksesueshëm dhe në të gjendet informacion i përgjithshëm mbi pranimin ²⁸² e regjistrimin, objektivat e programit dhe kurrikulat. Universiteti jep informacion të dedikuar për studentët e tj dhe jetën akademike, por i kushton vëmendje dhe aspekteve të tjera zhvillimore rinore nëpërmjet faqes së dedikuar studentëve ²⁸³ , kërkimit

²⁷⁹ https://www.facebook.com/mesdhetari/?locale=sq_AL;
<https://www.linkedin.com/company/universiteti-mesdhetar-i-shqiperise;>
<https://www.4icu.org/reviews/17938.htm>; <https://www.instagram.com/keshillistudentorumsh/>
<https://regjistri.urdhriipsikologut.al/members/detail/irva-rama>

²⁸⁰ <https://www.umsh.edu.al/>

²⁸¹ <https://www.umsh.edu.al/c/145/studentet>

²⁸² <https://www.umsh.edu.al/c/150/kriteret-e-pranimit>

²⁸³ <https://www.umsh.edu.al/c/145/studentet>

	shkencor ²⁸⁴ , ndërkombtarizimit ²⁸⁵ .			
Konkluzione	<i>GVJ e klasifikon të përmbushur plotësisht këtë standard. Të gjitha të dhënat që publikohen janë në nivel universiteti, por do ishte në interes të fakultetit të ketë një faqe të dedikuar për secilin program studimi ku të gjithë të kenë mundësi të informohen.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	GVJ konstaton se raporti financiar hartohet në nivel institucioni çdo vit. Raportet përmbajnë të dhëna të hollësishme për llogaritjen e kostove të programit dhe plani për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për një cikël të plotë studimi. GVJ nuk arriti të evidentoj pasqyra dhe raporte financiare të të ardhurave e shpenzimeve të Departamentit dhe specifikisht planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi, si dhe nuk evidentoi raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit Master në “Psikologji” me profile dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi nga universiteti. <i>Ndaj në këto kushte GVJ sygjeron që të ndërtohen politika specifike për çdo njësi bazë përgjegjëse për programet e studimit dhe të hartohen e miratohen plane për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</i>

²⁸⁴ <https://www.umsh.edu.al/c/147/kerkimi-shkencor>

²⁸⁵ <https://www.umsh.edu.al/c/148/nderkombetarizimi>

Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar, por edhe gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se në raportin financiar paraqiten në mënyrë të hollësishme të gjitha detyrimet financiare, pagat, shpenzimet, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës, si edhe aksesin në bibliotekat on-line. Ky plan financiar buxhetohet më pas sipas nevojave dhe kërkesave që ka vetë departamenti, në funksion të programit të këtij masteri. Asnjë program studimi nuk ka buxhet të individualizuar. <i>GVJ rekomandon hartimin e planit të financimit, i cili duhet të jetë sa më i detajuar dhe të përmbajë financimin e burimeve njerëzore për programin e studimit. Plani i financimit duhet hartuar duke mbajtur në konsideratë nevojat e zhvillimit të veprimtarive mësimore dhe shkencore edhe duke ndarë të ardhurat sipas burimeve të krijimit të tyre (si shpenzimet operative për blerje mallrash e shërbimesh dhe preventive për pajisje elektronike mbështetëse të procesit mësimor dhe zëra të tjerë, sipas natyrës specifike).</i>
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	Njësia e Auditimit të Brendshëm, ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe Urdhrit të Ministrit të Financave nr 100 datë 25.10.2016 “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”. Institucioni kryen auditim të përvitshëm bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në takimet e zhvilluara gjatë vizitës në institucion. FDSHH harton raportet dhe pasqyrat financiare, të kërkuara nga ligji. Këto raporte financiare dokumentojnë gjendjen financiare dhe shpërndarjen e burimeve financiare.
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të	Zyra e financë kontabilitetit është përgjegjëse për menaxhimin financiar dhe zbatimin e politikës financiare të institucionit²⁸⁶. Një nga detyrat e kësaj zyre është dhe nxjerrja e të gjitha të dhënave që u duhen titullarëve të institucionit për raportime dhe studime të ndryshme dhe mbi bazën e të dhënave që diponon

²⁸⁶ Evidenca 2. Rregullore e organizimit UMSH.pdf, neni 31

miratuar të vitit paraardhës.	bën dhe studime dhe propozime për plotësimin e strukturave financiare dhe metodave të punës ²⁸⁷ . Nga takimet e realizuara gjatë vizitës në institucion ²⁸⁸ ata na informuan se ishin pjesë e analizave vjetore të punës së institucionit dhe në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit. Sërish shohim që raportimet janë në nivel universiteti, duke mos mundësuar kuptueshmërinë mbi realizimin e buxhetit specifikisht për këtë program studimi.			
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.	Informacioni i vënë në dispozicion mbi qëndrueshmërinë financiare të institucionit dëshmon se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit. Referuar të dhënave institucioni ka asete që justifikojnë mbulimin e shpenzimeve në drejtim të zhvillimit e vazhdimësisë institucionale.			
Konkluzione	<i>Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar, por edhe gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se në raportin financiar paraqiten në mënyrë të hollësishme të gjitha detyrimet financiare, pagat, shpenzimet, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës, si edhe aksesin në bibliotekat on-line. GVJ e klasifikon të përmbushur plotësisht këtë kriter, pasi zbatohen procedurat ligjore dhe rregullat në fuqi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
--	-----------------------	------------------------------	-----------------------------	------------------------------

²⁸⁷ Evidenca 2. Rregullore e organizimit UMSH.pdf, neni 31, pika 2, gërma j.

²⁸⁸ Shënime gjatë vizitës në institucion

				X
--	--	--	--	---

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Informimi i studentëve mbi strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve fillon që në takimet e hapura që zhvillojnë me studentët potencial, nëpërmjet komunikimit me sekretarinë kur ata aplikojnë. Gjithashtu informacion mbi organigramën e Fakultetit dhe strukturën e programit të studimit paraqiten në faqen e internetit të UMSH ²⁸⁹ . Programi i studimit është ndërtuar dhe bazuar në rregulloren e vetë përkatëse të programit të studimit, në rregulloren e universitetit, si dhe në Ligjin e Arsimit të Lartë. Dhe të gjitha procedurat që lidhen me pranimin dhe vazhdimin e studimeve deri në diplomim janë në përputhje me ligjin për arsimin e lartë, udhëzimet e MASR si dhe statutin dhe rregulloren e brendshme të këtij programi studimi. Informacioni për kriteret ²⁹⁰ dhe kuotat e pranimin, dokumentacionin ²⁹¹ dhe organizimin i programit të studimit ²⁹² , procedurën e aplikimit publikohet online, në broshurën informuese dhe është pjesë e fushatave informuese përmes fletëpalosjeve dhe aktiviteteve të Departamentit ²⁹³ .
Kriteri 2. Politikën dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit. Institucioni mbështetet në rregulloren e tij, procedurën e transferimit, për të rregulluar në përputhje me ligjet në vend nga hyrja në dalje. Kandidati duke ndjekur një procedurë të caktuar dhe në afatet ligjore të përcaktuara me ligj mund të kryej ndërprerjen, transferimin e studimeve në përputhje me të drejta të plota për të gjithë. Të

²⁸⁹ Evidenca 4. Plani strategjik i zhvillimit UMSH

²⁹⁰ <https://www.umsh.edu.al/c/150/kriteret-e-pranimi>

²⁹¹ <https://www.umsh.edu.al/c/151/dokumentacioni>

²⁹² <https://www.umsh.edu.al/media/65188ddf8ef23.pdf>

²⁹³ <https://www.umsh.edu.al/c/217/formulare-aplikimi>

	gjitha procedurat që lidhen me pranimin dhe vazhdimin e studimeve deri në diplomim janë në përputhje me ligjin për arsimin e lartë, udhëzimet e MASR si dhe statutin dhe rregulloren e brendshme e këtij fakulteti. Gjithashtu fakulteti në fillimin e çdo viti akademik ngre komisionin ad-hoc për procesin e pranimit të studentëve. Informacioni për kriteret dhe procedurën e aplikimit publikohet online, në broshurën informuese dhe është pjesë e fushatave informuese përmes fletëpalosjeve²⁹⁴. Këtu duhet evidentuar mungesa e Zyrës së Karrierës për fakultetin, e cila do të shërbente si një urë shumë e mirë informimi dhe komunikimi për studentët. <i>Për këtë arsye, GVJ sugjeron hapjen e një zyre karriere në nivel fakulteti për të ndihmuar të gjithë studentët në orientimin e tyre gjatë studimeve por edhe në tregun e punës.</i> Kjo zyrë sipas evidencave ekziston deri dikur vetëm në nivel universiteti, gjë që tregon se nuk është pranë secilës njësi bazë.
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.	Në faqen zyrtare të UMSH janë të shpallura të gjitha informacionet që lidhen me procedurat e pranimit bazuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi, dokumentacioni që kërkohet, kohëzgjatja e programit dhe numri i krediteve që fiton studenti. E gjithë procedura është paraqitur në mënyrë transparente. Procedurat që lidhen me transferimin, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku përmes informacionit në sekretari dhe faqen zyrtare të universitetit mbi këtë procedurë dhe dokumentat e kërkuar për transferimin e studimeve konform rregullave dhe ligjeve në fuqi.
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë	Programi i studimit pranon kandidatët në varësi të kapaciteteve infrastrukturore dhe akademike të fakultetit dhe sipas kriterëve specifike që mund të propozohen nga Departamenti. Kriteret e pranimit²⁹⁵ për programet e studimit të ciklit të parë dhe të dytë janë të pasqyruara si informacione specifike edhe në faqen zyrtare, po ashtu dhe duke dokumentacioni i nevojshëm për regjistrim²⁹⁶ në programet e studimit, si dhe procesi i transferimit²⁹⁷, si një e drejtë e ligjshme e çdo studenti; duke

²⁹⁴ <https://www.umsh.edu.al/c/143/pranimet>

²⁹⁵ <https://www.umsh.edu.al/c/150/kriteret-e-pranimit>

²⁹⁶ <https://www.umsh.edu.al/c/151/dokumentacioni>

²⁹⁷ <https://www.umsh.edu.al/c/153/transferimet>

lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	lehtësuar kështu praktikën e çdo studenti në këtë institucion. Procedurat e mësipërme i mundësojnë aksesin kujtdo që është i interesuar në çdo kohë dhe në institucionet e varësisë²⁹⁸, në përputhje me ligjin 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe aktet rregullative të institucionit. Kriteret që duhet të plotësohen për t’u pranuar në programin e studimit, informacione të cilat janë dhe lehtësisht të aksesueshme²⁹⁹. Në dokumentacion e atashuar nuk gjenden vendime (të senatit) mbi miratimin e kuotave të pranimeve për vitet respektive akademike për programin Master në Psikologji me profile, ndaj e kemi të pamundur të vlerësojmë mbi plotësimin e kuotave apo mbi lehtësimet mbi kuotat për kategori të veçanta të ndryshme (për shtetas shqiptar brenda vendit, për aplikantë për program të dytë studimi, për transferimet, për minoritetin Romë dhe Egjiptian, kouta për personat AK apo për aplikantët nga trojet shqipfolëse). GVJ mbështetur në dokumentacion dhe vizitën në IAL konfirmon që kriteret, procedurat e pranimi të përzgjedhjes së studentëve janë në përputhje me VKM në fuqi. Edhe procedurat për përparimin e studentëve, transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme, të vlerësimit të dijeve dhe diplomimit janë përcaktuar qartë dhe kuptueshëm në rregulloret e institucionit
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Përpara fillimit të çdo viti akademik, UMSH informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për programin e studimit. Vendimet për kriteret specifike dhe të përgjithshme, për pranimin në programin e studimit, janë në përputhje me ligjin e arsimit të lartë, aktet nënligjore dhe procedurat që ndiqen në maturën shtetërore e më gjerë. Gjithashtu maturanët informohen për kriteret e pranimi dhe kërkesat për t’u regjistruar edhe nga mediat sociale shumë lehtësisht të aksesueshme nga të rinjtë³⁰⁰. Maturanëve ju jepet mundësia të takohen dhe me stafin akademik të programit të studimit për të cilin kanë interes gjatë vizitave në institucion. Informacione të gjera mbi programet e studimit janë gjithashtu në dispozicion në internet³⁰¹.

²⁹⁸ <https://www.asc.al/en/hei-list/hei/shkolla-e-larte-private-mesdhetare-e-shqiperise-2>

²⁹⁹ <https://www.umsh.edu.al/media/5f6c48a037f4b.pdf>

³⁰⁰ <https://m.facebook.com/mesdhetari/posts/10158594125948449/>

³⁰¹ <https://www.umsh.edu.al/c/151/dokumentacioni>

Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	Përpara fillimit të çdo viti akademik, UMSH harton kriteret e përgjithshme dhe të veçanta duke patur në fokus kandidatët me aftësi të veçanta, pakica dhe shtresa të marginalizuara. UMSH zbaton të gjitha rregullat dhe ligjet në fuqi referuar këtij procesi.
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	Institucioni është një universitet privat dhe për këtë program studimi nuk ka parashikur kritere të dedikuara për kandidatët nga shtete të tjera. Gjithashtu nga vizita në institucion informohemi se nuk ka interes nga studentë të ardhur nga shtete të tjera dhe nuk kanë pasur asnjë rast të tillë, por cilido student që shpreh interes qoftë edhe me kërkesa online ³⁰² trajtohet me profesionalizëm si dhe asisitohet në plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm për përzgjedhjen e drejimit të e studimeve që dëshiron.
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimin në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	UMSH-ja ka të përfshirë në rregulloren e tij edhe politikat për ndihmimin e studentëve (bursat) ³⁰³ për shtresat e marginalizuara ekonomikisht. Ky institucion ofron një sërë bursash si: bursë e plotë sociale i akordohet aplikantëve nga grupet në nevojë (familje me ndihmë ekonomike dhe mesatare shumë të lartë, status jetimi, fëmijë dëshmorësh në polici, në forca të armatosura, me aftësi ndryshe, komunitetet e marginalizuara, etj të ngjashëm).; bursë ekselence i akordohet studentëve të regjistruar për herë të parë me mesataren 9.7-10 nga shkolla e mesme, përfshirë provimet e maturës shtetërore; bursë për studentë shumë të mirë e përfitojnë deri në 2% e të gjithë studentëve të regjistruar për herë të parë kur mesatarja e shkollës së mesme është nga 9,3 deri në 9,6 dhe me kushte ekonomike jo të favorshme.; bursë talenti akordohet për një numër aplikantësh deri në 2% e numrit të studentëve etj.
Konkluzione	<i>Programi i studimit pranon kandidatët në varësi të kapaciteteve infrastrukturore dhe akademike të fakultetit dhe sipas kriterëve specifike që mund të propozohen nga Departamenti. Në faqen zyrtare të UMSH janë të shpallura të gjitha informacionet që lidhen me procedurat e pranimin bazuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi, dokumentacioni që kërkohet, kohëzgjatja e</i>

³⁰² <https://docs.google.com/forms/d/e/1FAIpQLSc6Wmo4Op-q6lqfDbtKJhL5M7qHSOmXqhBMdzg1E1CaSfeOKQ/viewform>

³⁰³ <https://www.umsh.edu.al/c/110/bursat>

	programit dhe numri i krediteve që fiton studenti. E gjithë procedura është paraqitur në mënyrë transparente. GVJ konstaton se IAL përmbush të gjitha kriteret dhe rregullat në fuqi lidhur me pranimin, transferimin, regjistrimin, orientimin e studentëve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	GVJ konstaton se informacioni mbi strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit, kriteret e përparimit dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin i vihet në dispozicion studentëve nëpërmjet këshillimit me stafin akademik gjatë fazës së interesimit për programin e studimit; informacionit që merret në Sekretarinë mësimore, në rregulloren e programit të studimit, në web ³⁰⁴ të UMSH etj. Procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit në tjetrin përcaktohen në rregulloret e institucionit ³⁰⁵ .
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Duke iu referuar RVB si dhe takimeve gjatë vizitës në institucion konstatuam se institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion mbi njohjen e studimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme sipas kërkesave dhe nevojave të tyre kurrikulën dhe programin e studimit, i cili mund të merret në faqen zyrtare të institucionit, ose gjatë fazës së regjistrimit, gjatë ditëve të orientimit. ³⁰⁶
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Nga takimet e realizuara me stafin akademik, studentët si dhe dokumentacioni i shqyrtuar, GVJ konstaton se përcaktimi i formës së vlerësimit të dijeve për lëndët specifike, bëhet nga pedagogu i lëndës si dhe pasqyrohet në programin e lëndës, të cilat janë të bazuara në udhëzimet e MASR për strukturën e hartimit të syllabusit të lëndës dhe procedurat e vlerësimit të

³⁰⁴ <https://www.umsh.edu.al/c/145/studentet>

³⁰⁵ Evidenca 6. Rregullore e FDSHH.pdf, neni 27-29; Evidenca 8. Rregullore departamenti.pdf, Kreu III dhe Kreu IV

³⁰⁶ Evidenca 21. Udhezues i studentit.pdf

	dijeve. Syllabuset janë në dispozicion të studentëve nga pedagogu. Studentët pohuan se njihen me format e vlerësimit të njohurive, nga komunikimi i drejpërdrejtë me pedagogët, qysh në fillim të procesit mësimor kur bëhet dhe prezantimi i përgjithshëm i lëndës.³⁰⁷
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Kriteret dhe procedurat e diplomimit në programin e studimit përcaktohen në rregulloren e studimeve të UMSH³⁰⁸-së, gjithashtu ato janë lehtësisht të aksesueshme edhe në faqen web³⁰⁹. Departamenti gjithashtu ka miratuar dhe mbështetet në rregulloren e tij, Kreu X, "Diplomimi"³¹⁰ ku specifikohen edhe modalitetet e miratimit të personelit akademik që do të udhëheqë temat e diplomave, për ata studentë që diplomohen me diploma dhe pjesa tjetër e cila diplomohet me provim përfundimtar formimi³¹¹. Udhëzimi në lidhje me stukturën e temës së diplomës gjendet online³¹² dhe iu vihen në dispozicion studentëve në fillim të vitit të tretë. Fazat kohore të mbrojtjes së diplomës përmes provimit me shkrim ose verbalisht bëhen të ditura në fillim të çdo viti akademik³¹³. Studetëve ju vihen në dispozicion dhe pyetjet orientuese për provimin e formimit të këtë program³¹⁴
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	GVJ konkludon se, UMSH ofron informacione të organizuara në website si dhe në ditët e informimit të studentëve. Veprimtari të tilla, kanë për qëllim të njohin maturantët me programet e studimit që ofrohen nga UMSH si dhe i ftojnë në "Javën e orientimit". Përmes grupeve të punës të përbërë nga staf akademik informohen maturantët që janë të interesuar të studiojnë në UMSH. Institucioni ka bërë video promovuese si dhe fletëpalosje, ku çdo student mund të informohet paraprakisht.
Konkluzione	<i>Kriteret dhe procedurat e diplomimit në programin e studimit përcaktohen në rregulloren e studimeve të UMSH-së, gjithashtu</i>

³⁰⁷ Evidenca 9. Rregullore e programit.

³⁰⁸ Evidenca 2. Rregullore e organizimit UMSH.pdf, Kreu X

³⁰⁹ <https://www.umsh.edu.al/c/215/procesi-i-diplomimit>

³¹⁰ Evidenca 7. Rregullore e FDSHH.pdf

³¹¹ ³¹¹ <https://www.umsh.edu.al/media/5ee210c8c94d4.pdf>

³¹² <https://www.umsh.edu.al/media/5ee210ca5f24f.pdf>

³¹³ Evidenca 37 dhe Evidenca 38 Modeli i Diplomes _ SUPlementi.pdf

³¹⁴ Evidenca 17. Pyetjet orientuese.pdf

	ato janë lehtësisht të aksesueshme edhe në faqen web.UMSH ofron informacione të organizuara në website si dhe në ditët e informimit të studentëve. GVJ konstaton se UMSH ka vënë në dispozicion të studentëve të programit të studimeve psikosociale të gjithë informacionin e nevojshëm mbi pranimin, programin, vlerësimet dhe kriteret për kalueshmërinë deri në formatin e diplomimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënës dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve përmes një morie formash si rregullores së këtij program studimi, faqes zyrtare të institucionit, fushatave informuese, fletëpalosjeve, etj. Gjithashtu, studentët informohen nga zyra e pranimin dhe regjistrimit në sekretarinë mësimore, këshillimit nga stafi akademik në faza të ndryshme. ³¹⁵ GVJ konfirmoi sa më sipër gjatë takimit me stafin dhe me studentët.
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Duke iu referuar RVB si dhe takimeve gjatë vizitës në institucion konstatuam se institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion mbi kurrikulën dhe programin e studimit, i cili mund të merret në faqen zyrtare të institucionit, ose gjatë fazës së regjistrimit, gjatë ditëve të orientimit. Syllabuset ³¹⁶ e lëndëve mësimore përmbajnë informacione të detajuara mbi ngarkesën, temat për çdo javë mësimore, format e kontrollit dhe vlerësimit, niveli i detyrueshëm i frekuentimit të lëndës dhe literatura bazë dhe ajo e rekomanduar.
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi	Në shqyrtimin e dokumentacionit, si dhe nga intervistat me stafin akademik, GVJ konstatoi se ka një përpjekje për të

³¹⁵ Evidenca 19. Broshura e programeve Master.

³¹⁶ Evidenca 14.2. Syllabuset e lendeve.

mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	studiuar tregun e punës dhe orientuar më tej studentët. UMSH organizon në mënyrë të vazhdueshme takime, sesione informuese, orë të hapura me përfaqësues të institucioneve dhe bizneseve të cilat ofrojnë mundësi punësimi. Studentët janë pjesë e vazhdueshme e këtyre takimeve. Ajo që u vu re në masterin me profile është mbizotërimi kryesisht i lëndëve me karakter klinik dhe këshillim, e më pas ato të fushës organizative. Ndaj u sugjerua ndarja e profileve, sidomos ajo e Terapisë së njohjes dhe sjelljes, ku kërksat ishin me të larta. <i>Për këtë arsye, GVJ sugjeron krijimin e zyrës së karrierës edhe pranë fakultetit për të qenë më pranë studentëve dhe nevojave që ata kanë duke i orientuar në zgjedhjet që bëjnë si dhe në tregun e punës.</i>
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Në dispozicion të studentëve është një nga sistemet IT më të mira përsa i përket të gjithë procesit të menaxhimit universitar, ³¹⁷ i cili i siguron akses në një numër informacioni si regjistrimi i studentëve në lëndët përkatëse, akses i plotë në informacionin, detyrimet dhe literaturën ³¹⁸ e lëndëve që ndjekin. Secili pedagog është regjistruar në sistem në lëndët e veta dhe kështu mund të menaxhojë krejt lehtësisht gjithë procesin akademik. Akses i plotë në këtë platform bëhet nëpërmjet kredencialeve të cilat ju jepen studentëve sapo fitojnë status student nga Zyra IT ³¹⁹ . Informacion mbi organizimin e procesit mësimor gjendet lehtësisht edhe në faqen web ³²⁰ të UMSH-së.
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm në llogarinë e dedikuar të EMS që përdoret për çështjet akademike të studentëve, si rregjistrimi, menaxhimi i studentëve, stafi akademik, degët e studimit, lëndët, provimet etj. Studentët asistohen gjatë gjithë kohës nga sekretaria mësimore.
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se institucioni përmbush të gjitha kriteret dhe rregullat në fuqi lidhur me vënien në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënësve dhe mundësitë e punësimit.</i>

³¹⁷ Evidenca 35. Manual i përdorimit të platformes elektronike.pdf

³¹⁸ <http://biblioteka.umsh.edu.al:8020/EbooksServer/user-registration/index.php>

³¹⁹ Evidenca 35. Manual i përdorimit të platformes elektronike.pdf

³²⁰ <https://www.umsh.edu.al/c/214/kalendari-akademik>

	<u>Këtu duhet të mbahet në konsideratë krijimi një zyre karriere në nivel fakulteti për të qenë më pranë studentëve.</u>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	Institucioni disponon dhe mban statistika të lidhura me numrin e studentëve të diplomuar dhe cilësinë në dalje. Nga të dhënat që kemi në dispozicion për këtë program studimi për 3 vitet e fundit akademike. Numri i studentëve regjistruar në këtë program studimi për tre vitet e fundit akademike është: Për vitin akademik 2021-2022 44 studentë (18 org dhe 26 komunitar); Për vitin akademik 2022-2023 38 studentë (14 org, 12 komunitar dhe 12 psikoterapi); Për vitin akademik 2023-2024 42 studentë (12 org, 6 komunitar dhe 24 psikoterapi).
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Çdo student është i pajisur me dosjen personale, pavarësisht statusit që ka si student efektiv, i çregjistruar nga programi i studimit, apo si ish student. I gjithë ky dokumentacion gjendet i arkivuar pranë sekretarisë mësimore. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik. Të gjitha këto të dhëna gjenden pranë sekretarisë mësimore dhe janë të hedhura sipas rregullores dhe ligjeve në fuqi. Nga të dhënat që kemi në dispozicion për këtë program studimi për 3 vitet e fundit akademike, konstatohet se numri i studentëve të regjistruar është thuhet konstant, me një kërkesë në rritje për psikoterapinë. Për këtë arsye GVJ sugjeron ndarjen e profileve të masterit në dy drejtime që kanë më shumë lidhje me njëra - tjetrën: Psikologji organizacionale dhe komunitare njëri profil dhe Këshillim e Psikoterapi e njohjes dhe e sjelljes profili tjetër.

Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurt dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Zyra që merret me regjistrimin e studentëve dhe sekretaria mësimore³²¹ janë strukturat e posaçme që merren me ruajtjen dhe menaxhimin e të dhënave statistikore nga hyrja deri në dalje. Punën e tyre kryejnë edhe përmes Portalit studentor që përdoret për menaxhimin e rekordeve të studentëve e realizojnë edhe përmes sistemit informatik të regjistrave dhe arkivave të të dhënave të plota, kjo referuar dhe kuadrit rregullativ të përdorimit të platformave elektronike³²². Këto të dhëna disponohen për të gjithë studentët e universitetit dhe janë të sigurt, pasi sistemi është pjesë e RASH, i cili garanton sigurinë, si dhe në të kanë akses vetëm personat e autorizuar. Studenti ka dosjen personale, e cila ka të gjitha të dhënat që janë marrë në fazën e regjistrimit dhe vazhdojnë të përditësohen në vijim përgjatë viteve të studimit. Personat e autorizuar mbështeten në sistemin informatik për të gjeneruar statistika mbi studentët në mënyrë të shpejtë dhe të saktë.
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	Sekretaria mësimore e FDSHH përpilon, administron dhe mban përgjegjësi për mirëmbajtjen e regjistrat themeltar, të hartuar në mënyrë manuale dhe elektronike. Sekretaria mësimore administron regjistrat për çdo program studimi, regjistrin e diplomave, dosjet personale të studentëve, dokumentacionin e procedurave të transferimit apo çregjistrimit, regjistrin bazë të notave, procesverbalet e provimeve etj. Marrja e informacionit dhe njohja me dokumentacionin për personelin dhe studentët bëhet në përputhje me ligjin nr 887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre	Në Raportin e GVB-së informohemi se UMSH harton raporte analitike dhe periodike vjetore ku ndër të tjera pika trajton edhe cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nuk u evidentuan raporte të tilla, ndaj <u>GVJ sygjeron</u> që Departamenti në fokusin vjetor të punës të tij të ketë edhe raportimet analitike të studimeve në programin Master në “Psikologji” me profile dhe

³²¹ Evidenca 26. Rregullore e sekretarise mesimore.pdf

³²² Evidenca 35. Manual i perdorimit te platformes elektronikt.pdf

treguesve.	të informojë edhe studentët e interesuar kryesisht për masat e marra në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve dhe për këtë të ketë dhe politika dhe rregullore se si do të monitorohen përmirësimet. Ajo që GJV konstatoi gjithashtu lidhet me faktin që gjurmimi studentëve lidhur me punësimin e tyre jepet në nivel universiteti dhe jo në nivel programi. Do ishte më efektive të kishim një informacion në nivel programi për të parë efektivitetin e tij.			
Konkluzione	<i>GJV konstaton se institucioni përmbush të gjitha kriteret dhe rregullat në fuqi lidhur me përditësimin dhe ruajtjen e të dhënave të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre. Sekretaria mësimore e FDSHH përpilon, administron dhe mban përgjegjësi për mirëmbajtjen e regjistrit themeltar, të hartuar në mënyrë manuale dhe elektronike. Çdo student është i pajisur me dosjen personale, pavarësisht statusit që ka si student efektiv, i çregjistruar nga programi i studimit, apo si ish student. I gjithë ky dokumentacion gjendet i arkivuar pranë sekretarisë mësimore.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e	Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre ³²³ në organet vendimmarrëse ³²⁴ si Senatin Akademik, komisionin për garantimin e standardeve dhe cilësisë, GVB ³²⁵ , këshillin e etikës, si dhe në këshillin e studentëve ³²⁶ , i cili është grupim i studentëve dhe përzgjedh

³²³ Evidenca 1. Statuti UMSH.pdf– Kreu X; Evidenca 2. Rregullore e organizimit UMSH.pdf – Kreu VIII; Evidenca 8. Rregullore departamenti.pdf- Kreu IX; Evidenca 8. Rregullore departamenti.pdf . Sesioni IV.

³²⁴ Evidenca 38. Rregullore ZKSK.pdf

³²⁵ Evidenca 61. Mendimi dekanit. pdf

³²⁶ Evidenca 37. rregullore e Funksionimit të Këshillit Studentor.pdf

këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të UMSH-së dhe në vlerësimet e ndryshme të procesit mësimor ³²⁷ . Përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese është e përcaktuar konform akteve ligjore dhe atyre rregullatore, në statusin ³²⁸ e vetë institucionit.
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Në të gjitha strukturat ku përcaktohet me ligj përfshirja e tyre, kemi një angazhim të shprehur qartë në lidhje me rolin e studentëve. Ato janë pjesë aktive e mbledhjeve të senatit akademik, punojnë së bashku me stafin në grupet e vlerësimit të brendshëm të cilësisë dhe janë në brendësi të punës së tyre në këtë veprimtari. Gjatë takimeve në institucion, GVJ konstatoi gjithashtu që studentët jepnin mendimin e tyre lidhur me cilësinë në mësimdhënie, por jo në nivel programi dhe specifike për secilën lëndë. Ky është një element shumë i rëndësishëm në vlerësimin e një programi, pasi feedbacku duhet të jetë i drejtpërdrejtë dhe jo në nivel institucional. <i>GVJ sugjeron të mbahet në konsideratë vlerësimi i stafit akademik në nivel programi duke patur NJSBC funksionale edhe për këtë program studimi, gjë që nga dokumentacioni dorëzuar nuk u pa një raport i tillë i detajuar.</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe është e gatshme të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre ³²⁹ . Është në praktikën e kërrij departamenti dhe në përvojën e deritanishme të realizojë takime dhe fokus grupe me studentët për të nxitur përfshirjen e tyre si në proceset akademike, ashtu dhe në ato ekstrakurrikulare.
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe	Studentëve u mundësohet një proces transparent mbi mënyrën e kontrollit dhe vlerësimit të dijeve, i cili shprehet në rregulloret e brendshme të institucionit. Në drejtim të ndershmërisë së kryerjes së procesit janë argumentimi i vlerësimit nga pedagogu, zhvillimi i seancave sqaruese dhe mundësia e kërkesës për

³²⁷ Evidenca 25. Formulari i Vlerësimit të pedagogut nga studenti.pdf

³²⁸ Evidenca 1. Statuti UMSH.pdf, neni 11 përfshirja në senat,

³²⁹ Evidenca 25. Formulari i Vlerësimit të pedagogut nga studenti.pdf

kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	rivlerësim nga një komision i posaçëm.			
Konkluzione	<i>GVJ sugjeron të mbahet në konsideratë vlerësimi stafit akademik në nivel programi duke patur NJSBC funksionale edhe për këtë program studimi. GVJ e evidenton si një pikë të dobët mungesën e vlerësimeve nga pyetësorët e studentëve, analiza e të cilëve duhet të lidhet drejtpërdrejtë me lëndët, lektorin etj. Kjo gjë nuk u pa në asnjë raport të NJSBC drejtpërdrejtë me këtë program studimi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi V.6	
Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, RVB, si dhe vizitës në institucion GVJ konkludon se institucioni ka Zyrën e Karrierës vetëm në nivel universiteti, por jo pranë fakulteteve dhe departamenteve. Statuti ³³⁰ dhe rregulloret ³³¹ e institucionit përcaktojnë procedurat që ndiqen lidhur me informimin dhe shërbimin ndaj studentëve sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore. Një rol shumë të rëndësishëm luan stafi akademik dhe ndihmës akademik në informimin e studentëve si dhe ofrimin e shërbimit ndaj tyre. Kjo bëhet me iniciativën personale të disa anëtarëve të punësuar me kohë të plotë ose të pjesshme. <i>Për këtë arsye, GVJ rithekson rëndësinë që ka këshillimi dhe orientimi karrierës edhe në nivel programi.</i>
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të	Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, RVB, si dhe vizitës në institucion vihet re se veprimtaria e kordinatorit të programit, njësia bazë dhe sekretaria orientohen drejt informimit

³³⁰ Evidenca 1. Statuti UMSH.pdf

³³¹ Evidenca 2. Rregullore e organizimit UMSH.pdf; Evidenca 6. Rregullore e FDSHH.pdf; Evidenca 8. Rregullore departamenti.pdf

posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	të studentëve dhe këshillimit të tyre në momentin e regjistrimit me çdo informacion në lidhje me programet e studimit të ofruara, avantazhet që secili prej tyre ofron, mundësitë e punësimit në të ardhmen. Ashtu sikundër citohet edhe në RVB, të gjitha strukturat e IT, Zyra Këshillimit ³³² , ALUMNI etj janë në nivel institucional dhe nuk i shërbejnë drejtpërdrejtë këtij programi studimi. <i>Përsa më sipër, GVJ rekomandon krijimin e strukturave të posaçme për të qenë më pranë studentëve sipas çdo programi studimi, jo vetëm në nivel institucional.</i>
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Zyra e Karrierës është në shërbim të studentëve duke ofruar informacion në lidhje me mundësi punësimi, apo aktivitete studentore, mobilitete që zhvillohen brenda ose jashtë vendit, duke ofruar njëkohësisht asistencë për kryerjen e aplikimeve apo këshillimin e nevojshëm. Për të kontaktuar persona që punojnë pranë kësaj zyre, studentët duhet të drejtohen në rektoratin e universitetit. Jo të gjithë kishin informacion rreth saj dhe mundësive që ajo ofron. <i>GVJ rekomandon që kjo zyrë të jetë më shumë prezente dhe të ushtrojë ndikimin e saj për të krijuar kontakte me institucione publike, kompani private në funksion të zhvillimit të praktikave profesionale/intershipeve të studentëve pranë këtyre institucioneve, por edhe në kuadër të punësimit të ardhshëm të studentëve në këto kompani e organizata.</i>
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Zyra e këshillimit të karrierës dhe ALUMNI mban të dhëna lidhur me punësimin e studentëve, por këto të dhëna janë sërish për të gjithë universitetin. Referuar dokumentacionit të dorëzuar, nuk gjenden të dhëna specifike lidhur me ecurinë e mëtejshme të studentëve që kanë përfunduar studimet në programin Master në “Psikologji” me profile. <i>GVJ rekomandon të gjendet informacion më i detajuar në nivel programi.</i>
Konkluzione	<i>Përsa më sipër, GVJ rekomandon krijimin e strukturave të posaçme për të qenë më pranë studentëve sipas çdo programi studimi, jo vetëm në nivel institucional. GVJ rekomandon që kjo zyrë të jetë më shumë prezente dhe të ushtrojë ndikimin e saj për</i>

³³² Evidenca 38. Rregullore ZKSK.

	të krijuar kontakte me kompani private në funksion të zhvillimit të praktikave profesionale/intershipeve të studentëve pranë këtyre institucioneve, por edhe në kuadër të punësimit të ardhshëm të studentëve në këto kompani e organizata.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1 Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Në raport me politikat e institucionit për sigurimin e brendshëm të cilësisë dhe duke u mbështetur në ligjin për arsimin e lartë dhe aktet e tjera ligjore, në përputhje me statutin dhe rregulloren e institucionit evidentojmë disa elementë të dallueshëm lidhur me korrektësinë e institucionit në raport me Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë si strukturë mbështetëse e UMSH-së. Institucioni ka miratur Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulave (NJSBCZHK), e cila është një njësi e ngritur në nivel universiteti. Përbërja dhe funksionimi i kësaj njësie është miratuar nga Rektori. Kjo njësi përbëhet nga drejtuesi i zyrës, anëtarë të tjerë të kësaj zyre që janë përzgjedhur nga pedagogët e çdo departamenti, përfaqësues nga administrata, si dhe një përfaqësues nga Këshilli i Studentëve ³³³ . Çdo vit akademik, çdo departament bën një analizë të detajuar të punës së departamentit ku përfshihen mendimet dhe sugjerimet e studentëve për lëndët dhe pedagogët, mendimet dhe sugjerimet e pedagogëve për mbarrëvajtjen e lëndëve, si dhe raportimet e tyre.

³³³ <https://www.umsh.edu.al/c/125/sigurimi-i-cilesise>

	Pas kësaj analize, bëhen edhe ndryshimet respektive nëse ka të tilla. Referuar dokumentacionit të dorëzuar, nuk gjejmë fakte evidente lidhur me këtë proces, por ndërkohë gjatë vizitës në institucion pedagogët shprehen që e zhvillojnë në rrugë informale. Bisedat me studentët ndikojnë në përmirësimin e metodave të mësimdhënies sipas tyre. <i>Ky kriter nuk përmbushet sipas rregullave dhe ligjeve në fuqi, ndaj GVJ rekomandon të mbahet në konsideratë për më tej.</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	GVJ gjatë vizitës në institucion, konstatoi se Sistemi i brendshëm i cilësisë, funksionon i centralizuar, vetëm në nivel qëndror. Kjo strukturë ka pak kohë që ka nisur të ushtrojë aktivitetin e saj sipas rregullave dhe normave ligjore. Gjatë kontaktit me përfaqësues të kësaj strukture, u vu në pah ekzistenca e disa pyetësorëve³³⁴ të standartizuar të cilat duhet të përdoren më pas në çdo program studimi. Në këtë mënyrë mund të vlerësohen aftësitë mësimdhënëse të personelit akademik për lëndën dhe programin specifikisht. <i>Përsa më sipër, GVJ e cilëson këtë si një pikë të dobët të institucionit lidhur me cilësinë e programit dhe vlerësimin e tij. Mungojnë dokumente mbështetëse të punës së këtyre strukturave në formën e raporteve që prodhohen për këtë program studimi dhe departamentin.</i>
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.	Referuar dokumentacionin të dorëzuar dhe vizitës në institucion, konstatojmë që edhe pse kjo strukturë është ngritur në nivel universiteti, ndesh me vështirësi lidhur me përfshirjen e studentëve në nivel programi. Nuk evidentohet asnjë raport lidhur me vlerësimin e pedagogëve për secilën lëndë në këtë program studimi. Kjo gjë nuk i shërben përmirësimit të programit dhe marrjen në konsideratë të ankimimeve.³³⁵ <i>GVJ rekomandon që këto struktura të mbështesin secilin program dhe të kryejnë vlerësime më të detajuara për të përmirësuar programin e studimit.</i>
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Veprimtaritë në kuadër të sistemit të Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulave për programin e studimit janë transparente. Kuadri rregullator dhe politikat e institucionit³³⁶ në drejtim të mbështetjes dhe krijimit të lehtësirave në realizimin e një sërë veprimtarish të mbledhjes së

³³⁴ Evidenca 31. Formular për vlerësimin e pedagogëve.

³³⁵ Evidenca 34. Procedura e punës me focus grupe.

³³⁶ Evidenca 1. Statuti UMSH.pdf, neni 84

	informacionit në funksion të realizimit të një procesi korrekt të vlerësimit të brendshëm			
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Referuar të gjithë analizës së mësipërme, shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion, GVJ konstaton sërish që analiza dhe administrimi pyetësorëve nuk zhvillohet për programin e studimit dhe stafin akademik specifikisht. Kjo gjë pengon më pas promovimin e praktikave të mira dhe nuk ndikon si një nxitje për personelin akademik në përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. Stafi akademik ka patur mundësi promovimi në programet e mobilitetit, por këto kanë qenë iniciativa të aplikimeve individuale të secilit prej tyre. <i>Ky element shihet si një pikë e dobët për këtë program studimi, ndaj GVJ rekomandon të mbahet në konsideratë.</i>			
Konkluzione	GVJ ka shprehur më sipër opinionin sipas secilit kriter lidhur me këtë standard. Në përfundim mund të themi që ky element është një pikë e dobët për këtë program studimi pasi nuk trajton analiza të mirëfillta që i shërbejnë drejtpërdrejtë këtij programi studimi.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Universitetit Mesdhetar i Shqipërisë në zbatim të politikave të institucionit për sigurimin e brendshëm të cilësisë dhe duke u mbështetur në ligjin për arsimin e lartë dhe aktet e tjera ligjore, në përputhje me statutin ³³⁷ dhe rregulloren e institucionit ka ndërtuar disa element të dallueshëm lidhur me korrektësinë e institucionit në raport me Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë ³³⁸ si strukturë mbështetëse e UMSH-së. Gjithashtu universiteti ka miratuar edhe planin e zhvillimit strategjik për zhvillimin sa më të strukturuar e transparent të tij ³³⁹ . Struktura në fjalë e realizon punën e saj duke u mbështetur në një dokument të rëndësishëm

³³⁷ Evidenca 3. Organigrama.pdf

³³⁸ Evidenca 1. Statuti UMSH.pdf, Neni 53 dhe 84

³³⁹ Evidenca 4. Plani i Zhvillimit strategjik UMSH.pdf

	për funksionimin e saj siç është Rregullorja e UMSH-së neni 28 ³⁴⁰ , si dhe në të gjitha dokumentet e ASCAL-it.
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Misioni i Universiteti Mesdhetar të Shqipërisë është përgatitja e specialistëve dhe liderëve të spikatur për sektorin publik, privat dhe jofitimprurës dhe gjenerimi i ideve që u japin përgjigje dhe zgjidhje sfidave aktuale dhe perspektive të zhvillimit të vendit dhe rajonit³⁴¹. Filozofia e Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë, është ndërtimi i një komuniteti, mësimi dhe krijimi në të cilin respektohet, vlerësohet dhe besohet çdo pjestar dhe zhvillohen pritshmëri të larta për veten dhe të tjerët, nëpërmjet inspirimit, arritjeve dhe ekselencës³⁴². Plani strategjik i zhvillimit të UMSH-së evidenton se universiteti është i përkushtuar për të siguruar cilësi dhe kjo mund të arrihet vetëm nëpërmjet procedurave efektive të menaxhimit dhe organizimit të strukturave, të cilat sigurojnë mbarëvajtjen e proceseve akademike dhe kërkimore si edhe të veprimtarisë menaxheriale të Universitetit³⁴³.
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	Institucioni ka aplikuar për akreditim për programin e studimit në ASCAL konform rregullave në fuqi në vendin tonë. Ka ndjekur të gjitha procedurat zyrtare që lidhen me këtë proces. ASCAL ka ngritur grupin e punës, i cili është angazhuar në procesin e vlerësimit të jashtëm të akreditimit për këtë program studimi. Për sigurimin e cilësisë në nivel qëndor institucioni përdor instrumentet e ndryshme si pyetësorë me studentët, stafin akademik, takimet në grup për të garantuar ndërhyrjen dhe përmirësimin e cilësisë nëse është e nevojshme. Referuar akreditimit institucional, institucioni ka marrë vlerësimin maksimal.
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim,	Struktura e sigurimit të brendshëm të cilësisë përmes organizimit të saj ³⁴⁴ të veprimit synon që për këto qëllime të realizojë monitorim të vazhdueshëm të punës së stafit akademik dhe

³⁴⁰ Evidenca 2. Rregullore e organizimit UMSH.pdf

³⁴¹ Evidenca 1. Statuti UMSH.pdf, Neni 4

³⁴² <https://www.umsh.edu.al/c/14/misioni-dhe-filozofia>

³⁴³ Evidenca 4. Plani i Zhvillimit strategjik UMSH.pdf

³⁴⁴ <https://www.umsh.edu.al/c/125/sigurimi-i-cilesise>

për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	administrativ me fokus sigurimin e cilësisë në menaxhim, zhvillimin e projekteve kërkimore, ndërkombëtarizimin³⁴⁵ përmes programeve të mobilitetit për stafin ³⁴⁶dhe studentët. Pjesë e këtyre veprimtarive do të jenë zyra e burimeve njerëzore, njësisë për kërkimin shkencor, departamentet dhe zyra e kujdesit për studentët, zyra e karrierës, kordinatorët dhe senati akademik³⁴⁷. Referuar dokumentacionit të dorëzuar dhe RVB, nuk evidentojmë tregues të qartë dhe të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim. Ndërkohë gjatë vizitës në institucion dhe intervistave të zhvilluara me personelin akademik u diskutuan instrumente të ndryshme që përfshijnë vetëraportime të pedagogëve, raportime në nivel departamenti, monitorim nga njësia e sigurimit të cilësisë, të procesit mësimor si dhe mendime nga studentët. GVJ rekomandon që këto dokumente të formalizohen dhe të jenë më të matshëm për të promovuar punën e gjithësecilit.			
Konkluzione	Universitetit Mesdhetar i Shqipërisë në zbatim të politikave të institucionit për sigurimin e brendshëm të cilësisë dhe duke u mbështetur në ligjin për arsimin e lartë dhe aktet e tjera ligjore, në përputhje me statutin dhe rregulloren e institucionit ka ndërtuar disa element të dallueshëm lidhur me korrektësinë e institucionit në raport me Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë si strukturë mbështetëse e UMSH-së. GVJ konstaton që kjo strukturë (NJSBC) ekziston në nivel qëndror dhe nuk gjenden raporte apo dokumentet për këtë program studimi specifikisht. Nuk zotërojmë një dokumentacion mbështetës për të vlerësuar më mirë punën e kryer. Mungojnë dokumente mbështetëse të punës së këtyre strukturave në formën e raporteve që prodhohen për këtë program studimi dhe departamentin.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese

³⁴⁵ Evidenca 23. Strategjia e Ndekrombetarizimit.pdf

³⁴⁶ Evidenca 33. Levizja e stafit akademik.pdf

³⁴⁷ Evidenca 32. Plani i Monitorimit DPS.pdf

dhe rezultateve të synuara të të nxënit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Bazuar në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, konstatohet se institucioni për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programit angazhon titullarët, lektorët e lëndëve dhe asistent-lektorët në azhurnimin e syllabuseve. Për të nxitur dhe monitoruar procese të tilla një rol kyç luan Departamenti. Ky i fundit luan një rol të rëndësishëm në organizimin e procesit mësimor, rishikimin dhe vlerësimin sistematik për përmirësimin e planeve mësimore të programeve të studimit. Në dokumentacionet e bëra publike në faqen zyrtare të institucionit (https://www.umsh.edu.al/c/125/sigurimi-i-cilesise) gjenden raportet periodike dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse, gjithnjë në nivel universiteti.
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	Referuar RVB, dokumentacionit të dorëzuar dhe vizitës në institucion nuk evidentohen praktika aktuale që dëshmojnë përmbushjen më së miri të këtij kriteri. Ekziston vetëm një dokument në nivel universiteti lidhur me vlerësimin përmes pyetësorëve të plotësuar nga studentët, por që nuk jep fakte dhe detaje për këtë program studimi specifikisht. <i>GVJ ka konstatuar që nuk përmbushet me mjete dhe instrumente adresimi i mangësive dhe përmirësimi në vijim i cilësisë, si rrjedhojë nuk gjendet e aplikuar edhe motivimi i arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</i>
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e	UMSH në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit shprehet në RVB se përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies

cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	përmes monitorimit të syllabuseve, vlerësimit të pedagogëve si dhe përmes vlerësimeve paralele të provimeve apo detyrave të studentëve. Nga informacioni i paraqitur në RVB dhe atë i marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, u konstatua se institucioni për kryerjen e vlerësimit, përdor një pyetësor³⁴⁸, në nivel institucional, por ato nuk i shërbejnë drejtpërdrejtë këtij programi studimi. Raporti është i përgjithshëm dhe nuk evidenton cilat janë problematikat specifike sipas të gjithë komponentëve të programit të studimit. <i>Përsa më sipër, GVJ citon sërish që kjo duhet të mbahet në konsideratë për të vazhduar më tej</i>
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.	Institucioni kryen vlerësime periodike të centralizuara përmes njësisë së ngritur pranë universitetit. Kjo strukturë ka aplikuar pyetësor për studentët; fokus grupe; takime me stafin dhe studentë etj. Ajo në nivel njësie kryesore është struktura përgjegjëse për realizimin e procesit të vlerësimit. Gjithashtu, në kuadër të vlerësimit, realizimit dhe cilësisë së programit të studimit realizohen dhe monitorohen rezultatet e studentëve në provime, rezultatet e studentëve në realizimin e detyrave të ndryshme gjatë kursit, monitorim gjatë praktikës si dhe monitorimi procesit të mësimdhënies. <i>GVJ nuk gjen dokumente mbështetëse që dëshmojnë punën që bën institucioni në këtë drejtim, duke i shërbyer këtij programi studimi, përveç raporteve që gjenden online që janë përmendur shumë herë gjatë RVB.</i> Edhe ky kriter mbetet një pikë e dobët në këtë program.
Konkluzione	<i>GVJ ka konstatuar që nuk përmbushet me mjete dhe instrumente adresimi i mangësive dhe përmirësimi në vijim i cilësisë, si</i>

³⁴⁸ Evidenca 25. Formulari i Vlerësimit të pedagogut nga studenti.pdf




	<i>rrjedhojë nuk gjendet e aplikuar edhe motivimi i arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët. GVJ konstaton që në funksion të përmirësimit të cilësisë rekomandohen të kryhen vlerësime periodike duke marrë feedback nga të gjithë aktorët.</i> <i>GVJ nuk gjen dokumente mbështetëse që dëshmojnë punën që bën institucioni në këtë drejtim, duke i shërbyer këtij programi studimi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	UMSH përpiqet të parashikojë dhe garantojë politika dhe procedura që sigurojnë rritjen e brendshme të cilësisë, kjo duke përfshirë edhe aktorë të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit. Nga informacioni i paraqitur në RVB dhe atë i marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se institucioni garanton dhe bashkëpunon me ekspertë të jashtëm duke ruajtur dhe mbajtur në konsideratë përmirësimin e vazhdueshëm të paramentrave të cilësisë. Për këtë ekzistojnë dhe marrëveshjet e bashkëpunimit. ³⁴⁹
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton	Detyrat dhe përgjegjësitë e secilit individ të përfshirë nga institucioni për sigurimin e cilësisë bëhen të qarta në aktet rregullative të NJSBCZHK dhe udhëzimet për procese të caktuara. Individët dhe secila nga njësitë e angazhuara në Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë ka të përcaktuar përgjegjësitë sipas strukturës hierarkike organizative të UMSH-s dhe udhëzimeve të Rektoratit të cilët për procese të ndryshme vlerësimi planifikojnë, organizojnë dhe garantojnë zbatimin e

³⁴⁹ Evidenca 10. Marrëveshjet e bashkëpunimit.

ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	politikave dhe procedurave për realizimin e sigurimit të cilësisë. GJV konkludon se referuar planit të zhvillimit strategjik ³⁵⁰ dhe rregullores për funksionimin e brendshëm të cilësisë (NJSBCZHK) dhe përmes shqyrtimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion, nga informacioni i paraqitur dhe atë të siguruar në takimet gjatë vizitës në institucion, detyrat dhe përgjegjësitë konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palët të përfshira në çështjet e cilësisë janë të parashikuara në kuadrin rregullor ³⁵¹ të cilësisë
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.	UMSH si një njësi e Arsimit të Lartë, ka disa standarde të cilat i respekton për përzgjedhjen e anëtarëve në procesin e vlerësimit (si: kompetenca profesionale, paanshmëria, përfaqësimi për çdo njësi, rotacioni etj). Gjithashtu, edhe përfshirja e studentëve në këtë proces është në funksion të respektimit të integritetit dhe barazisë ndaj personelit dhe studentëve. <i>Nuk gjenden të dhëna mbështetëse në dokumentacion që dëshmojnë përfshirjen e njësisë bazë dhe kryesore në këtë proces, por vetëm dokumentacioni në nivel qëndror.</i> Gjatë takimit në institucion, GJV pati mundësi të kontaktojë me përfaqësues nga fakulteti, por mungojnë të dhëna të dokumentuara që dëshmojnë punën e kryer nga këta anëtarë.
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit është në përputhje me Kodin e Etikës dhe përpiqet të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe të drejtave të studentëve. ³⁵²
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e	Pjesë e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë janë edhe bashkëpunëtorë apo ekspertë të jashtëm, pedagogë me kohë të pjesshme, përfaqësues të institucioneve partnere, ish student alumni. Mendimet dhe ekspertiza e tyre vjen nëpërmjet tryezave të rumbullakëta, aktiviteteve të përbashkëta, mbledhjeve. Kjo gjë u evidentua edhe gjatë vizitave në institucion, ku personeli me kohë të pjesshme ishte aktiv dhe

³⁵⁰ Evidenca 4. Plani i Zhvillimit strategjik UMSH.pdf

³⁵¹ Evidenca 1. Statuti UMSH.pdf

³⁵² Kodi etikes pdf.

studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	pjesëmarrës në takimet e zhvilluara me GVJ.			
Konkluzione	<i>UMSH përpiqet të parashikojë dhe garantojë politika dhe procedura që sigurojnë rritjen e brendshme të cilësisë, kjo duke përfshirë edhe aktorë të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit. Individët dhe secila nga njësitë e angazhuar në Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë ka të përcaktuar përgjegjësitë sipas strukturës hierarkike organizative të UMSH-s dhe udhëzimeve të Rektoratit referuar dokumentacionit të dorëzuar, GVJ konstaton se nuk gjenden të dhëna mbështetëse në dokumentacion që dëshmojnë përfshirjen e njësisë bazë dhe kryesore në këtë proces, por vetëm dokumentacioni në nivel qendror.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Politikat, strategjitë e organizimit të veprimtarive, raportet periodike janë transparente dhe publikohen edhe në faqen zyrtare të UMSH, por sërish kemi një raport të përgjithshëm, pa identifikuar problematikat në nivel programi studimi. Edhe pse UMSH ka ngritur struktura duke shkuar deri diku në nivel fakulteti, informacioni që mblidhet nuk i shërben drejtpërdrejtë programit të studimit. Në funksion të transparencës do të ishin të nevojshme vijimi i praktikës të nisur si diskutimet me stafin dhe studentët, focus-grupet e ndryshme, etj. Këto veprimtari do të ndihmonin transparencën në ndarjen e informacionit me palët e interesuara dhe të përfshira, e gjithashtu do të lejonin marrjen e një feedback-u mbi mundësinë e përmirësimit të punës së grupit të vlerësimit të brendshëm të programit të studimit.

	<i>Përsa më sipër GVJ rekomandon që në raportet e tjera të jepen rubrika specifike për çdo program studimi, lëndë dhe lektor. Në këtë mënyrë mund të shkojmë në detaje dhe mund të përmirësojmë ndjeshëm cilësinë.</i>
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, RVB, si dhe vizitës në institucion, konstatohet se institucioni është i interesuar të ruajë dhe respektojë të dhënat e privatësisë, lirinë dhe etikën akademike-profesionale. Gjetjet e vlerësimit të brendshëm dhe raportet periodike janë transparente³⁵³ dhe bëhen publike dhe është lehtësisht e mundur që të evidentohen dhe të aksesohen raportet periodike në faqen web të UMSH-së, nga të gjithë të interesuarit.³⁵⁴ <i>GVJ sygjeron që të shihet mundësia e hartimit të raporteve të cilësisë vetëm për këtë program studimi, të jenë periodike dhe të shihet mundësia e publikimit të tyre, sigurisht duke mbajtur në konsideratë mbrojtjen e të dhënave personale, me qëllim që aktorët e interesuar të kenë mundësi të njihen me këto raporte.</i>
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Raporti i vetëvlerësimit të programit të studimit, si dhe raporti vjetor i departamentit përfshin edhe të dhëna mbi masat e marra nga plan veprimi i vitit të kaluar dhe planin e veprimit për vitin e ardhshëm akademik. Referuar RVB, dokumentacionit të dorëzuar dhe vizitës në institucion, <i>GVJ konstaton sërish që raportet e publikuara mbeten të përgjithshme dhe nuk kanë një plan konkret përmirësimi që lidhet drejtpërdrejtë me këtë program studimi.</i>
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Akreditimi është një proces me rëndësi dhe ndihmon fuqishëm për marrjen e vendimeve për të bërë ndryshime profilizuese të programit të studimit, për disa arsye: - Së pari, vlerësimi i jashtëm i programit të studimit nga ekspertët dhe rekomandimet e bëra prej tyre, mund të nxjerrin në pah nevojën për përmirësime të programit të studimit; - Së dyti, vlerësimi i brendshëm tërësor i programit të studimit, gjithashtu nxjerr në pah pikat e forta dhe të dobëta të programit të studimit; - Së treti, akreditimi i programit realizohet pas ofrimit, për një periudhë të caktuar kohe, kur mësimdhënia është konsoliduar, rezultatet e studentëve kanë dalë disa herë

³⁵³ <https://www.umsh.edu.al/c/125/sigurimi-i-cilesise>

³⁵⁴ Kodi etikes pdf.

	dhe nevojat për përmirësim janë më të bazuara. Raporti i vlerësimit të brendshëm të cilësisë pas përfundimit përdoret nga vetë institucioni për përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit, si dhe ndërmerren reagime nga ana e njësisë bazë në lidhje me pikat e dobëta të evidentuara nga grupi i vlerësimit të brendshëm.			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Angazhimin e stafit akademik dhe studentëve në sigurimin e brendshëm të cilësisë e kërkon baza ligjore në funksion të cilësisë në mësimdhënie si edhe nga rregulloret³⁵⁵ e UMSH-së dhe statuti³⁵⁶, një sërë strukturash të ngritura me qëllim sigurimin dhe përmirësimin e brendshëm të cilësisë përfshijnë në përbërje të tyre (NJSBCZHK). Të gjitha këto struktura që monitorojnë dhe dokumentojnë gjetjet e tyre, i ndajnë me strukturat e tjera me qëllim informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton sërish që raportet e publikuara mbeten të përgjithshme dhe nuk kanë një plan konkret përmirësimi që lidhet drejtpërdrejtë me këtë program studimi. GVJ sygjeron që të shihet mundësia e hartimit të raporteve të cilësisë vetëm për këtë program studimi, të jenë periodike dhe të shihet mundësia e publikimit të tyre, sigurisht duke mbajtur në konsideratë mbrojtjen e të dhënave personale, me qëllim që aktorët e interesuar të kenë mundësi të njihen me këto raporte.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

³⁵⁵ Evidenca 4. Plani i Zhvillimit strategjik UMSH.pdf

³⁵⁶ Evidenca 1. Statuti UMSH.pdf, Neni 4, Neni 53 dhe 84;


Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Psikologji” me profile “Psikologji Organizative”, “Psikologji Komunitare” dhe “Këshillim dhe Psikoterapi me Orientim Njohës Sjellor” ofruar nga Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë”.

Pikat e forta dhe afirmime

1. Universiteti Mesdhetar ka një listë të gjatë bashkëpunëtorësh kombëtarë që ka një përfitim të dyfishtë: nga njëra anë, lehtëson lidhjen teori – praktikë të programit, nga ana tjetër praktikat që studentët ndjekin bëhen realisht në institucione nga ku përfitojnë aftësi dhe shkathtësi të aplikueshme drejtpërdrejt në terren.
2. Universiteti Mesdhetar ka politika të qarta dhe efektive të rritjes së partneriteteve dhe bashkëpunimit me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, praktikave profesionale dhe kërkimit shkencor për programin e studimit.
3. Stafi akademik dhe ai administrativ janë në mbështetje të studentëve dhe shumë pranë tyre.
4. Universiteti ofron akses në biblioteka online ku studentët mund të aksesojnë shumë libra në fushën e psikologjisë. Kjo bibliotekë është një vlerë e shtuar për institucionin.

Pika të dobëta


1. Mungesa e relacionit të saktë për ndryshimin dhe riorganizmin e masterit nga Master i Shkencave në Master i Shkencave në Psikologji me Profile “Psikologji Organizative”, Psikologji Komunitare, “Këshillim dhe Psikoterapi me Orientim Njohës Sjellor” (standarti II.3. kriteri 2; standarti II.5. kriteri 3)
2. Specifikimi përgjegjësisë, punës së koordinatorit si në rregullore dhe evidentimi tij dhe dokumentacion në të cilën merret një vendim në përcaktimin e tij. (Standardi II.2, Kriteri 3).
3. Personeli akademik i programit Master i Shkencave në “Psikologji” me profile, edhe pse ka tituj akademikë dhe grade shkencore në përputhje me ligjet aktuale duhet që hartimi syllabuseve dhe stafit në këtë nivel masteri shkencor të jetë me titull Profesor” Profesor i Asoc. (Standardi II.4, kriteri 5).
4. Departamenti i Psikologjisë, rekomandohet të konsiderojë përmirësimin dhe përditësimin e përmbajtjes së programit të studimit në mënyrë të vazhdueshme sipas objektivave strategjikë të zhvillimit të departamentit dhe të programit të studimit.
5. Të bëhen përpjekje për të rritur numrin stafit akademik me formim bazë dhe të vazhduar në psikologji dhe sugjerohet që personeli akademik i programit të studimit të liçencohet nga Urdhri i Psikologut në Republikën e Shqipërisë.



6. Mungesa e mobilitetit të studentëve nga programi i studimit Master i Shkencave në “Psikologji” me profile, drejt programeve të ngjashme në universitete jashtë vendit dhe anasjelltas. Vetëm një studente u raportua. (standarti I.3. kriteri 3).
7. Mungesa e evidencave të përmirësimit dhe përditësimit të përmbajtjes së programit të studimit në mënyrë të vazhdueshme si në elementët e planit mësimor të programit të studimit edhe në përmbajtjen e syllabuseve të lëndëve dhe moduleve të ofruara në programin e studimit. (standarti II.3., kriteri 5)
8. Praktikat e sigurimit të cilësisë nuk mbërijnë në nivel programi dhe nuk vlerësojnë aftësitë mësimdhënëse dhe formimin e personelit akademik të angazhuar në nivel programi. (kapitulli VI). Përsa më sipër, GVJ e cilëson këtë si një pikë të dobët të institucionit lidhur me cilësinë e programit dhe vlerësimin e tij. Mungojnë dokumente mbështetëse të punës së këtyre strukturave në formën e raporteve që prodhohen për këtë program studimi dhe departamentin.

Rekomandime

- 1- Institucioni të punojë më shumë në drejtim të nxitjes së mobilitetit të studentëve të programit të studimit Master i Shkencave” në “Psikologji” me profile, në mënyrë që të ketë tregues të studentëve përfutës nga programet e shkëmbimit.
- 2- Departamenti i Psikologjisë, rekomandohet të konsiderojë përmirësimin dhe përditësimin e përmbajtjes së programit të studimit në mënyrë të vazhdueshme sipas objektivave strategjike të zhvillimit të departamentit dhe të programit të studimit. Të ndahen profilet në dy drejtime si master më vete, në mënyrë që të kenë më shumë lidhje me njëra – tjetrën 1. Master në Psikologji organizative dhe komunitare dhe 2. Master në Këshillim dhe Psikoterapi me orientim njohës dhe sjelle.
3. Të bëhen përpjekje për të rritur numrin stafit akademik me formim bazë dhe të vazhduar në psikologji dhe sugjerohet që personeli akademik i programit të studimit të licensohet nga Urdhri i Psikologut në Republikën e Shqipërisë.
4. Të hartohen dhe të implementohen politika të qarta për vlerësimin e cilësisë së programit të studimit dhe të personelit akademik të angazhuar në programin e studimit në mënyrë që procesi të shërbejë përmirësimit të cilësisë nëpërmjet strategjive të ndërhyrjes. GVJ sugjeron të mbahet në konsideratë vlerësimi i stafit akademik në nivel programi duke patur NJSBC funksionale edhe për këtë program studimi, gjë që nga dokumentacioni dorëzuar nuk u pa një raport i tillë i detajuar.
5. Sugjerohet një rishikim i planit mësimor 2022-2024 në llogaritjen e orëve siç është te diploma pasi shihet se në total orët janë 120 në punën individuale dhe konsultimit ndërkohë në total është dhënë 410 orë.
6. GVJ sugjeron se në këtë program studimi duhet riparë kurrikula ku të jepen më shumë lëndë të profileve përkatëse të programit duke qënë se studentët përgjatë studimit të këtij program studimi profilizohen.



7. GJV sugjeron që është e domosdoshme krijimi i një laboratorit me të gjitha mjetet dhe pajisjet e nevojshme që do i shërbejë këtij programi studimi. Departamenti ka menduar krijimin e laboratorit në lidhje me psikologjinë, kryesisht atë të njohjes dhe të sjelljes, por që ende nuk është finalizuar dicka. Për studentët e masterit është shumë e rëndësishme zhvillimi i orëve praktike në ambiente pune me klientë
8. GJV i sugjeron institucionit të ndërtojë politika specifike për organizimin e praktikës duke përcaktuar në to dhe mënyrën e përzgjedhjes së personelit mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale, me detyrimet përkatëse të studentëve për t'u përmbushur gjatë praktikave dhe me kriteret e vlerësimit
9. GJV sugjeron që është e nevojshme që Fakulteti të bëjë përpjekje të mëtejshme për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit pasi është i varfër dhe jo i pajisur me literaturë bashkëkohore.
10. GJV rekomandon që zyra e karrierës të jetë më shumë prezente dhe të ushtrojë ndikimin e saj për të krijuar kontakte me institucione publike, kompani private në funksion të zhvillimit të praktikave profesionale/intershipeve të studentëve pranë këtyre institucioneve, por edhe në kuadër të punësimit të ardhshëm të studentëve në këto kompani e organizata.

Evaluation's conclusions for the second cycle study program Master of Sciences in Psychology with profiles provided by the Higher Education Institution "Mesdhetar University "

Strengths and affirmations

1. The Mediterranean University has a long list of national collaborators that has a double benefit: on the one hand, it facilitates the theory-practice connection of the program, on the other hand, the practices that students follow are actually carried out in institutions from which they benefit from skills and abilities that are directly applicable in the field.
2. Mediterranean University has clear and effective policies for increasing partnerships and cooperation with institutions, companies, third parties, local and/or foreign business actors in order to implement the study program, within the framework of professional training, professional practices and scientific research for the study program.
3. The academic and administrative staff are supportive of the students and very close to them.
4. The university offers access to online libraries where students can access many books in the field of psychology. This library is an added value for the institution.

Weaknesses




1. Lack of accurate relation for the change and reorganization of the master's degree from Master of Science to Master of Science in Psychology with Profiles "Organizational Psychology", Community Psychology, "Counseling and Psychotherapy with Cognitive Behavioral Orientation" (standard II.3.criterion 2;standard II.5. criterion 3)
2. Specifying the responsibilities and work of the coordinator as in the regulations and recording it and the documentation in which a decision is made in its designation. (Standard II.2, Criterion 3).
3. The academic staff of the Master of Science program in "Psychology" with profiles, although they have academic titles and scientific degrees in accordance with current laws, must draft syllabi and staff at this level of scientific master's degree be with the title of Professor" Associate Professor (Standard II.4, criterion 5).
4. The Department of Psychology is recommended to consider improving and updating the content of the study program on an ongoing basis according to the strategic development objectives of the department and the study program.
5. Efforts should be made to increase the number of academic staff with basic and continuing education in psychology and it is suggested that the academic staff of the study program be licensed by the Order of Psychologists in the Republic of Albania.
6. Lack of student mobility from the Master of Science in Psychology study program with profiles to similar programs at universities abroad and vice versa. Only one student was reported.(standard I.3. criterion 3).
7. Lack of evidence of continuous improvement and updating of the content of the study program, both in the elements of the study program curriculum and in the content of the syllabi of the subjects and modules offered in the study program. (Standard II.3., criterion 5)
8. Quality assurance practices do not reach the program level and do not assess the teaching skills and training of academic staff engaged at the program level. (Chapter VI).
Regarding the above, GVJ considers this as a weak point of the institution regarding the quality of the program and its evaluation. Supporting documents of the work of these structures in the form of reports produced for this study program and the department are missing.

Recommendation

1. The institution should work more towards promoting the mobility of students in the Master of Science in Psychology study program with profiles, so that there are indicators of students benefiting from exchange programs.
2. The Department of Psychology is recommended to consider improving and updating the content of the study program on an ongoing basis according to the strategic development objectives of the department and the study program.To divide the profiles into two




separate master's degrees, so that they have more connections with each other: 1. Master's in Organizational and Community Psychology and 2. Master's in Counseling and Psychotherapy with a cognitive and behavioral orientation.

3. Efforts should be made to increase the number of academic staff with basic and continuing education in psychology and it is suggested that the academic staff of the study program be licensed by the Order of Psychologists in the Republic of Albania.
4. To draft and implement clear policies for assessing the quality of the study program and the academic staff engaged in the study program so that the process serves quality improvement through intervention strategies. The GVI suggests taking into consideration the evaluation of academic staff at the program level by having a functional NJSBC for this study program as well, although such a detailed report was not seen in the submitted documentation.
5. A review of the 2022-2024 curriculum is suggested in calculating the hours as it is in the diploma, as it is seen that the total hours are 120 in individual work and consultation, while a total of 410 hours have been given.
6. GVI suggests that in this study program, the curricula should be revised to include more subjects of the relevant profiles of the program, since students are profiled throughout the study of this study program.
7. GVI suggests that it is necessary to create a laboratory with all the necessary tools and equipment that will serve this study program. The department has considered creating a laboratory related to psychology, mainly cognitive and behavioral, but nothing has been finalized yet. For master's students, it is very important to develop practical hours in work environments with clients.
8. GVI suggests that the institution build specific policies for organizing internships, defining in them the method of selecting supervisory personnel in the host environment who are engaged in the implementation of professional internships, with the respective obligations of students to be fulfilled during internships and with the evaluation criteria.
9. GVI suggests that it is necessary for the Faculty to make further efforts to increase the library's items, updating the existing fund in support of the program as it is poor and not equipped with contemporary literature.
10. GVI recommends that the career office be more present and exercise its influence to create contacts with public institutions and private companies in order to develop professional practices/internships for students at these institutions, but also in the context of the future employment of students in these companies and organizations.



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA , LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
VLERËSIMI TËRËSOR				X

